



BULETINI
VËLLIMI II

Parathënie:



Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që në cilësinë e kryesueses së PZAP-it të shkruaj këtë parathënie për buletinin e - II- të me vendime të PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës (të mbajtura me 11 qershor 2017) dhe Zgjedhjet Komunale e për Kryetar të Komunave të vitit 2017 (të mbajtura me 22 tetor 2017). Buletini do të jetë pikë referimi

për ata që punojnë dhe që merren me proceset zgjedhore në Kosovë. Me rastin e përgatitjes së Buletinit të dytë jemi përkushtuar të tregojmë rezultatet kryesore të punës së PZAP-it për dy palë zgjedhjet e vitit 2017.

Edicioni i dytë i Buletinit përmban një numër të rasteve më të veçuara dhe më të rëndësishme të vendimeve për të gjitha fazat e procesit zgjedhore dhe pas zgjedhor përfshirë rastet e vendimeve që kanë të bëjnë me ankesat e subjekteve politike, Kandidateve për deputet për Kuvend të Republikës së Kosovës, kandidatëve për anëtar të Kuvendeve Komunale, kandidatëve për Kryetar të Komunave, Organizatave Jo Qeveritare, qytetarëve etj. të parashtruara lidhur me:

Para fushatën zgjedhore, fushatën zgjedhore, thyerjen e heshtjes zgjedhore, ditën e zgjedhjeve, administrimin e Rezultateve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

PZAP-i ka nxjerrë vendime të rëndësishme për të gjitha fazat e procesit zgjedhor të dy palë zgjedhjeve të organizuara në Kosovë në vitin 2017, por ndër vendimet më të rëndësishme të PZAP-it janë ato me të cilat ka anuluar rezultatet votimit të raundit të parë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Parteshit dhe ka urdhëruar KQZ-në për përsëritjen e votimit për raundin e parë të zgjedhjeve për kryetar në këtë komunë si dhe ka anuluar rezultatet votimit të raundit të dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut dhe ka urdhëruar KQZ-në për përsëritjen e votimit për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar në këtë komunë në Zgjedhjet Komunale të Vitit 2017.

Vendime tjera të rëndësishme të PZAP-it janë edhe: Largimi nga lista e 10 (dhjetë) kandidatëve për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të koalicionit të komunitetit boshnjak (SDA-BSDAK), për shkak se janë të etnisë shqiptare, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura në Vitin 2017.

Shqiptimi i dënimi më gjobë në vlerë prej 25,000.00 (njëzet e pesë mijë) euro ndaj një subjekti politik të komunitetit serb për shkak të publikimit të një spoti zgjedhor ku bënë mesazhe kërcënuese për mos krijimin e ushtrisë së Kosovës dhe funksionalizimin e plotë të shtetit të Kosovës, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura në Vitin 2017.

Decertifikimin nga gara të një kandidat për kryetar të Komunës në Prizren nga subjekti politik NISMA, në Zgjedhjet Komunale të Vitit 2017.

Vlen të theksohet e të përsëritet se sa është e rëndësishme që parashtruesit e ardhshëm të ankesave dhe apeleve të synojnë dorëzimin e ankesave dhe apeleve në PZAP duke përdorur këtë buletin, të konsultoj me vëmendje vendimet e PZAP-it në rastet e ngjashme dhe ti marrin parasysh nëse rasti i tyre mund të ketë ndonjë mundësi suksesi në dritën e rasteve të ngjashme. Duhet kuptuar qartë që parimisht e drejta e ankesës nuk mund ti mohohet asnjë parashtruesi, por do të ishte e dobishme që ata paraprakisht të njoftoheshin me buletin e PZAP-it dhe të kenë vlerësim objektiv për suksesin e ankesave të tyre.

Qëllimi i publikimit të vendimeve të PZAP-it është t'i tregohet opinionit të gjerë se anëtarët e PZAP-it i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe plotësisht transparente, duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë.

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time te veçantë për të gjithë stafin e PZAP-it, me punën dhe me përkrahjen e të cilëve është bërë i mundur publikimi i edicioni të dytë të buletinit me vendime të PZAP-it.

Gyltene Sylejmani
Kryesuese e PZAP-it

Përmbajtja

Zgjedhjet Parlamentare - 2017	9
VENDIMI - Anr.02/2017 , Mos emërimi i anëtarëve të KKZ-së.....	10
VENDIMI-Anr.09/2017 , Tërheqje nga lista e kandidatëve për deputet.....	12
VENDIMI-Anr.10/2017 Largim nga lista e kandidatëve për deputet.....	14
VENDIMI –Anr.67/2017 , Dëmtimi posterave gjatë fushatës zgjedhore.....	19
VENDIMI – Anr.120/2017 , Nxitje, provokim dhe urrejtje ndaj ekzistimit të shtetit të Republikës së Kosovës.....	21
VENDIMI –A.nr. 196/2017 , Vëzhguesit e certifikuar kanë përdorur akronimin e subjekteve tjera politike.....	24
VENDIM Anr.250/2017 , Vendosija e Posterëve në objekte publike.....	26
VENDIMI - Anr.259/2017 , Kërcenim dhe bartja me automjete e votuesve nga subjekti politik deri në QV në ditën e votimit.....	29
VENDIMI - Anr.264/2017 , Presion tek votuesit për të votuar subjektin e zzzcaktuar politik dhe tentim për blerje të votave.....	31
VENDIMI - Anr.266/2017 , Votimi është lejuar pa u kontrolluar gjurmët e gishtërinjëve të votuesve me llamba ultraviolete dhe sprej.....	32
VENDIMI - Anr.277/2017 , Thyerja e heshtjes zgjedhore.....	34
VENDIMI - A.nr. 322/2017 , Gabim në plotësimin e Formularëve të Rezultateve të Kandidatëve – FRK në vendvotim.....	36
VENDIMI - A.nr. 341/ 2017 , Votuesit janë lejuar të votojnë me dokumente të shtetit tjetër.....	37
VENDIMI – A.nr. 358/2017 , Shpallja e rezultateve preliminare.....	41
VENDIMI – A.nr. 386/2017 , Shpallja e rezultateve përfundimtare (Pas rinumërimit të fletëvotimeve për kandidat, është ndryshuar rezultati përfundimtar dhe është ndryshuar rezultati i renditjes së kandidatëve për deputet, sipas rezultatit që ka rezultuar nga rinumërimi i fletëvotimeve, me vendim të PZAP-it).....	43
VENDIMI – A.nr. 407/2017 , Shpallja e rezultateve përfundimtare (Pas rinumërimit të fletëvotimeve për kandidat, është ndryshuar rezultati përfundimtar dhe është ndryshuar rezultati i renditjes së kandidatëve për deputet, sipas rezultatit që ka rezultuar nga rinumërimi i fletëvotimeve, me vendim të PZAP-it).....	46
 Zgjedhjet Lokale - 2017	
VENDIMI - ZL.Anr.01/2017 , Mos emërimi i anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ-së).....	52
VENDIM - ZL.Anr.28/2017 , De certifikim i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal.....	54

VENDIMI - ZL.Anr.67/2017,	
Nxitje e urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore	58
VENDIMI - ZL.Anr.70/2017, Vendosja e posterave në hapësira publike.....	62
VENDIMI - ZL.Anr.83/2017,	
Mos përfshirja e votuesve në listën e votuesve jashtë Kosovës.....	65
VENDIMI - ZL.Anr.87/ 2017,	
Pengim i mbajtjes së tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore.....	67
VENDIMI - ZL.Anr.88/2017,	
Përfshirja (përdorimi) i fëmijëve në fushatë zgjedhore.....	71
VENDIMI – ZL.Anr.142/2017,	
Vendosja e njoftimeve të subjekteve politike në hapësira publike.....	73
VENDIMI – ZL.Anr.170/2017,	
Vendosja e tendave në hapësirë publike.....	76
VENDIMI – ZL.Anr.192/2017,	
Përdorimi i objekteve publike gjatë fushatës zgjedhore.....	81
VENDIMI – ZL.Anr.223/2017,	
Shpifje, nxitje dhe provokim në rrjete sociale gjatë fushatës zgjedhore.....	84
VENDIMI – ZL.Anr.252/2017, Nxitje, provokim dhe urrejtje ndaj ekzistimit të shtetit të Kosovës.....	87
VENDIMI - ZL.Anr.352/2017, Ndërrim i numrit në listën e votuesve.....	91
VENDIMI- ZL.Anr.442/2017, Thyerja e heshtjes zgjedhore në afërsi të Qendrës së Votimi (QV-së).....	94
Anulim i zgjedhjeve për kryetar të komunës - Raundi i parë (Rivotimi).....	96
VENDIMI-ZL A.nr. 776/2017, Mospërputhje e votave në Formularët e Rezultateve të Kandidateve (FRK).....	99
VENDIMI – ZL.Anr.1072/2017, Vëzhguesi i certifikuar nga KQZ ka bërë fushatë zgjedhore për një subjekt politik të caktuar.....	101
VENDIMI - ZL A.nr.1086/2017, Thyerja e heshtjes zgjedhore duke i udhëzuar votuesit të votojnë për kandidatin e caktuar.....	106
VENDIMI - ZL A.nr. 1114/2017, Manipulim i votimit me postë i votuesve jashtë Kosovës.....	109
VENDIMI -ZL A.nr. 1119/2017, Ligjshmëria e kandidaturës për kryetar të komunës.....	117
VENDIMI-ZL A.nr. 1125/2017, Parregullsi gjatë ditës së votimit dhe shpallja e rezultateve përfundimtare.....	119
VENDIMI- ZL.A.nr.1128/2017, Votim me kusht i personave të cilët nuk kanë qenë në listën e votuesve.....	128
VENDIMI - ZL.Anr.1142/2017, Shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale për kryetar komune – Raundi i dytë-Rivotim.....	130

Botues: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Bordi redaktues: Rafet Haxhaj - anëtar i PZAP-it dhe kryesues i grupit punues për hartimin e Buletinit, Fejzullah Rexhepi - anëtar i PZAP-it, Faton Ademi - anëtar i PZAP-it, Adnan Konushevci - anëtar i PZAP-it, Mulë Desku - Kryesues i Sekretariatit të PZAP-it, Halil Cenaj, - Drejtor i Departamentit Ligjorë, Florije Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore, Kudret Hasani - Zyrtarë i Lartë Ligjor, Valbona Millaku - Zyrtare e Lartë Ligjore, Vrion Krasniqi - Zyrtar i Teknologjisë Informative (TI), Fuad Jamini - Koordinator i Përkthimeve, Antigona Murati - Asistente Ekzekutive.

Kontribuuesit: Gyltene Sylejmani - Kryesuese e PZAP-it, Hasan Shala - anëtar i PZAP-it, Ymer Hoxha - anëtar i PZAP-it, Zyhdi Haziri - anëtar i PZAP-it, Afijete Sada- Glllogjani - anëtare e PZAP-it, Nenad Llazić - anëtar i PZAP-it, Rrustem Thaqi - anëtar i PZAP-it, dhe Kymete Kicaj - anëtare e PZAP-it.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Të drejtat e autorit: Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përgjashtim i përgjegjësive: Sipas nenit 118.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, vendimet e PZAP-it publikohen në përputhshmëri me rregullat dhe procedurat e PZAP-it. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e PZAP-it. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhjeje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të publikuara nga PZAP-i, mbizotëron versioni origjinal i vendimit i arkivuar në arkivin e PZAP-it dhe i cili është i publikuar në web faqen zyrtare të PZAP-it. Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të PZAP-it.



ZGJEDHJET
PARLAMENTARE - 2017

VENDIMI - Anr.02/2017, Mos emërimi i anëtarëve të KKZ-së

Subjekti politik X.X., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apel kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak se nuk e ka emëruar për anëtarë të KKZ-së personin N.N., të nominuar nga ky subjekt politik.

PZAP-i, apelin e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 118. paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenit 11. paragrafi 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, sepse parashtruesi i apelit nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet e tij.

Paneli vlerëson se, pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja për emërimin e përfaqësuesit të këtij subjekti politik për anëtarë të KKZ-së në komunën e Prizrenit i është bërë e padrejtë dhe se subjekti politik X.X. ka pasur më shumë vota se partitë tjera minoritare të komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkali (REA), janë të paqëndrueshme ngase subjekti politik X.X. që është parashtruesi i apelit në këtë rast, nuk ka fituar vota të mjaftueshme për zgjedhjet përgjithshme në nivel komunal, në mënyrë që ti mundësohet emërimi i anëtarit të KKZ-së, ashtu siç ka kërkuar.

VENDIM

REFUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik X.X., me seli në Prizren i parashtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) lidhur me emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Komunën e Prizrenit.

Arsyetim

Parashtruesi i apelit nga subjekti politik X.X. me seli në Prizren me datën 18.05.2017 ka paraqitur një apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së me të cilin pretendon se KQZ nuk e ka pranuar dhe nuk e ka nominuar për anëtar të Komisionit Komunal Zgjedhor në Prizren personin N.N. i lindur me datën 25.12.1967.

Parashtruesi i apelit ka kërkuar që të anulohet vendimi i KQZ-së dhe të emërohet si anëtar i KKZ-së përfaqësuesi nga radhët e subjektit politik N.N., pasi që ky subjekt prin dhe ka pasur më shumë vota se partitë tjera të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit.

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 11 paragrafi 7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datën 18.05.2017 e ka informuar KQZ-në dhe ka kërkuar nga ky komision që deri më datë 19.05.2017 në orën 12:00 të përgjigjet lidhur me apelin e parashtruar.

Në përgjigjen e ofruar nga KQZ theksohet se subjekti politik X.X., nuk e ka fituar numrin e votave në nivel komunal për zgjedhjet nacionale ashtu siç pretendohet nga parashtruesi i apelit me propozim për PZAP-in që apeli të refuzohet si i pabazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli i ka vlerësuar apelin e parashtruar dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015 - Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, se pala parashtruese e apelit ka të drejtën e parashtrimit të apelit dhe se PZAP-i ka kompetencën e shqyrtimit të apeleve dhe të nxjerrë vendime për apelimet e tilla. Paneli ka gjetur se përveç pretendimeve të thëna si më lartë, pala parashtruese nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet e parashtruara në apel.

Paneli vlerëson se, pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja për nominimin e kandidatit për KKZ në komunën e Prizrenit i është bërë e padrejtë dhe se subjekti politik X.X. ka pasur me shumë vota se partitë tjera minoritare të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë të paqëndrueshme ngase subjekti politik X.X. që është parashtruesi i apelit në këtë rast, nuk ka fituar vota në nivel komunal për zgjedhjet nacionale.

Mbi këtë bazë Paneli vlerëson se vendimi i apeluar i KQZ-së, për nominimin e kandidatit të KKZ-së në Komunën e Prizrenit, është i bazuar në ligj dhe është në harmoni të plotë me nenin 67 par. 1 dhe

3 te LZP-se në të cilin KQZ-ja është përpjekur dhe ka garantuar përfaqësimin e drejtë të KKZ-së, në komunën e theksuar më lartë, për të gjitha komunitetet me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI-Anr.09/2017, Tërheqje nga lista e kandidatëve për deputet

Parashtruesja e apelit B.P., kandidate për deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik X.X., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja (PZAP), ka parashtruar apel duke e kontestuar vendimin e KQZ-së me nr.717/2017 për certifikimin e kandidatëve për deputet të datës 24.05.2017, me të cilin kërkon që të tërhiqet nga lista e kandidatëve për deputet për arsye se është certifikuar në këtë listë kundër vullnetit të saj.

Apelin me të cilin është ankimuar vendimi i lartpërmendur, Paneli e ka aprovuar si të bazuar, në mbështetje të nenit 28. paragrafi 1 lidhur me nenin 122. paragrafi 1 i LPZ-së, që përcakton se nëse kandidati/ja pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në procesin zgjedhor mund të parashtroj apel në PZAP, dhe paneli ia mundëson tërheqjen pa e zëvendësuar të njëjten me ndonjë kandidat tjetër nëse i plotëson kushtet ligjore.

VENDIM

I.PRANOHET apeli si i bazuar i B.P., lidhur me tërheqjen nga lista e kandidatit për deputet nga X.X., Leposaviq.

II. ANULOHET vendimi nr.717/2017 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve lidhur me certifikimin e kandidates B.P..

Arsyetim

Parashtruesja e apelit, B.P., kandidate për deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik, X.X., me seli në Leposaviq me datën 25.05.2017, ka paraqitur apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së me nr.717-2017 për certifikimin e kandidatëve të datës 24.05.2017, në të cilin kërkon që të tërhiqet nga lista e kandidatëve për deputet për shkak të arsyeve të saja personale dhe nuk mund të jetë në listën e kandidatëve për deputet. Parashtruesja e apelit pretendoi se ka njoftuar edhe subjektin e saj politik X.X., dhe se emri i saj në këtë listë është kundër vullnetit të saj. Po ashtu nëpërmjet kësaj shkrese dëshmon se nuk ka pranuar vullnetarisht që të jetë në këtë listë. Parashtruesja e apelit kërkon nga PZAP-i që ti merret për bazë kërkesa për tërheqja nga lista e kandidatëve dhe të anulohet vendimi i KQZ-së.

Paneli konstatoi se apeli është i bazuar pasi që neni 122. 1 pika c, i LZP-së, përcakton se nëse kandidati pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në procesin zgjedhor mund të parashtroj apel në PZAP, andaj mbi këtë bazë paneli konstaton se apeli është i bazuar duke marrë parasysh se kandidates për deputete B.P., e cila për arsye personale nuk dëshiron që të jetë pjesë në listat zgjedhore në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 25.05.2017, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit në të njëjtën ditë.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ brenda afatit të caktuar me të cilën theksohet se në bazë të nenit 28.1 të LZP-së tërheqja apo zëvendësimi i kandidatëve dhe subjekteve politike mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim për tërheqje jo më vonë se dy ditë të punës para datës së caktuar për tërheqjen e shortit të përcaktuar sipas nenit 24.1 të LZP-së. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se KQZ në mbledhjen e mbajtur me datën 24.05.2017 ka marrë vendim me nr. Protokollit 717-2017 ku është caktuar që data e hedhjes së shortit të bëhet me datën 26.05.2017 ku sipas KQZ-së parashtruesja e apelit kërkesën për tërheqje ka parashtruar më datën 25.05.2017 dhe bazuar në nenin 28.1 të LZP-së e njëjta nuk mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Apeli është i bazuar:

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku përcaktohet se: “subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së, për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit”, ku sipas kësaj dispozite apeli i parashtruar nga ana e kandidatës B.P. është paraqitur brenda afatit kohorë dhe se ndryshimi i datës së hedhjes së shortit nga ana e KQZ-së, nuk mund të jetë në dëm të kandidatës.

Paneli konstatoi se apeli është i bazuar pasi që neni 122.1 pika c, i LPZ-së, përcakton se nëse kandidati pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në procesin zgjedhor mund të parashtrorj apel në PZAP, andaj mbi këtë bazë paneli konstaton se apeli është i bazuar duke marrë parasysh se kandidatës për deputete B.P., e cila për arsye personale nuk dëshiron që të jetë pjesë në listat zgjedhore në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Andaj mbi këtë bazë dhe bazuar në nenin 122.1 pika c si dhe nenin 118.1 të LPZ, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI-Anr.10/2017, Largim nga lista e kandidatëve për deputet

Koalicioni X.X. dhe Y.Y., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apel duke e kontestuar vendimin e KQZ-së nr. 692/2017 të datës 24.05.2017, me të cilin vendim sipas parashtruesit të apelit janë larguar nga lista dhjetë (10) kandidatët e nominuar për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga koalicionit X.X.–Y.Y., për shkak se janë të komunitetit shumicë në vend.

PZAP-i apelin e parashtruar e aprovoi si të bazuar pasi që ka konstatuar se KQZ-ja me rastin e marrjes së vendimit të ankimuar nuk ka plotësuar aspektin procedural lidhur me njoftimin për korigjimin e listave të kandidatëve për deputet në kuptim të nenit 26 par. 3 të LZP-së, i cili parashikon që njoftimi të jetë i arsyetuar

në formë të shkruar ku do të sqarohet se, përse lista e kandidatëve për deputet të koalicionit politik në fjalë duhej korrigjuar. Paneli duke u nisur nga pikëpamja e mos plotësimit procedural nga ana e KQZ-së, ka anuluar vendimin e KQZ në fjalë duke ia kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje të kësaj çështje.

VENDIM

APROVOHET si i bazuar apeli, Anr.10/2017 datë 25.05.2017, i Koalicionit X.X. dhe Y.Y., ashtu që ANULOHET vendimi i KQZ-së me nr. 692/2017 të datës 24.05.2017, dhe çështja i kthehet KQZ-së, në rishqyrtim dhe rivendosje.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel nga Koalicionit X.X.-Y.Y. me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr. 692/2017 të datës 24.05.2017, me të cilin vendim sipas parashtruesit të apelit janë larguar nga lista 10 kandidat për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të koalicionit X.X-Y.Y, për shkak se janë të etnisë shqiptare.

Parashtruesi i apelit, si në apelin e paraqitur kundër vendimit të ankimuar të KQZ-së, nr.692/2017 të datës 24.05.2017, ashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 26.05.2017, ka mbetur në tërësi, pran pretendimeve të paraqitura në apelin e datës 25.05.2017, ne të cilin ka pretenduar se çfarë vendimi ka marr KQZ, në këtë rast nuk ka ndodhur asnjëherë në praktikën zgjedhore, sepse KQZ veprimin e saj e arsyeton se në bazë të kërkesës së Koalicionit rival "M.M" ka angazhuar Agjensionin e Regjistrimit Civil (ARC), e cila ka ndërmarrë hetimin e kandidatëve me qëllim që të identifikohen se kandidat e listës së parashtruesit të apelit, se cilës kombësi i përkasin dhe se të njëjtit nën presion dhe dhunë janë deklaruar se i takojnë kombësisë shqiptare. Mëtej parashtruesi i apelit, në seancën dëgjimore ka potencuar se kandidatët për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë tërhequr nga lista e X.X-Y.Y, pa dijen e kryesisë së këtij subjekti politikë, dhe nën presionin që ju është bërë kandidatëve të tërhequr se do të ballafaqoheni me procedura gjyqësore nëse nuk tërheqin, krejt kjo është bërë nga KQZ-ja, sipas parashtruesit të

apelit. Me propozim për PZAP-in, që të anulohet vendimi i ankimuar i KQZ-së, dhe të certifikohet lista e X.X.-Y.Y., me 30 kandidatët, sepse vendimi i KQZ-së, është anti-Kushtetues dhe anti-ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përmes përfaqësues së tij, si në përgjigje në apel ashtu edhe në seancën dëgjimore kanë theksuar pretendimet ankimore janë të pabazuara sepse lista kandidatëve për deputet të koalicionit X.X.-Y.Y. është rregulluar në prezencën e udhëheqësit të koalicionit N.B. H.K. dhe A.N. të cilën listë e ka nënshkruar vet A.N. kandidat për deputet dhe me të njëjtën është pajtuar para se ZRPPC ta rekomandon listën e deputetëve në KQZ. Ashtu siç është theksuar me lart përfaqësuesja e KQZ-së, mëtej në seancë thekson se pastrimin e listës të kandidateve të koalicionit X.X.-Y.Y. është bërë nga përfaqësuesit e këtij koalicioni që i cekëm më par dhe pas pastrimit i është dorëzuar KQZ për miratim. Pastrimi i listës është bërë me qëllim që në kuadër të koalicionit X.X.-Y.Y., të jenë kandidat vetëm nga komuniteti që edhe është vetë koalicioni pasi që të njëjtit garojnë në zgjedhjet e 11.06.2017, për deputet për vendet e garantuar sipas nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas KQZ-së, subjektet e komuniteteve jo shqiptare që garojnë për vendet e rezervuara apo të garantuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, do të duhej që në listat e tyre të jenë të përfshirë vetëm kandidat të komunitetit që i takon vetë subjekti politik. Me propozim për PZAP-in, që apeli i parashtruar nga Koalicioni X.X.-Y.Y., të refuzohet si i pabazuar ngase është në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës dhe në kundërshtim me nenin 111 par.1 të LZP-së.

Me propozimin e parashtruesit të apelit, në seancën e datës 26.05.2017, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar A.N. kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit X.X.-Y.Y. i cili deklaron se personalisht dy lista i 'ka nënshkruar por listën e parë e ka nënshkruar në zyrë, konkretisht në ZRPPC, dhe në atë listë nuk ka pas kurrfarë shkrimi përveç emrave, pastaj shihet që janë përdorur disa laps-kimike. Ndërsa listën e dytë e ka nënshkruar në korridor të KQZ-së, por në listën e dytë ka qenë një emër i shlyer. Prezent me dëshmitarin ka qenë në KQZ H.K. i koalicionit X.X.-Y.Y. dhe F.Rr. kandidat për deputet i koalicionit X.X.-Y.Y. me vonë ka ardhur edhe N.B. përfaqësues-udhëheqës i koalicionit X.X.-Y.Y. Dëshmitari potencon se ka pas presion nga KQZ

për tu larguar nga lista pasi që nuk është i entitetit të koalicionit X.X.-Y.Y. dhe largimi i tij nga lista sipas këtij dëshmitari është pa dëshirën e tij.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë dhe provat si në vijim: Vendimin e KQZ-së, Nr. 692/2017 të datës 24.05.2017, Listën e Kandidatëve para se të rekomandohet nga ZRPPC për votim në KQZ dhe deklaratën e dëshmitarit A.N. të dhënë në seancën e datës 26.05.2017.

Pasi që paneli, bëri vlerësimin e pohimeve të palëve në procedurë, vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 par. 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), aprovoi apelin si të bazuar dhe vendosi si nëdispozitiv të këtij vendimi nga arsyet në vijim:

Nga vendimi i KQZ-së, Nr. 692/2017 të datës 24.05.2017, paneli konstaton se është certifikuar lista e 20 kandidatëve për deputet e koalicionit X.X.-Y.Y. që garojnë për vendet e garantuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e cila listë ishte rekomanduar nga ZRPPC, për certifikim në KQZ.

Me listën e kandidatëve të koalicionit X.X.-Y.Y. të nënshkruar në dy fletat nga A.N. me datë 24.05.2017, në cilësinë e kandidatit për deputet, në koalicionin e lartpërmendur, paneli nuk ka mundur ta vlerësoi së për çfarë lloj liste bëhet fjalë sepse e njëjta nuk përmban asnjë lloj shkrimi se çfarë liste është përveç që shihet se është listë e 30 deputetëve të koalicionit X.X.-Y.Y., e lëshuar nga KQZ, ndërsa lidhur me rumbullakimet, minuset apo pluset që janë bërë afër emrave të kandidatëve që gjenden në këtë listëpo ashtu paneli nuk ka mundur t'i vlerëson se për çfarë arsye janë bërë rumbullakimet e emrave, minuset apo pluset, prandaj të njëjtës nuk ia fali besimin dhe nuk ka pas ndonjë rëndësi në vendimmarrje.

Paneli, nga deklarata e dëshmitarit dhe njeherit kandidat për deputet të koalicionit X.X.-Y.Y., ka vlerësuar se i njëjti është tërhequr nga lista kundër vullnetit të tij, dhe kundër vullnetit të udhëheqësit të Koalicionit X.X.-Y.Y..

Përfaqësuesja e KQZ-së, në seancën e datës 26.05.2017, potencon se ka biseduar përmes telefonit me H.B., e afërt me udhëheqësin e koalicionit X.X.-Y.Y., për ti tërhequr nga lista e deputetëve, kandidatët për deputet të cilët janë të etnitetit shqiptar.

Mirëpo KQZ, me asnjë provë materiale apo në mënyrë shkresore nuk e ka dëshmuar se kandidatët e tërhequr nga lista janë tërhequr me vetëdëshirë, siç e thekson në seancë përfaqësuesja e KQZ-së, për më tepër KQZ, nuk i ka ofruar asnjë provë PZAP-it, që e njëjta ka bërë përpjekje që ta njofton udhëheqësin e koalicionit X.X.-Y.Y..

Me këtë rast KQZ, me rastin e marrjes së vendimit të ankimuar ka rënë në kundërshtim me nenin 26 par.3 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se *“Nëse zyra vendos që lista e kandidatëve nuk përmbush dispozitën e mësipërme, në atë rast e njofton subjektin politik në fjalë që të korrigjojë listën e kandidatëve në periudhën brenda (5) ditëve të punës, duke dhënë arsyetimin/et/ se përse lista e tyre duhet korrigjuar”*, ngase zyra nuk i' ka prezantuar PZAP-it, asnjë dëshmi se e ka njoftuar koalicionin X.X.-Y.Y., apo që ka vepruar konform dispozitës së lart cituar ligjor.

Duke marr parasysh se kemi të bëjmë me zgjedhje të parakohshme ky afat pesë ditor përgjysmohet, por nuk justifikohet që korrigjimi i listave të kandidatëve të bëhet përmes telefonit, pasi nga dispozita e lartcekur njoftimi duhet të jetë i arsyetuar se për se lista duhet të korrigjohet, që nënkupton se njoftimi duhet të jetë në formën e shkruar, andaj paneli konstaton se nuk është plotësuar aspektin procedural, sipas nenit 26 par.3 të LZP-së, për njoftimin e subjektit politik për korrigjimin e listës së kandidatëve për deputet, para se të merret vendimi i ankimuar nga KQZ. Në rast se subjektet politike nuk i korrigjojnë listat sipas kërkesës së ZRPPC-së, atëherë ZRPPC të njëjtën ta rekomandon në KQZ për vendosje mirëpo me sqarim se nuk është e korrigjuar lista nga subjekti i caktuar politik por në asnjë rast ZRPPC nuk mund vetë ta korrigjoj listën pa vullnetin e subjektit politik (që tërheqja duhet të jetë në formën e shkruar), por këtë korrigjim mund ta bëjë KQZ-ja, me rastin e vendosjes së certifikimit të kandidatëve të një subjektit politik, duke vendosur se cilët kandidatë nuk mund të certifikohen, si kandidatë për deputet.

Nga arsyet e theksuar më lart, vendimi i kundërshtuar është dashtë të anulohet dhe çështja t'i kthehet KQZ-së, në rishqyrtim dhe riprocedurë, për t'i eliminuar shkeljet esenciale të dispozitave të lartë theksuara ligjore, që janë të tilla që e pengojnë vlerësimin ligjshmërisë së vendimit të ankimuar. KQZ-ja, në riprocedurë të kujdeset që çështja të shqyrtohet në tërësi ashtu që të merr parasysh vërejtjet e lart theksuar, pretendimet e paarshtuar në

apel nga parashtruesi i apelit, provat në shkresat e lëndës dhe pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve theksuara më lart, të merr vendim të bazuar në ligj, duke e arsyetuar marrjen e vendimit ngase në vendimin e kundërshtuar nuk ka fare arsyetim për marrjen e të njëjtit.

Andaj PZAP-i, konform dispozitave ligjore të nenit 118 par. 1 lidhur me nenin 122 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI – Anr.67/2017, Dëmtim i posterave gjatë fushatës zgjedhore

Subjekti politik N.N. përmes përfaqësuesit të tij në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar ankesë, kundër koalicionit X.X. të cilën e përfaqëson sipas autorizimit G.K., për shkak të dëmtimit të posterëve gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, me të cilën pretendon se në sheshin “Adem Jashari”, dhe në rrugën “Ahmet Delija”, në komunën e Skenderajt, posterët e kandidatit V.S. janë dëmtuar nga militantët e koalicionit X.X..

PZAP-i, ankesën e parashtruar e refuzoj si të pabazuar, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117. paragrafi 2 të LZP-së ngase parashtruesi i ankesës me asnjë dëshmi nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesë, se janë dëmtuar posterët që ishin objekt lëndor.

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesae subjektit politik N.N., me seli në Prishtinë, Anr.67/2017, e datës 05.06.2017, me të cilën ka kërkuar që të ndërmerren veprimet ligjore kundër Koalicionit X.X., për shkak të dëmtimit të posterave.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesën e paraqitur nga N.N., me datë 05.06.2017, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi fotografitë e printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi në ankesës

po ashtu në seancën dëgjimore të datës 06.06.2017, mbetet në tërësi pranë pretendimeve ankimore, duke theksuar se me datën 05.06.2017, rreth orës 10:00, aktivisti i tyre ka vërejtur se në sheshin “Adem Jashari” dhe në rrugën “Ahmet Delija”, në Skenderaj, posterët e kandidatit V.S. ishin dëmtuar nga militantët e koalicionit X.X. etj., edhe pse të njëjtit ishin vendosur në hapësira të lejuara nga KQZ. Parashtruesja e ankesës gjatë seancës propozoj që të dëgjohet si dëshmitarë F.S. nga Skenderaj, i cili mund të jap informata lidhur me atë se kush i ka bërë dëmtimet e posterëve.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni X.X. etj., të datës 06.06.2017, si dhe në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 06.06.2017, nuk e kanë pranuar shkeljen e pretenduar sipas ankesës duke arsyetuar se N.N. me asnjë provë nuk e dëshmon së veprimi i kundërligjshëm është kryer nga X.X. dhe partnerët. Posterit nuk gjendet në lartësinë dorës ku edhe një këmbësor i thjeshtë do të mund të dëmtonte, ai është në lartësinë e tillë që vetëm ata që e kanë vendosur do të mund të kenë qasje në të, prandaj, N.N. do të duhej të sillte dëshmi me emra e mbiemra që të vërtetonte se këtë veprim e kanë kryer aktivistët e koalicionit. Po ashtu i propozon PZAP-së, që të mos e pranoj si të verifikuar këtë ankesë.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimi të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë dhe provat si në vijim: shikoj dy fotografit nga vendi ku janë dëmtuar posterat dhe deklaratën e dëshmitarit F.S. nga Skenderaj, të dhënë në seancën e datës 06.06.2017.

Pasi që paneli, bëri vlerësimin e pohimeve të palëve në procedurë, vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 par. 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), nga të njëjtat nuk mundi të vërtetoj faktin e pretenduar si në parashtrimet e ankesës se për dëmtimet e posterve janë përgjegjës militantët e Koalicionit X.X. etj., andaj **refuzoj si të pabazuar ankesën** dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi nga arsyet në vijim:

Nga fotografia e identifikuar me nr.1, Paneli vlerëson se posterit i kandidatit V.S. nga radhët e subjektit politik N.N., ka qenë i vendosur në një ndërtesë, mirëpo i njëjti shihet qartë se është dëmtuar respektivisht është grisur në anën e poshtme të tij, nga persona të panjohur.

Nga fotografia e identifikuar me nr.2, Paneli, nuk ka mundur ta vërteton se materiali propagandistik, që përdoret për fushatë zgjedhor, e që shihet sështë i dëmtuar, a është i subjektit politik N.N. apo e ndonjë subjekti politik tjetër, sepse nga fotografia e ofruar si dëshmi, shihet se është dëmtuar materiali i cili ka qenë i vendosur në vendet e dedikuar për reklamim por nuk mund të identifikohet se cilit subjekt i takon materiali i dëmtuar.

Paneli ka aprovuar propozimin e parashtruesit të ankesës dhe është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit F.S., i cili ka deklaruar se në natën kur janë dëmtuar posterët ka ndodhur edhe një incident me veprimtarin e N.N., F.I., në Komunën e Skenderajt dhe mbështetësve të Koalicionit X.X., i cili aludon se mbasi ka ndodhur incidenti me veprimtarin e tyre të lartpërmendur, të njëjtin veprim e kanë bërë sipas dëshmitarit, mbështetësit e koalicionit X.X. etj. edhe pse i njëjti deklaroi nuk e din se kush i ka dëmtuar posterët dhe personalisht dëshmitari nuk e ka parë dhe nuk e ka identifikuar askënd, andaj Paneli as nga deklarata e dëshmitarit F.S. i cili është vëllai i kandidat V.S., nga radhët e subjektit politik N.N., nuk mundi ti vërtetoi pretendimet ankimore se mbështetësit e koalicionit X.X. etj. i kanë dëmtuar posterat që janë objekt lëndor, ngase dëshmitari në seancën e datës 06.06.2017, nuk ka mundur ta identifikon asnjë person që i ka dëmtuar posterat në fjalë, në mënyrë që paneli të ndërmerri veprime ndaj subjektit politik.

Prandaj paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, më asnjë dëshmi nuk i ka vërtetuar pretendimet e parashtruara në ankesë, në mënyrë që PZAP, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI – Anr.120/2017, Nxitje, provokim dhe urrejtje ndaj ekzistimit të shtetit të Republikës së Kosovës

Organizata Jo Qeveritare N.N. në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X., për shkak të nxitjes, provokimit dhe urrejtjes ndaj ekzistimit të shtetit të Kosovës gjatë fushatës zgjedhore në

Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, në të cilin rast pretendohet se subjekti politik X.X. ka publikuar një spot zgjedhor me mesazhe kërcënuese për mos krijimin e ushtrisë së Kosovës dhe funksionalizimin e plotë të shtetit të Kosovës. Gjithashtu, bën thirrje për ruajtje të institucioneve të shtetit të Serbisë në Kosovë, ndërsa Republika e Kosovës quhet “ Kosovë e Metohi”.

PZAP-i, ankesën e parashtruar e miratoi si të bazuar në kuptim të nenit 117. paragrafi 2 të LZP-së për arsye se, subjekti në fjalë me qëllim të promovimit të subjektit politik dhe kandidatit të tij, në spotin zgjedhor ka përdorur simbolet e hartës së një shteti tjetër Serbisë, ku është përfshirë edhe Kosova, veprim ky që nga Paneli është kualifikuar se nxitë urrejtje dhe kërcenim për mos krijimin e ushtrisë së Kosovës dhe funksionalizimin e shtetit të Kosovës. Po ashtu edhe mesazhet që nxitin, provokojnë urrejtjen ndaj mos ekzistimit të shtetit të Kosovës, si dhe fyerjen edhe të subjekteve tjera politike serbe, me ç’rast përdorimi i mesazheve të tilla është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike.

VENDIM

PRANOHET si e bazuar ankesae N.N., dhe subjektit politik X.X., i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 25,000.00 (njëzet e pesë mijë) euro, për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, e cila detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

Arsyetim

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga N.N. me të cilën pretendon se subjekti politik X.X. ka publikuar një spot zgjedhor ku bënë mesazhe kërcënuese për mos krijimin e ushtrisë së Kosovës dhe funksionalizimin e plotë të shtetit të Kosovës. Në spot gjithashtu bëhet thirrje për ruajtje të institucioneve të Serbisë në Kosovë ndërsa Kosova quhet Kosova dhe Metohi. Pra parashtruesi i ankesës thekson se spoti i X.X. ka mesazhe që nxisin provokim dhe urrejtje ndaj ekzistencës të shtetit të Kosovës dhe janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i

ankesës si provë materiale ka bashkangjitur një CD.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik X.X. për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 08.06.2017 deri në ora 09:00.

Subjekti politik X.X. gjer në ora 11:00 të datës 08.06.2017 nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë. Mos dorëzimi i përgjigjes në ankesë si dhe mos dorëzimi i saj me kohë, nuk është pengesë që PZAP-i të vendos lidhur me ankesën (neni 7.5 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it).

PZAP-i pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se;

- ankesa është e bazuar

Paneli pas shikimit të bërë në CD-në, e ofruar si provë materiale e cila është publikuar edhe nëëeb-faqe zyrtare të X.X., ka vlerësuar se subjekti politik X.X. me qëllim të promovimit të subjektit politik dhe kandidatëve të tij në spotin zgjedhor X.X. ka përdorur simbolet e hartës të Serbisë ku është përfshirë edhe Kosova, që nxit urrejtje, bënë kërcënim për mos krijimin Ushtrisë së Kosovës dhe funksionalizimin e shtetit të Kosovës. Spoti X.X. po ashtu ka mesazhe që nxit provokon urrejtjen ndaj ekzistimit të Shtetit të Kosovës dhe bënë thirrje për ruajtjen e institucioneve të Serbisë në Kosovë, ndërsa Kosovën e quan Kosova i Metohija, po ashtu nga spoti në fjalë sipas X.X. është e vetmja listë që i ka kandidatët serbë për deputetët serbë, e që edhe kjo është një fyerje për subjektet tjera politike serbe, sepse siç dihet janë të certifikuar edhe subjekte politike tjera të këtij komuniteti dhe të njëjtat janë duke garuar në zgjedhjet e parakohshme parlamentare për Kuvend në Republikën e Kosovës, dhe sipas vlerësimit të Panelit me përdorimin e kësaj gjuhe në spot nxitet urrejtja kundër të tjerëve.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika (l) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: *Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si*

në vijim: Përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokoj një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi mori parasysh shkeljet e lartpërmendura, dhe shqiptoj gjobën, duke u bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c) LZP-së, nenin 3 pika 11 Rregullores për Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, si dhe duke marr parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI –A.nr. 196/2017, Vëzhguesit e certifikuar kanë përdorur akronimin e subjekteve tjera politike

Subjekti politik N.N. në ditën e votimit ka paraqitur ankesë kundër koalicionit X.X. dega në Obiliq, me të cilën pretendon se në shumicën e vendvotimeve në Komunën e Obiliqit, të gjithë vëzhguesit me këtë akronim janë deklaruar se janë anëtarë të vetëm dy subjekteve politike Y.Y. dhe Z.Z. edhe pse ka pasur vëzhgues tjerë të emëruar në vendvotime.

PZAP-i ankesën e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar, pasi që ka vlerësuar se pohimet e ankuesit janë të pa argumentuara dhe të pa dëshmuara me asnjë provë relevante, për faktin se parashtruesi i ankesës nuk kishte bashkangjitur asnjë provë relevante që do të argumentonin pretendimet e tij në ankesë.

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr. 196/2017 i datës 11.06.2017 parashtruar nga U.G. nga rradhët e subjektit politik N.N. dega në Obiliq.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11 qershor 2017, nga U.G. nga rradhët e subjektit politik N.N. dega në Obiliq, paraqitur kundër koalicionit X.X. dega në Obiliq, me të cilën parashtruesi i ankesës pretendon se në shumicën e vendvotimeve VV në Obiliq, të gjithë vëzhguesit me këtë akronim janë deklaruar se janë anëtarë të subjekteve politike Y.Y. dhe Z.Z..

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga U.G. në cilësinë e zyrtarit nga rradhët e subjektit politik N.N. dega në Obiliq ku pretendohet se në shumicën e vendvotimeve VV në Obiliq, gjatë kohës së procesit të votimit, të gjithë vëzhguesit me këtë akronim janë deklaruar se janë anëtarë të subjekteve politike Y.Y. dhe Z.Z..

PZAP-i vlerësoi se pohimet e ankuesit janë të pa argumentuara, pasi që nuk janë të dëshmuara me asnjë provë relevante, për të vërtetuar dhe vendosur lidhur me pretendimet ankimore në favor të parashtruesit të ankesës.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIM Anr.250/2017, Vendosja e Posterëve në objekte publike

Koalicioni i përberë nga Subjektet politike N.N., M.M., Y.Y., kanë paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X., për shkak të vendosjes së posterëve në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, me të cilën pretendon se me datën 08.06.2017, rreth orës 8:30, në rrugën "Afrim Zhitija", p.n. në objektin e Administratës Pensionale, në komunën X.X., aktivistët nga radhët e subjektit politik X.X. kanë vendosur posterët e kandidatit të tyre për deputet të Kuvendit të Kosovës, dhe se është bërë shkelje e dispozitës ligjore të nenit 33. paragrafi 1 pika b e LZP-së.

PZAP-i pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga koalicioni i subjekteve politike N.N., M.M., Y.Y., gjeti se ankesa është e bazuar, dhe subketit politik X.X., i shqiptoj dënim më gjobë në vlerë prej 3,300.00 € (tremijë e treqind euro), pasi që nga provat e ofruar nga parashtruesi i ankesës, në mënyrë të padyshimtë rezulton se posterët e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik X.X., janë vendosur në objekte publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33. pika b) i LZP-së.

PZAP-i kërkesën për tërheqjen e ankesës si më lartë nga koalicioni N.N., M.M., Y.Y., kundër subjektit Politik X.X., nuk e ka miratuar, pasi që ka vlerësuar se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut, dhe se në këtë rast tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ.

VENDIM

Pranohet si e bazuar ankesae koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Mitrovicë, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Mitrovicë, i shqiptohet dënimi më gjobë nëvlerë prej 3,300.00 (tremijë e treqind)euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.06.2017, përmes dërgesës postare, ndërsa sipas datës 12.06.2017 e protokolluar me nr.250/2017, me të cilën pretendon se me datën 08.06.2017, rreth orës 8:30, në rrugën "Afrim Zhitija", p.n., në objektin e Administratës Pensionale, në Mitrovicë, aktivistët nga radhët e subjektit politik LVV kanë vendosur posterat e kandidatit të tyre për deputet të Kuvendit të Kosovës.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës ligjore i Nenit 33 paragrafi 1 pika b e LZP-së. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur pesë fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Koalicioni PDK-AAK-NISMA dega në Mitrovicë, me nr. 250/2017 të datës 12.06.2017, ka paraqitur kërkesë për tërheqje të ankesës Anr.250/2017, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje LVV dega në Mitrovicë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të ankesës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli vlerëson nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë rezulton se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në objekte publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), i LZP-së e cila përcakton: " Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike".

Duke u nisur nga gjendja e vlerësuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik, është shkelur neni 33, pika b), i LZP-së, pasi që posteret e kandidateve për deputet nga subjekti në fjalë, janë vendosur në ngjitur në objekte publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;

- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga subjekti politik LVV, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në objektin e Administratës Pensionale të Kosovës, pra në objekt publik .

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me nr.250/17 të datës 12.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.250/2017 të datës 12.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik LVV, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në mbështetje të nenit 54 par.1 i Ligjit për Procedurën Administrative është parashikuar që *"Tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim"*. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuar interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) i LZP-së,

lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - Anr.259/2017, Kërcënim dhe bartja me automjete e votuesve nga subjekti politik deri në QV në ditën e votimit

Subjekti politik N.N. përmes përfaqësuesit tij, ka paraqitur ankesë kundër koalicionit X.X., nën pretendimin se e njëjta ka shkelur nenin 11.3 të Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2013 të KQZ-së, duke bërë cenim të drejtës së përcaktimit të lirë të votuesit, ngase kanë zhvilluar fushatë jashtë qendrës së votimit për shkak se të njëjtit kanë bartur votues me automjete duke i dërguar në qendrën e votimit.

PZAP-i ankesën e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar, për faktin se në rastin konkret parashtruesja e ankesës nuk ka ofruar asnjë prove e cila do të vërtetonte pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës.

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar **ankesa Anr.259/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga subjekti politik, N.N..**

Arsyetim

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, N.N. në të cilën thekson se në qendrën e votimit në shkollën "7 shtatori" në fshatin Vitomicë, komuna Pejë, subjekti politik X.X. ka zhvilluar fushatë, jashtë shkollës, vendin e votimit dhe janë vërejtur duke bartur votues me makina. Pretenduesi i ankesës thekson se ky subjekt politik ka përdorur mjetet e kërcënimit ndaj A.R. kryesuesit të vendvotimit dhe kërcënuesi ka qenë V.P. lidhur me këtë zyrtarët policorë kanë qenë dëshmitarë të ngjarjes e nuk kanë reaguuar. Njëri nga policët me të cilën është identifikuar me numrin 4736. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë cenim të përcaktimit të lirë të votuesve, si dhe e nenit 11.3 të Rregullës 09/2013, kërcënim serioz për procesin e votimit. Parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti

politik X.X. me fushatën dhe presionin ndaj votuesve dhe ka bërë shkelje të Kodit Penal dhe Rregullores përkatëse zgjedhore.

Lidhur me rastin në fjale PZAP-i e njofto edhe Policinë e Kosovës dhe kërkoi nga ata që të ndërmarrin veprime konkrete.

Në raportin e policisë të datës 13.06.2017 theksohet se lidhur me rastin në fjale zyrtarët policor të caktuar në ruajtjen e rendit publik por edhe për të mundësuar votim të qetë ishin aty që nga fillimi i implementimit të planit operativ, mirëpo edhe përkundër kësaj nuk kane arritur që të vërejnë këtë person se ka hyre në këtë qendër të votimit. Por me të marr ankesën është vepruar me njësitet tjera reaguese dhe menjëherë e kanë identifikuar personin në fjale V.P. dhe mbi bazën e vendimit të Prokurorit Policia e Kosovës i njëjti është shoqëruar në stacionin policor në Pejë dhe është intervistuar nga ana e hetuesve rajonal por se nuk është iniciuar ndonjë procedure penale për shkak që sipas hetuesve kishte vetëm shkelje të rregullores së brendshme.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo provë materiale e cila do të vërtetonte pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Paneli konstatoi se ankesa refuzohet, nuk është e vërtetuar asnjë pretendim i parashtruesit të ankesës nga raporti i policisë në rastin konkret po ashtu as parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - Anr.264/2017, Presion tek votuesit për të votuar subjektin e caktuar politik dhe tentim për blerje të votave

Përfaqësuesi i subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë ka parashtruar ankesë në PZAP kundër Koalicionit X.X., nën pretendimin se janë bërë shkelje të nenit 215 të Kodit Penal të Kosovës pasi që gjatë ditës së votimit në vendvotimin me numër 1112B, koalicioni X.X. ka ushtruar presion tek votuesit dhe ka bërë blerje të votave.

PZAP-i ankesën e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar për faktin se parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë për ti provuar pretendimet e tij në ankesën e parashtruar.

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa **Anr.264/2017** e datës 12.06.2017, me të cilën është pretenduar se Koalicioni X.X. ka bërë presion tek votuesit dhe blerje të votës.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik N.N. me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së votimit në fshatin Kçiç i Madh, në afërsi të shkollës fillore "Bislim Imeri", me numër të vendvotimit 1112B, koalicioni X.X. ka ushtruar presion tek votuesit dhe blerje të votave. Më këtë rast pretendohet se është bërë shkelje e nenit 215 të Kodit Penal.

PZAP-i, me datë 13.06.2016, ka pranuar një raport informues nga Policia e Kosovës, Njësia e Hetimeve-Stacioni Policor Jugor-Mitrovicë, ku theksohet se me datën 11.06.2017, rreth orës 11.45, kanë pranuar një thirrje nga Zyrtarët Policor në fshatin Kçiç për një problem në qendër të votimit nr. 1112B. Së bashku me prokurorin kanë dalë në vendin e ngjarjes ku kanë kontaktuar me I.F. dhe R.F. të cilët kanë njoftuar se në një shtëpi e cila gjendet përballë shkollës në Kçiç, dyshohet se subjekti politik X.X. ka ushtruar presion ndaj votuesve dhe dyshohet për blerje të votave, por nuk ka pasur

persona të identifikuar me emër për të cilët dyshohet se kanë bërë presion ndaj votuesve.

Nga ana e Policisë është kontrolluar shtëpia në fjalë dhe askush nuk ka qenë aty, është vërtetuar se është shtëpi e pa banuar dhe se e njëjta shtëpi nuk ka as dyer e as dritare. Po ashtu prokurori ka kërkuar që të merren masa shtesë rreth këtij vendvotimi.

PZAP-i, pas shqyrtimit ankesës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në afërsi të shkollës "Bislim Imeri", fshatin Kçiç i Madh, monitoruesi i tyre ka vjetur se koalicioni N.N. ka ushtruar presion tek votuesit dhe blerje të votave.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së. Po ashtu, nuk është e specifikuar që ushtrimi i presionit dhe blerja e votave është bërë brenda rrethojave të vendvotimit por thuhet në afërsi të qendrës së vendvotimit dhe se në rastin konkret nuk ka persona të identifikuar nga Policia lidhur me pretendimet ankimore, ndërsa parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë për ti provuar pretendimet e tij si në ankesë, e në raste se pala ofron prova të reja në kuptim të nenit 118, paragrafi 4 të LPZ-së, PZAP do ta rishqyrton vendimin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - Anr.266/2017,

Votimi është lejuar pa u kontrolluar gjurmët e gishtërinjëve të votuesve me llamba ultraviolete dhe sprej

Subjekti politik N.N. ka paraqitur ankesë për shkak se në vendvotimin me numër 2101b, kryesuesi i këtij vendvotimi ka lejuar votuesit të votojnë pa iu marr gjurmët e gishtërinjëve dhe pa iu verifikuar të njëjtat përmes llambës ultraviolete dhe sprej.

PZAP-i duke u bazuar në nenet 117. paragrafi 2 dhe 3 dhe nenin 118. paragrafi 1 ankesën e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar, për faktin se në rastin konkret nga prova e ofruara nuk ka mundur të vërtetohet-identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është kryer shkelja e pretenduar në ankesë.

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.266/2017 e datës 12.06.2017, e subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, lidhur me votimin e votuesve pa ju marr gjurmët, pa përdorur llampë e as sprej, në qendrën e votimit numër 2101b, në Voinik, Komuna e Skenderajt.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së zgjedhjeve, me datën 11.06.2017, komisionerët e subjektit politik N.N. në shkollën "Skender Skenderi" në qendrën e votimit 2101b, në Voinik-Skenderaj, ka konstatuar se kryesuesi i këtij vendvotimi, ka lejuar që votuesit të votojnë pa ju marr gjurmët, pa u kontrolluar me llampë e as sprej dhe se komisionerët e tyre nuk kanë mundur ti ndalojnë këto veprime të jashtëligjshme, të njëjtit nuk janë lejuar që evidentojnë shkeljet në libër të votimit. Për këto arsye sipas dispozitave të rregullës zgjedhore kemi të bëjmë me shkelje të votimit të rregullt.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave-deklaratave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Sepse

nga prova e ofruara nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është kryer shkelja e pretenduar në ankesë, kjo dëshkohet edhe nga deklarata e Kryesuesit i KVV-së, të qendrës së vendvotimit 2101b, R,R, i cili në dëshminë e deponuar me datën 13.06.2017, për PZAP-it, ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet si në ankesë për faktin se komisionerët e subjektit N.N. kanë qenë të vendosur në pikat kyqe në vendvotim, njëri tek dera me llampë e tjetri tek libri i votimit dhe se ka pasur vetëm tendencë të votuesve për të hyr në vendvotim por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Po ashtu kryesuesi i vendvotimit deklaroi se çdo gjë është e shënuar në libër të votimit si dhe deklaratat e komisioneve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje të cilët janë larguar nga vendvotimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nën 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - Anr.277/2017, Thyerja e heshtjes zgjedhore

Organizata Jo Qeveritare N.N. ka parashtruar ankesë në PZAP, me pretendimin se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, me të cilën thekson se T.H. kandidat për deputet nga koalicioni X.X. gjatë heshtjes zgjedhore ka bërë fushatë zgjedhore në rrjetin e saj social Facebook, duke bërë thirrje votuesve që të votohet për të dhe për kandidatin për kryeministër.

PZAP-i ka gjetur se Koalicioni X.X. është përgjegjëse për veprimet e tij duke shkelur nën 36. paragrafi 1 pika b) të LZP-së, sepse në dispozitivin e lartcekur është përcaktuar se në periudhën e heshtjes zgjedhore është e ndaluar " bërja e fushatës në çfarëdo mënyre".

VENDIM

Pranohet si e bazuar ankesa e OJQ-së N.N. ashtu që Koalicionit X.X. i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

Arsyetim

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga OJQ N.N. me të cilën pretendon se T.H. kandidate për deputete nga koalicioni X.X. ka bërë fushatë në rrjetin social Facebook në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Parashtuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se si kandidatja për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës T.H. nga radhët e koalicionit X.X. gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetin e saj social facebook ka bërë fushatë zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet nr 12 dhe kandidati për kryeminister R.H. ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Koalicioni X.X. është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - A.nr. 322/2017, Gabim në plotësimin e Formularëve të Rezultateve të Kandidatëve – FRK në vendvotim

Kandidati N.N. i subjekti politik M.M. dega në Viti në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar ankesë me datë 13 qershor 2017 kundër X.X. dega në Sllatina e Epërme, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve në vendvotim në ditën e votimit, ngase në vendvotimin me nr.2607d/01 me rastin e plotësimit të Formularit të Rezultateve të Kandidateve (FRK) janë shënuar gabimisht votat e kandidatit me numër 79 tek kandidati me numër 78, sepse kandidati me numër 79 i ka pasur 54 vota e të cilat siç u theksua me lartë ju kanë shënuar kandidatit me numër 78.

PZAP-i, ankesën e parashtruar ka hedhur si të pasafatshme për arsye se me dispozitën e nenit 5.3 të Rregullores Nr. 02/2015, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, ankesa duhet të paraqitet në PZAP brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit. Afati për paraqitjen e ankesës ka qenë deri me datën 12.06.2017 në ora 19:00, ndërsa ankuesi e ka parashtruar ankesën në PZAP me datën 13.06.2017, që rezulton të jetë pas afatit ligjor të përcaktuar .

VENDIM

HUDHET si e pasafatshme ankesa Anr.322/2017, të datës 13.06.2017, parashtruar nga subjekti politik N.N. dega në Viti, për shkak të parregullësive gjatë procesit të votimit me datë 11.06.2017.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datë 13 qershor 2017, nga subjekti politik N.N. dega në Viti me të cilën pretendon se nëvendvotimin VV nr.2607d/01 Në Sllatin të Epërme gjatë shënimit të FRPP-së janë ngatëruar votat e kandidatëve me numërin 79 dhe numërin 78, prandaj kandidati me numër 79 i ka pasur 54 vota kurse gabimisht ju kanë shënuar kandidatit me numër 78. Parashtruesi i

ankesës PZAP-it i ka kërkuar që ta bëjë përmirësimin e votave mes dy kandidatëve. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 2 kopje të formularëve të rezultateve zgjedhore.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të afatshmerisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 5.3 të Rregullores Nr. 02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa e njëjta është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi i ankesës me datë 13.06.2017. Nga përmbajtje e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi ndërliidhen me procesin e votimit.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjore për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesës ka qenë me datën 12.06.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e tij e ka parashtruar në PZAP me datë 13.06.2017, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5.3 të Rregullores Nr. 02/2015 lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - A.nr. 341/ 2017, Votuesit janë lejuar të votojnë me dokumente të shtetit tjetër

Subjektit politik N.N. më datë 13.06.2017 në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka parashtruar ankesat A.nr. 341/2017, A.nr. 342/2017, A.nr. 343/2017, A.nr. 344/2017, A.nr. 345/2017, A.nr. 346/2017, A.nr. 347/2017, A.nr. 348/2017, A.nr. 349/2017, A.nr. 350/2017, A.nr. 351/2017, A.nr. 352/2017 dhe A.nr. 353/2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor

në ditën e votimit.

PZAP-i, ankesat e parashtruara i ka hedhur si të pasafatshme për arsye se, me dispozitën nenit 119. paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) lidhur me nenin 6. paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it Nr.02/2015 është parashikuar që ankesa mund të paraqitet në PZAP brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit. Në këtë rast afati ligjor për paraqitjen e ankesave ka qenë deri me datën 12.06.2017 në ora 19:00, ndërkaq ankuesi i ka parashtruar ankesat në PZAP me datë 13.06.2017.

VENDIM

Hudhen si të pasafatshme ankesat e Partija Kosovskih Srba (PKS), me seli në Komunë e Leposaviqit Anr. 341/2017, Anr. 342/2017, Anr. 343/2017, Anr. 344/2017, Anr. 345/2017, Anr. 346/2017, Anr. 347/2017, Anr. 348/2017, Anr. 349/2017, Anr. 350/2017, Anr. 351/2017, Anr. 352/2017 dhe Anr. 353/2017 të datës 14.06.2017, paraqitur kundër X.X. për shkak të parregullësive gjatë procesit të votimit me datë 11.06.2017.

Arsyetim

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat Anr. 341/2017, Anr. 342/2017, Anr. 343/2017, Anr. 344/2017, Anr. 345/2017, Anr. 346/2017, Anr. 347/2017, Anr. 348/2017, Anr. 349/2017, Anr. 350/2017, Anr. 351/2017, Anr. 352/2017 dhe Anr. 353/2017 të datës 14.06.2017, dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me Anr. 341/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP, më datë 13.06.2017, ka pranuar ankesat nga N.N. me seli në Komunë e Leposaviqit, paraqitur kundër X.X. në të cilat kanë theksuar se:

Ankesa Anr. 341/2017, është e parashtruar nga J.S. me të cilën pretendohet se X.X. ka lejuar që votues me dokumente të Serbisë të votojnë si votues të rregullt edhe pse ka qenë kutia e votimit që të votohet me kusht në Vendvotimin 1203b/02D.

Ankesa Anr. 342/2017, është e parashtruar nga J.V. me të cilën pretendohet se X.X. ka lejuar që votues me dokumente të Serbisë të votojnë si votues të rregullt edhe pse ka qenë kutia e votimit që të votohet me kusht ne Vendvotimin 1202b/04D. Për më tepër parashtruesja e ankesës thekson në ankesë se ju është bërë presion nga përfaqësuesi i X.X. në vendvotim që të lejohen të votojnë votuesit edhe pse nuk ishte në harmoni me rregullat zgjedhore.

Ankesa Anr. 343/2017, është e parashtruar nga R.S. me të cilën pretendohet se X.X. ka lejuar që votues me dokumente të Serbisë të votojnë si votues të rregullt edhe pse ka qenë kutia e votimit që të votohet me kusht ne Vendvotimin 1211b/01D.

Ankesa Anr. 344/2017, është e parashtruar nga M.K. me të cilën pretendohet se X.X. ka lejuar që votues me dokumente të Serbisë të votojnë si votues të rregullt edhe pse ka qenë kutia e votimit që të votohet me kusht ne Vendvotimin 1205b/01R.

Ankesa Anr. 345/2017, është e parashtruar nga B.P. me të cilën pretendohet se një votues ka votuar me kusht në VV1202b/04D, sepse kur i njëjti ka shkuar të voton në VV e tij të rregullt ka rezultuar se gjendet e nënshkruar rubrika e tij në librin e votuesve. Poashtu parashtruesja e ankesës thekson se një aktiviste e L.S. në VV të lartpërmendur, ka bërë presion ndaj disa votuesve që ta votojnë partinë e saj.

Ankesa Anr. 346/2017, është e parashtruar nga G.P. me të cilën pretendohet se X.X. ka lejuar që votues me dokumente të Serbisë të votojnë si votues të rregullt edhe pse ka qenë kutia e votimit që të votohet me kusht ne Vendvotimin 1201b/04D.

Ankesa Anr. 347/2017, është e parashtruar nga V.P. me të cilën pretendohet se X.X. ka lejuar që votues me dokumente të Serbisë të votojnë si votues të rregullt edhe pse ka qenë kutia e votimit që të votohet me kusht ne Vendvotimin 1201b/03R, po ashtu sipas parashtruesit të ankesës, në këtë VV ka ardhur edhe kryetari i Komunës së Leposaviqit, sipas sistemit të Kosovës dhe ka uluruar duke thënë se tradhtar për kënd punoni ju sepse këtu duhet të votohet me letërnjoftime të Serbisë.

Ankesa Anr. 348/2017, është e parashtruar nga M.S. me të cilën pretendohet se votues të cilët kanë ardhur nga Serbia, përveç letërnjoftimit të Serbisë, nuk kanë poseduar dokumentet e personave të zhvendosur nga Kosova, ne Vendvotimin 1205b/05D.

Ankesa Anr. 349/2017, është e parashtruar nga A.B. me të cilën pretendohet se votues të cilët kanë ardhur nga Serbia, përveç letërnjoftimit të Serbisë, nuk kanë poseduar dokumente e personave të zhvendosur nga Kosova, ne Vendvotimin 1208b/01D.

Ankesa Anr. 350/2017, është e parashtruar nga M.N. me të cilën pretendohet se, në shkollën fillore "Vuk Karadzic" ne Vendvotimin 1202b/02R, votues me dokumente të Serbisë, kanë votuar si votues të rregullt edhe pse ka qenë kutia e votimit që të votohet me kusht.

Ankesa Anr. 351/2017, është e parashtruar nga S.V. me të cilën pretendohet se votues të cilët kanë ardhur nga Serbia, përveç letërnjoftimit të Serbisë, nuk kanë poseduar dokumentet e personave të zhvendosur nga Kosova, ne Vendvotimin 1205b/05D.

Ankesa Anr. 352/2017, është e parashtruar nga J.V. me të cilën pretendohet se X.X. ka lejuar që votues me dokumente të Serbisë të votojnë si votues të rregullt edhe pse ka qenë kutia e votimit që të votohet me kusht ne Vendvotimin 1202b/03R.

Ankesa Anr. 353/2017, është e parashtruar nga Z.B. me të cilën pretendohet se X.X. ka lejuar që votues me dokumente të Serbisë të votojnë si votues të rregullt edhe pse ka qenë kutia e votimit që të votohet me kusht ne Vendvotimin 1202b/04B. Mëtëj parashtruesi i ankesës thekson se anëtari i KVV-së, nuk e ka lejuar që ta evidenton presionin e X.X.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të afatshmerinë së ankesave gjeti se:

Ankesat janë të pasafatshme

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 119 par.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesat të njëjtat janë dorëzuar në PZAP, nga parashtruesit e ankesave me datë 13.06.2017. Nga përmbajtja e ankesave rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruar nga ankuesit në ankesat Anr. 341/2017, Anr. 342/2017, Anr. 343/2017, Anr. 344/2017, Anr. 345/2017, Anr. 346/2017, Anr. 347/2017, Anr. 348/2017, Anr. 349/2017, Anr. 350/2017, Anr. 351/2017, Anr. 352/2017 dhe Anr. 353/2017 të datës 14.06.2017, ndërlidhen me

parregullsitë gjatë procesit të votimit, në ditën e votimit të datës 11.06.2017.

Nga kjo rezulton se ankesat e lartpërmendur janë dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjore për të parashtruar ankesa në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 12.06.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesit ankesat e tyre i kanë parashtruar në PZAP me datë 13.06.2017, që do të thotë se ankesat janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 par.1 të LZP-së, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

VENDIMI – A.nr. 358/2017, Shpallja e rezultateve preliminare

Kandidati për deputet N.N. nga subjekti politik X.X. komuna e Prizrenit, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar ankesë me datën 21.06.2017 kundër Y.Y. në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 2004a/07r, për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, sepse rezultatet nuk përputhen me ato të shpallura nga KQZ-ja. Ka propozuar që të përmirësohet gabimi në numërimin e fletëvotimeve.

PZAP-i ankesën e parashtruar e ka hedhur si të pa lejuar për arsye se, me dispozitën nenin 105. të LZP-së përcaktohet qartë se, palët me interes ligjor mund të parashtrojnë ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së.

Paneli vlerëson se në rastin konkret KQZ-ja, nuk e ka shpallur rezultatin përfundimtar, por rezultati të cilit i referohet pala ankuese në këtë fazë të procesit zgjedhor është rezultat jo përfundimtar dhe i ndryshueshëm në çdo moment, andaj ankesa është hedhë si e palejuar.

PZAP-i ka vlerësuar pasi që ka konstatuar se rezultati i procesit të numërimit të fletëvotimeve është i ankueshëm në afat prej 24 orëve, vetëm kur KQZ-ja merr vendim dhe e bën shpalljen e rezultatit përfundimtar në mënyrë publike.

VENDIM

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 358/2017 e datës 21.06.2017, e parashtruar N.N. nga Prizreni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik X.X.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 21.06.2017, ka pranuar ankesën Anr. 358/2017, N.N. nga Prizreni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik X.X. në të cilën pretendohet se në qendrën e votimit në shkollën "Motrat Qiriazit", nr. 2004a/07r, në Prizren, nuk përputhen rezultatet nga ato që i ka shpallur KQZ-ja dhe të cilat ata i posedojnë. Sipas raportit të vëzhguesit numri i votave të kandidatit N.N. është 81 vota, ndërsa në formular janë regjistruar vetëm 5 vota. Parashtruesi i ankesës PZAP-it i ka kërkuar që të bëjë përmirësimin e këtij gabimi me numërimin e votave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa e parashtruar nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik X.X. është e palejuar, për arsyes se rezultati preliminar ende nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, e po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR, ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj, rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, dhe se në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesë në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e lartcekura dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se "PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet" dhe nenit 6.4

te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: "Ankesat të cilat janë të palejuar dhe te pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim", lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI – A.nr. 386/2017, Shpallja e rezultateve përfundimtare (Pas rinumërimit të fletëvotimeve për kandidat, është ndryshuar rezultati përfundimtar dhe është ndryshuar rezultati i renditjes së kandidatëve për deputet, sipas rezultatit që ka rezultuar nga rinumrimi i fletëvotimeve, me vendim të PZAP-it)

Kandidati për deputet N.N. nga koalicioni X.X., ka parashtruar ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), duke e kontestuar vendimin e KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të publikuar me datë 29.06.2017, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2512D/02D gjatë plotësimit të Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK-së) komisionarët kanë bërë gabim teknik, dhe votat e tij i janë bartur tek kandidatja me nr.18, Y.Y., e që do të duhej të jenë të kandidati me nr. 17, dhe ka kërkuar nga Paneli që fletëvotimet e vendvotimit të lartëpërmendur të rinumërohen.

PZAP-i, Ankesën e parashtruar e gjeti si të bazuar për arsye se, ka konstatuar mos përputhje nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK-ja) në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve me FRK-në e plotësuar në vendvotimin 2512/02D, se kandidati me nr. 17 N.N., nga radhët e subjektit politik X.X. Komuna e Ferizajt i cili ka 0 vota në FRK-në. Pas rinumërimit të fletëvotimeve në QNR-në nga Paneli, ka rezultuar se i njëjti i ka 30 fletëvotime të vlefshme në kutinë e votimit.

Paneli në mbështetje të nenit 117. paragrafi 4 ka urdhëruar KQZ-në që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni X.X. në Vendvotimin 2512D/02D, ndërkaq, rezultati i dalë nga rinumërimi i kutisë së votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të vendimit të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

PZAP-i ka vendosur që kryesuesit të vendvotimit të lartëpërmendur t'i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuar nën autoritetin e KQZ-së në kuptim të nenin 120 paragrafi 3, pika d), të LZP-së.

VENDIM

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, N.N. nga koalicioni X.X..

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni X.X. në Vendvotimin 2512D/02D,

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Venvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

IV. M.M. me nr. të letërnjoftimit 00000, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 2512D/02D, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.06.2017, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës N.N. nga radhët e koalicionit X.X. me të cilën pretendon se në vendvotimin 2512D/02D gjatë plotësimit të FRK-së komisionerët kanë bërë gabim teknik dhe se votat e tij janë bartur tek kandidatja me nr.18 Y.Y. dhe kërkon që të bëhet rinumërimi votave të këtij VV.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e

pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 2512/02D është konstatuar nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) -ja në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), se kandidati me nr. 17 N.N. nga radhët e subjektit politik X.X. Komuna e Ferizajt i cili ka poseduar 0 vota në FRK-në e vjetër e cila është plotësuar në VV 2512D/02D i ndërsa pas rinumërimit në QNR i njëjti i posedon 30 vota.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II dispozitivit.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkitazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesueses së vendvotimit, për pjesëmarrjen në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidate dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës i janë regjistruar 0 vota në FRK, ndonëse pas hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 30 vota.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

**VENDIMI – A.nr. 407/2017,
Shpallja e rezultateve përfundimtare (Pas rinumërimit të fletëvotimeve për kandidat, është ndryshuar rezultati përfundimtar dhe është ndryshuar rezultati i renditjes së kandidatëve për deputet, sipas rezultatit që ka rezultuar nga rinumrimi i fletëvotimeve, me vendim të PZAP-it)**

X.X., kandidate për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga subjekti politik N.N. në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka parashtruar ankesat A.nr. 407/2017, dhe A.nr 420/2017, duke kontestuar rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës. Parashtruesja pretendon se gjatë rinumërimit të materialit zgjedhor nga vendvotimi 2303d/03R, janë vërtetuar shumë parregullsi-shkelje, si votimi me asistencë në më shumë se 1000 raste. Sipas pretendimeve në ankesë parregullsi të ngjashme janë evidentuar edhe në vendvotimet; 2303d/01R, 2303d/02R, 2303d/03R, 2303d/04R, 2304d/01R, 2304d/02D, 2306d/02R, 2308d/02R, duke theksuar se procesverbalet origjinale nga vendvotimet e theksuara nuk përkojnë me gjendjen e saktë - faktike në kutitë e votimit.

PZAP-i, ankesat e parashtruara i pranoi si të bazuara pasi që ka konstatuar se kishte mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit të Përputhjes së Rezultatit, dhe ka urdhëruar KQZ-në që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për të gjitha subjektet politike dhe të të gjithë kandidatëve të tyre në Vendvotimet: 2303d/01R, 2303d/02R, 2303d/03R, 2303d/04R, 2304d/01R, 2304d/02D, 2306d/02R, 2308d/02R, ndërsa rezultatin i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve të kutive të votimeve në VV (si në pikën- II- të vendimit), të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

VENDIM

I. Pranohen si te bazuara ankesat Anr. 407/2017 dhe Anr. 420/2017 të datës 30.06.2017, te Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, X.X. nga subjekti politik N.N..

II. Urdhërohet Komisioni Qendrori Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për të gjitha subjektet politike dhe të gjithë kandidatëve të tyre në Vendvotimet: 2303d/01R, 2303d/02R, 2303d/03R, 2303d/04R, 2304d/01R, 2304d/02D, 2306d/02R, 2308d/02R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive te votimeve në Vendvotimet si në pikën- II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

Arsyetim

X.X. nga subjekti politik N.N. me datën 30.06.2017 ka paraqitur në PZAP, ankesat me numër Anr. 407/2017, dhe Anr 420/2017.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, i ka bashkuar ankesat Anr. 407/2017, dhe Anr 420/2017 të datës 30.06.2017, dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me Anr. 407/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nga ankesat e paraqitura nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës X.X. nga subjekti politik N.N. pretendohet se gjatë rinumërimit të materialit zgjedhor nga vendvotimi 2303d/03R në komunën e Shtërpcës, janë vërtetuar shumë parregullsi. Parashtruesi i ankesës thekson se këto shkelje i ka kuptuar me datë 29.06.2017 në ora 14:00 nga momenti i publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja. Po ashtu ai thekson se ka pas parregullsi të karakterit të njëjtë edhe në vendvotimet në vijim ku është parë qartazi se procesverbalet origjinale nga vendvotimet e theksuar nuk përmbajnë gjendje e saktë faktike në kutitë të votimit:

1. 2303d/01R në komunën e Shtërpcës
2. 2303d/02R në komunën e Shtërpcës

3. 2303d/04R në komunën e Shtërpcës
4. 2304d/01R në komunën e Shtërpcës
5. 2304d/02D në komunën e Shtërpcës
6. 2306d/02R në komunën e Shtërpcës
7. 2308d/02R në komunën e Shtërpcës

Sipas pretendimeve në ankesë në nivelin e komunës së Shtërpcës është raportuar votimi me asistencë në më shumë se 1000 raste, gjë e cila tregon se kjo është përqindja më e lartë e kësaj lloji të votimit në gjithë procesin zgjedhor. Nëse merret parasysh se në nivel të Komunës së Shtërpcës dalja përgjithshme është diku rreth 6000 qytetarë, atëherë del se diku 20% të votave janë votat nga votimi me asistencë.

Parashtruesi i ankesës më tutje thekson se të gjitha pretendimet e theksuara mund të vërtetohen me qasje në kutinë e votimit me nr. 2303d/03R, duke e shikuar listën e votuesve me nënshkrimet e votuesve, ku sjelljet e tilla janë padyshim shkelje e rëndë e shumë neneve të LZP-së dhe Kodit Penal të Kosovës. Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që kjo ankesë të pranohet si e bazuar dhe ti vërtetoj shkeljet e pretenduara.

Si prova është bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularët e Përputhjes së të dhënave për vendvotimet e lartcekura, si dhe të dhënat e publikuara nga KQZ-ja.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për të gjitha subjektet politike dhe të gjithë kandidatët e tyre për

vendvotimet 2303d/01R, 2303d/02R, 2303d/03R, 2303d/04R, 2304d/01R, 2304d/02D, 2306d/02R, 2308d/02R, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



ZGJEDHJET

LOKALE - 2017

VENDIMI - ZL.Anr.01/2017, Mos emërimi i anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ-së)

Subjektit politik X.X., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apel duke e kontestuar vendimin e KQZ-së për mos emërimin e anëtarëve të KKZ-së.

Parashtruesi i apelit pretendon se KQZ-ja nuk e ka emëruar për anëtarë të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Suharekë, si në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës ashtu edhe në Zgjedhjet e Rregullta Lokale. Sipas pretendimeve në apel subjekti politik X.X., janë fitues nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

PZAP-i, apelin e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar sipas dispozitave të nenit 118. paragrafi 1 të LZP-së, si dhe nenit 11. paragrafi 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, duke vlerësuar si të bazuara pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit, se nuk i janë marrë për bazë rezultatet për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të vitit 2017, pasi që me rastin e emërimit të anëtarëve të komisionit komunal zgjedhor merren për bazë rezultatet e zgjedhjeve të fundit të certifikuara, e që në rastin konkret deri në emërimin e KKZ-ve nuk kanë qenë të certifikuara Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të vitit 2017.

VENDIM

REFUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik X.X. me seli në Suharekë i parashtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) lidhur me emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Komunën e Suharekës.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një apel nëpërmjet postës nga subjekti politik X.X. me seli në Suharekë me datën 06.07.2017 të dorëzuar nëpërmjet postës më datë 04.07.2017, kundër vendimit të KQZ-së me të cilin pretendon se KQZ nuk ka pranuar anëtarë të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Suharekë si në Zgjedhjet e

Parakohshme Parlamentare ashtu edhe në Zgjedhjet e Rregullta Lokale. Parashtruesi i apelit thekson se si subjekt politik X.X. janë fitues nga radhët e komunitetit të Suharekës.

Parashtruesi i apelit ka kërkuar nga PZAP-i që ti mundësohet pranimit të anëtarit të subjektit të tij politik Ali Shabanaj .

Në përgjigjen e ofruar nga KQZ theksohet se KQZ me datën 03.07.2017 ka marrë vendim me Nr. 1185/2017 për emërimin e anëtarëve të KKZ-ve për Zgjedhjet Lokale 2017 dhe se kriter për emërimin e KKZ-ve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2017 dhe Zgjedhjet Lokale 2017 ka qene rezultati i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të vitit 2017. Andaj duke u bazuar e këto rezultate e vitit 2014 ne nivel komunal në Suharekë subjekti politik Y.Y. ka fituar më shumë vota në nivel komunal për komunën e Suharekës.

Paneli pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli i ka vlerësuar apelin e parashtruar dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, se pala parashtruese e apelit ka të drejtën e parashtrimit të apelit dhe se PZAP-i ka kompetencën e shqyrtimit të apeleve dhe të nxjerrë vendime për apelimet e tilla. Paneli ka gjetur se përveç pretendimeve të thëna si më lartë, pala parashtruese nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet e parashtruara në apel.

Paneli vlerëson se, pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit Nr.1185 të datës 03.07.2017 nga KQZ-ja për nominimin e anëtarëve për KKZ në Komunën e Suharekës i është bërë e padrejte dhe se subjekti politik X.X. ka fituar në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2017 më shumë vota se partit të komuniteteve tjera minoritare janë të paqëndrueshme ngase KQZ me rastin e nominimeve të anëtarëve të KKZ-ve për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më datë 22.10.2017 si kriter ka marrë rezultatet e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të vitit 2014 të fituara në nivel komunal nga ana e subjekteve politike. Prandaj në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të vitit 2014 në nivel komunal subjekti politik Y.Y. ka fituar më shume vota se subjekti politik X.X.

Ndërsa lidhur me pretendimin e parashtruar në apel se në zgjedhjet e fundit të parakohshme parlamentare 2017 subjekti politik X.X. ka fituar më shume vota, Paneli vendosi se këto pretendime nuk kanë referencë ligjore për tu marrë si bazë pasi që rezultatet e parakohshme parlamentare 2017 ende nuk janë certifikuar dhe se ky kriter nuk mund të merret si bazë tani për tani.

Mbi këtë bazë Paneli vlerëson se vendimi i apeluar i KQZ-së, për nominimin e kandidatit të KKZ-së në Komunën e Suharekës, është i bazuar në ligj dhe është në harmoni të plotë me nenin 67 par. 1 dhe 3 të LQP-se në të cilin KQZ-ja është përpjekur dhe ka garantuar përfaqësimin e drejtë të KKZ-së, në komunën e theksuar më lart, për të gjitha komunitetet me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LQP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIM - ZL.Anr.28/2017,

De certifikim i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal

N.A., kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime nga subjekti politik X.X. dega në Shtime, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apel për shkak të de certifikimit nga lista e kandidatëve (si kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime) në Zgjedhjet Lokale 2017. Parashtruesja e apelit pretendon se KQZ-ja, e ka de certifikuar në mënyrë të padrejtë nga lista e kandidatëve për anëtare të Kuvendiit Komunal dhe ka kërkuar nga PZAP-i që të bëjë anulimin e vendimin Nr.1623/31-2017 datë 12.09.2017, të KQZ-së, për de certifikimin e saj, si kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në X.X., pasi që ka kryer obligimin/pagimin e dënimit të shqiptuar sipas aktgjykimit P.nr 3913/2015, të datës 05.02.2016, të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

PZAP-i apelin e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar për arsye se dispozita e nenit 29. paragrafi 1 pika q) i LQP-së, përcakton se cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve është i aftë për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor

për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit, siç edhe është në rastin konkret N.A.. Paneli ka vlerësuar se pretendimet janë të paqëndrueshme dhe vendimin e KQZ-së, e ka vlerësuar të ligjshëm në kuptim të nenit 29. paragrafi 1 pika q) i LZP-së.

VENDIM

REFUZOHET si i pabazuar apeli i N.A. për anulimin e vendimit Nr. 1623/31-2017, datë 12.09.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, me të cilin, parashtruesja e apelit është decertifikuar si kandidatë për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime nga subjekti politik X.X. për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datën 22.10.2017.

Arsyetim

Parashtruesja e apelit N.A. kandidatë për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik X.X., me datën 14.09.2017, ka paraqitur një apel në PZAP, kundër vendimit Nr. 1623/31-2017 datë 12.09.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin pretendon se KQZ-ja, e ka decertifikuar nga lista e kandidatëve për Kuvendin Komunal, në mënyrë të padrejtë. Andaj parashtruesja i apelit kërkon nga PZAP-i, që ta anulon vendimin Nr. 1623/31-2017 datë 12.09.2017, të KQZ-së, lidhur me decertifikimin e saj, nga gara si kandidatë për anëtare të Kuvendit Komunal të AAK-së, në Shtime, pasi që e njëjta thekson se e ka kryer obligimin e dënimit të shqiptuar me gjobë sipas aktgjykimit P.nr 3913/2015, të datës 05.02.2016, të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

KQZ-ja, në përgjigjen në ankesë ka theksuar, se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), që të bëjë verifikimin e kandidatëve që marrin pjesë në garë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22 tetor 2017, nëse të njëjtit janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Në këtë rast N.A. kandidatë për Kuvendin Komunal në Shtime nga subjekti politik X.X. është i dënuar për vepër penale, në bazë të Aktgjykimit P.nr 3913/2015, të datës 05.02.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm

me datën 01.03.2016. Andaj KQZ-ja, pretendon në përgjigjen në ankesë se ka vepruar konform nenit 29 par.4,të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), me rastin e marrjes së vendimit nr.1623/31-2017, që kandidatja N.A. të decertifikohet si kandidate e listës së subjektit politik X.X. me propozim për panelin e PZAP-it, që apeli të refuzohet si i pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së ,dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtrueses të apelit se me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1623/31-2017 datë 12.09.2017, nga KQZ-ja, lidhur me decertifikimin e saj nga gara e listës së kandidatëve për anëtarë të Kuvendin Komunal në Shtime, ju është bërë e pa drejtë ngase obligimet-gjobën e shqiptuar me Aktgjykimin P.nr 3931/2015 të datës 05.02.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e ka bërë brenda afatit të caktuar me aktgjykimin e lartpërmendur. Paneli vlerëson se pretendimet e parashtrueses së ankesës janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj dhe si të tilla u refuzuan bazuar në neni 29 par.1 pika q) i LZP-së, i cili përcakton se; cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i aftë për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit, siç edhe është në rastin konkret ngase kandidatja për anëtare te Kuvendit Komunal ne Shtime, N.A. me Aktgjykimin P.nr 3931/2015 të datës 05.02.2016, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 01.03.2016, është shpallur fajtor për veprën penale ne tri (3) vitet e fundit para certifikimit.

Mbi këtë bazë Paneli, konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1623/31-2017 datë 12.09.2017, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 29 par. 4 të LZP-së, pasi që kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, N.A. nga radhët e subjektit politik X.X. pasi që është certifikuar nga KQZ-ja, si kandidatë, me

të dhënat që kanë rezultuar nga KGJK-ja, e ka humbur aftësinë për te qenë kandidatë sipas dispozitës ligjore të nenit 29 par.1 pika q), të LZP-së, pasi i njëjti është shpallur fajtor për vepër penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas aktgjykimit, P.nr 3913/2015 të datës 05.02.2016, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, është bërë i bërë i plotfuqishëm me datën 01.03.2016. Mbi këtë bazë vendimi i KQZ-së, për dërcetifikimin e apelueses dhe largimin e ti nga lista e kandidatëve të subjektit politik është i ligjshëm dhe çdo pretendim në apel është i pa qëndrueshëm.

Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh edhe dispozitën e nenit 45 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se: *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”*. Kjo e drejtë e garantuar me Kushtetutë parashtrueses së apelit nuk ju është kufizuar me vendimin e ankimuar të KQZ-së, pasi që pikërisht me nenin 55 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *“Te drejtat dhe liritë themelore të garantuar me këtë Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj”*. Ndërsa, në rastin konkret kjo e drejtë parashtrueses së apelit për tu zgjedhur ju është kufizuar me nenin 29 par.4, të LZP-së, pasi që parashtruesja e apelit e ka humbur aftësinë për te qenë kandidatë sipas nenin 29 par.1 pika q), të LZP-së.

Sipas vlerësimit të panelit edhe përmbajtja e dispozitës së nenit 45 të Kushtetutës, *“gëzon të drejtën të zgjedh dhe të zgjedhet me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”* është komentuar, në komentarin e Gjykatës Kushtetuese, në këtë rast kemi të bëjmë me formën e dytë të mbrojtjes gjyqësore të kësaj të drejte, në kuptimin që Kushtetuta në këtë paragraf të nenit 45 paraqet prezumime për vendosjen e disa shkallëve dhe të formave të mbrojtjes së kësaj të drejte, e cila më vonë rregullohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Në vështrim të këtij Ligji, shkalla e parë dhe forma e mbrojtjes së kësaj të drejte është mbrojtja administrative brenda Komisionit Qendror Zgjedhor (neni 64 lidhur me nenin 98); e dyta është në PZAP si institucion i përhershëm dhe i pavaruar në përbërje prej gjyqtarëve (105; 118-119), ndërsa e treta është mbrojtja e plotë gjyqësore në Gjykatën Supreme të Kosovës (neni 118.4). Nga kjo rezulton se mbrojtja e të drejtës gjyqësore e

garantuar me Kushtetutë konsumohet me vendimin e PZAP-së dhe mundësinë që i njëjti të ankimohet në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL.Anr.67/2017, Nxitje e urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore

Subjekti politik N.N. me seli në Prishtinë, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik X.X., dega në Prizren, për shkak të nxitjes dhe urrejtjes, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, të datës 22.10.2017, ka theksuar se nga data 24.09.2017, në internet-në rrjetin social "facebook", ka qarkulluar një poster/foto, me mbishkrimin "Miku i turkut është vetëm turku", i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik X.X.. Ky postim sipas parashtruesit të ankesës, ka përmbajtur gjuhë të urrejtjes, dhe ngjallje të mosbesimit në raport me komunitet e tjera që jetojnë në Kosovë.

Paneli, duke u mbështetur në nenit 117. paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, e ka pranuar pjesërisht si të bazuar ankesën e subjektit politik N.N., dhe i ka shqiptuar gjobë në lartësi prej 300.00 € (treqind euro). Lidhur me pjesën e ankesës që ka të bëjë për distancim publik nga gjuha e nxitjes dhe urrejtjes të publikuar në rrjetin social "Facebook", e ka refuzuar si të pabazuar, pasi që ka vlerësuar se nuk ekziston rreziku që në të ardhmen të përsëriten veprimet e njëjta nga kandidati i subjektit politik i cili ka bërë thyerjen e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike.

VENDIM

I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar ankesae N.N. me seli në Prishtinë, subjektit politik X.X. dega në Prizren i shqiptohet dënimi me gjobë nëshumë prej 300.00 (treqind) euro, të cilën detyrohet ta

paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa e ankesës e N.N. me seli në Prishtinë, që kërkohet të detyrohet subjekti politik X.X. të distancohet publikisht nga gjuha nxitëse e publikuar në rrjetin social "Facebook" se "Miku i turkut është vetëm turku"

Arsyetim

Me datën 22.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga N.N. me të cilën pretendon se nga data 24.09.2017, nëpër internet është duke u sponsorizuar një poster i kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal nga radhët e subjekti politik X.X. e cila përmban gjuhë të urrejtjes, pasi që mbishkrimi në gjuhën turke mund të ndikojë në përçarjen në mes komuniteteve. Sllogani "Miku i turkut është vetëm turku" të cilin e përdor kandidati, bënë thirrje për ndarje dhe mos besim në komunitete të tjera që jetojnë në Kosovë.

Parashtruesi në ankesë po ashtu në seancën e shqyrtimit të kësaj çështje juridike me datë 28.09.2017, mbeti në tërësi pranë pretendimeve ankimore, duke theksuar se vet kryesuesi i supozuar në përgjigjen në ankesë e pranon se postimi i publikimit është bërë nga një simpatizant i subjektit politik X.X. prandaj sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik është dashur që të ndërmarrin masa dhe të distancohen nga ky publikim nga se legjislacioni në fuqi, për të gjitha veprimet që kryhen qoftë nga kandidati dhe simpatizantët apo militantët e tyre e mban përgjegjës subjektin politik, ku i njëjti propozoi për panelin që të ndërmerren veprime konform dispozitave ligjore si në rastin e thyerjes së kodit të mirësjelljes ndaj subjekteve politike.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik X.X. të datës 27.09.2017, si dhe në seancën e datës 28.09.2017, nuk e kanë pranuar shkeljen e pretenduar sipas ankesës të parashtruar nga N.N. Kandidati i X.X. i përfshirë në këtë ankesë S.K. ka deklaruar se personi i cili ka bërë postimin nuk është simpatizant i subjektit politik, sepse me këtë lloj postimi nuk është që i simpatizon po përkundrazi ia keqëson gjendjen. I njëjti thekson se ai në facebook e tij i ka mbi 2000 (dymijë) shok, andaj nuk mund ti kontrolloj se si mund të postojnë ata, ai thekson se për postimin e ka kuptuar pasi që është bërë

ankesa duke e kontaktuar personin që e ka publikuar dhe se i njëjti e ka fshirë postimin në fjalë, por se nuk ka mundur ta identifikoj se ai është simpatizant i subjektit politik X.X. Me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimi të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë dhe provat si në vijim: shikoj tri fotografi me ngjyra të formatit "A4".

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore provat e administruar secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe par 3 të LZP-së, gjeti se ankesa është e bazuar, për këto arsye:

Paneli nga tri fotografi me ngjyra të formatit "A4", ka konstatuar se kandidati i subjekti politik nga X.X. S.K. në facebookun e tij përmes një postimi me fotografi (poster), ka përdorur gjuhë të urrejtjes sepse ka qenë mbishkrimi "Miku i turkut është vetëm turku", veprime këto që nxisin provokime dhe urrejtje në mes komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë, ku me përdorimin e kësaj gjuhe të bërë në facebook, nxitet urrejtja kundër të tjerëve, që është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike të LZP-së..

Paneli, për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, ku kjo vërtetohet nga tri fotografit që gjenden në shkresat të lëndës të publikuara ne rrjetin social "facebook" e kandidatit S.K. nga subjekti politik X.X. e cila nuk është kundërshtuar se është postuar një mesazh siç pretendohet nga parashtruesi i ankesës, nga vet kandidati në seancën e mbajtur me datë 28.9.2017.

Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh edhe pretendimin e kandidatit S.K. nga subjekti politik X.X. se postimi nuk është bërë nga simpatizantët apo mbështetësit e subjektit politik X.X., mirëpo këtë pretendim paneli e vlerësoi si të pabazuar në ligj dhe të argumentuar. Ngase dispozita ligjore e nenit 33 pika (l) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: *Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: Përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon , ose që mund të nxisë ose provokoj një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave*

tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në pikën -I- dispozitiv të këtij vendimi mori parasysh shkeljet e lartpërmendura, dhe shqiptoj gjobën, duke u bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c) LZP-së, si dhe duke marr parasysh rrethanat si në vijim që kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë,
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore dhe
- Veprimet e ndërmarra nga subjekti politik për ta përmirësuar shkeljen e pretenduar në ankesë.

Refuzohet si e pabazuar pjesa e ankesës që kërkohet të detyrohet subjekti politik X.X. të distancohet publikisht nga gjuha nxitëse e publikuar në rrjetin social "Facebook" se "Miku i turkut është vetëm turku" sepse parashtruesi i ankesës nuk e ka bindur panelin, se subjekti politik X.X. ka qenë nxitëse apo e ka përkrahur një postim të kësaj natyre. Fakti se mesazhi lëndor është postuar nën emrin e kandidatit të subjektit politik X.X. paneli ka vendosur për subjektin politik si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi, mirëpo mesazhi i postuar ndërlidhet me kandidatin në fjalë dhe konsiderohet si mesazh i kandidatit e jo si mesazh i subjektit politik, prandaj paneli nuk ka gjetur arsye të bazuar që të detyrohet subjekti politik X.X. që publikisht të distancohet nga një mesazh i kësaj natyre, për këto arsye në këtë pjesë të ankesës vendosi si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, bazuar në nenin 32 par.2, 117, 118 par.1 dhe nenin 120 par.1 pika (c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL.Anr.70/2017, Vendosja e posterave në hapësira publike

Subjekti Politik N.N., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Y.Y. për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit në hapësirë publike në hyrje të fshatit X.X. të Komunës së X.X. gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017. Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se ka parregullsi apo thyerje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, nga subjektit politik Y.Y. ndërkaq ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi një fotografi nga vendi i lartcekur, dhe ka kërkuar që kundër subjektit politik Y.Y. të ndërmerren veprime ligjore.

PZAP-i ka refuzuar ankesën e parashtruar si të pa bazuar, dhe ka vlerësuar se posteri i ofruar si provë, e që pretendohet se është vendosur në hapësirë publike, nuk ndërlidhet me Zgjedhjet Lokale, dhe kohën kur edhe është zhvilluar fushata zgjedhore. Paneli ka gjetur se posteri për të cilin bëhet fjalë u takon Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 11.06.2017, dhe ka vlerësuar se nuk është në juridiksionin e panelit që të urdhëron subjektet politike që t'i largojnë posterët pas përfundimit të procesit zgjedhor, respektivisht të certifikimit të zgjedhjeve sepse një gjë e tillë nuk parashihet me legjislacionin zgjedhor.

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e N.N. me seli në Prishtinë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.70/2017, e datës 26.09.2017, me të cilën ka kërkuar që të ndërmerren veprimet ligjore kundër subjektit politik Y.Y. me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike-thyerjen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore.

Arsyetim

N.N. me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, me datë 26.09.2017, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke

i bashkangjitur si dëshmi një fotografi, nga vendi ku pretendohet së është bërë, thyerja e kodit të mirësjelljes për subjektet politike. Në ankesë është pretenduar se në hyrje të fshatit Komogllav të Komunës së Ferizajt kanë hasur në pano të kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjektit politik Y.Y. të vendosura në hapësirë publike. Ndërsa në seancën e panelit për shqyrtimin e kësaj çështje juridike, me datë 28.09.2017, dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i parashtruesit të ankesës ka deklaruar se, përkundër faktit se posteri në fjalë është i zgjedhjeve të kaluara parlamentare, mirëpo slogani i subjektit politik Vetëvendosje është “me zemër” e që është i njëjti edhe në këto zgjedhje, logoja e fushatës zgjedhore subjektit politik Vetëvendosje, është e njëjtë, posteri në fjalë nuk është tërhequr pas përfundimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe i njëjti është vendosur në hapësirë publike. Po ashtu përfaqësuesi i parashtruesit të ankesës në seancë ka theksuar se nuk kanë informata kur është vendosur posteri në fjalë, mirëpo e kanë vërejtur në kohën kur edhe kanë parashtruar ankesën. Me propozim për panelin që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Kryerësi i supozuar subjekti politik Y.Y. me seli në Prishtinë, si në përgjigje në ankesë ashtu edhe në seancën e panelit për shqyrtimin e kësaj çështje juridike, me datë 28.09.2017 dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit të saj, mbetet në tërësi si në përgjigje në ankesë dhe se slogani i subjektit politik Y.Y. në këto zgjedhje nuk është i njëjtë me zgjedhjet e kaluara parlamentare, ngase në këto zgjedhje slogani i subjektit të tyre politik është “voto me zemër e me mendje”, ndërsa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare ka qenë “voto me zemër”. Kandidatet të cilët gjenden në panon e cila i është bashkangjitur ankesës, nuk janë kandidat që garojnë në këto zgjedhje lokale. Gjithashtu, ka theksuar përfaqësuesi i Y.Y. se panoja është e vendosur nga fushata që ka pas të bëjë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Përfaqësuesi i subjektit politik Y.Y. mëtej ka theksuar se nuk e kanë tërhequr posterin në fjalë pasi që mirëmbajtjen e hapësirave publike e bënë Kuvendi Komunal, në këtë rast Komuna e Ferizajit. Për më tepër fotografia në fjalë nuk e ka asnjë efekt për këto zgjedhje dhe ankesa është e pas afatshme sepse, panoja në fjalë ka disa muaj që është vendosur në të vend. Me propozim për panelin që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë dhe provat si në vijim: shikoj dy fotografi nga vendi ku janë vendosur posterat në pano.

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore provat e administruar në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se ankesa është e pa bazuar, për këto arsye:

Paneli, për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, ndërsa në këtë rast parashtuesi i ankesës nuk e ka bindur panelin me pretendimet dhe dëshmitë e prezantuara siç është fotografia-posterin, se ka ndodhur thyerja e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike mbështetësit e tyre dhe kandidatët për zgjedhjet lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, sepse posterit i ofruar si provë që pretendohet se është e vendosur në hapësirë publike, nuk ndërlidhet me zgjedhjet lokale, e që është në këtë kohë është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, por posterit lëndore ka të bëjë me zgjedhjet e mbajtura parlamentare të datës 11.06.2017.

Në pyetjen e panelit në seancën e shqyrtimit të kësaj çështje juridike se kur është vendosur posterit në hapësirën që pretendohet se është publike, nga përgjigja e përfaqësuesit të parashtuesit të ankesës, rezulton se as ai vetë nuk ka informata se kur mund të jenë vendosur posterit në atë vend, por thekson se ata e kanë vërejtur atë poster në datën e parashtimit të ankesës. Nga kjo paneli vlerëson se posterit në fjalë mund të jetë i vendosur që nga fushata për zgjedhjet parlamentare e që për këto zgjedhje lokale nuk e ka asnjë efekt, ngase kandidatët në atë poster nuk janë në garë zgjedhore në këto zgjedhje lokale dhe po ashtu subjekti politik Y.Y. në zgjedhjet parlamentare ka garuar në zgjedhjet parlamentare me numër të subjektit 35 ndërsa në këto zgjedhje garon me numrin e subjektin 10.

Pretendimet e parashtuesit të ankesës në seancë e shqyrtimit të kësaj çështje juridike së është dashur të obligohet subjekti politik që ti largon posterat e zgjedhjeve të kaluara parlamentare nga hapësirat publike, është i paqëndrueshëm ngase nuk është në juridiksionin e panelit dhe nuk parashihet me legjislacion zgjedhor, që urdhëron subjektet politike që ti largojnë posterat pas përfundimit

respektivisht certifikimit të zgjedhjeve.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.

1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL.Anr.83/2017, Mos përfshirja e votuesve në listën e votuesve jashtë Kosovës

Votuesi K.K. me vendqëndrim në Lausanne-Zvicër, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apel, me të cilin e ka kontestuar vendimin e KQZ-së për mos përfshirje të tij në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale 2017, dhe ka pretenduar se me vendimin (e ankimuar) të KQZ-së i është mohuar-refuzuar nga KQZ-ja kërkesa për të votuar. Parashtruesi gjithashtu ka theksuar se KQZ-ja ia ka refuzuar kërkesën për t'u regjistruar si votues në listën e votuesve jashtë vendit, edhe pse i njëjti ka pasur dokumente valide (letërnjoftim) të Republikës së Kosovës.

Paneli, apelin e parashtruar e ka pranuar si të bazuar, pasi vërtetohet se parashtruesi i apelit është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil".

VENDIM

PRANOHET si i bazuar apeli i parashtruar nga K.K. nga Zvicra, **ANULOHET** vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.1762/2017 të datës 22.09.2017 përkitazi me votuesen K.K. dhe **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që votuesen K.K. me vendbanim Rue de Geneve,75/1004 Lausanne-Zvicër ta përfshijë në listat e votuesve jashtë Kosovës.

Arsyetim

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga K.K. nga Zvicra, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 14.09.2017, në të cilën pretendohet se i është refuzuar nga KQZ-ja kërkesa për të votuar edhe pse posedon dokumente valide të Republikës së Kosovës. Parashtruesja e apelit në cilësi të provës ka bashkangjitur

ID e Republikës së Kosovës.

Në përgjigjen në apel të datës 27.09.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se periudha e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës ka filluar me 16.07.2017 dhe ka mbaruar me 23.08.2017, ndërsa lista votuese për zgjedhjet lokale 2017, është certifikuar me datën 22.09.2017, me vendimin 1762/2017. Apeluesja K.K. ka aplikuar për votim jashtë Kosovës, ku KQZ-ja i ka refuzuar aplikacionin për shkak se dosja ka qenë e pa kompletuar si për faktin se dokumenti i identifikimit me afat të skaduar, nuk ka dëshmuar se ka të drejtë të përfshihet në listën votuese jashtë Kosovës pasi që aplikacioni ka qenë i pa nënshkruar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimit, në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i bazuar pasi që parashtruesja e apelit si dëshmi ka bashkëngjitur ID e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës me datë 31.07.2017, dhe se e njëjta i plotëson kushtet të cilat kërkohen në bazë të nenit 3.1, pika a), të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil”,* e që në rastin konkret parashtruesja e apelit posedon dokumente valide të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës dhe njëherit i plotëson kriteret për të qenë pjesë e Listës së Votuesve.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 3, 118 par. 1, 122 par. 1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par. 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL.Anr.87/ 2017, Pengim i mbajtjes së tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore

Subjektit politik N.N., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka parashtruar ankesë kundër G.H. në cilësinë e menaxherit të Qendrës së votimit “Halil Bajraktari”, Komuna e X.X., për shkak të pengimit të mbajtjes së tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore, edhe pse subjekti politik N.N. kishte leje nga KKZ-ja në komunën e X.X., që të mbahet tubimi publik, në datën dhe kohën e pretenduar si në ankesë.

Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se menaxheri i QV-së së lartpërmendur ka bërë pengimin e mbajtjes së tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore dhe ka bërë shkelje të neni 4. paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Paneli, ankesën e parashtruar e ka pranuar pjesërisht si të bazuar, në kuptim të nenit 117. paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, ashtu që menaxherit të QV-së në fjalëia ka ndaluar pjesëmarrjen në zgjedhje, si pjesë e stafit administrativ të ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e KQZ-së në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, duke i përfshirë edhe Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

Lidhur me pjesën e ankesës që është kërkuar nga parashtruesi i ankesës që të shqiptohet gjobë ndaj menaxherit të QV-së, paneli e ka vlerësuar si të pabazuar.

VENDIM

I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, që identifikohet me shenjën ZL.Anr.87/2017 e datës 27.09.2017, ashtu që G.H. në cilësinë e Drejtorit të Shkollës “Halil Bajraktari”, Komuna e Gllogocit, I NDALOHET pjesëmarrja në zgjedhje, si pjesë e stafit administrativ e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, duke i përfshirë edhe Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 22.10.2017.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa e ankesës e subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj G.H. për shkak të pengimit të mbajtjes së tubimit, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 22.10.2017.

Arsyetim

Përfaqësuesi i parashtruesit të ankesës, si në ankesën e parashtruar në PZAP, me datë 27.09.2017, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje në seancën e panelit të datës 02.10.2017, ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka pretenduar se subjekti politik N.N. është penguar me rastin e mbajtjes së tubimit publik me datë 26.09.2017, në Glllogoc, Shkolla Filllore "Halil Bajraktari", pasi që personi me emrin G.H. nuk ka lejuar për tu mbajtur tubim publik në ditën e mbajtjes së tubimit publik, përkundër se e njëjta ishte paraparë që të mbahet dhe kishte leje nga KKZ-ja në Glllogoc. Parashtruesi i ankesës konsideron se në rastin konkret ka pas pengim për mbajtjen e tubimit publik. Me propozim për panelin që ankesa të aprovohet ne tërësi si e bazuar dhe të merren masa ndëshkuese ndaj drejtorit të shkollës G.H. si dhe ti shqiptohet dënim me gjobë.

Paneli ka caktuar me datë 02.10.2017, seancë për shqyrtimin e kësaj çështje, mirëpo kryerësi i supozuar nuk ka prezantuar në seancë, ndërsa nga fletë kthesa e dorëzuar nga PZAP-i, është konstatuar se G.H. në cilësinë e kryerësit të supozuar, e ka pranuar ftesën për seancën e datës së lartpërmendur më datë 28.09.2017, por i njëjti nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, prandaj paneli konform nenit 423 par.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), shqyrtimin e kësaj çështje e ka mbajtur në mungesë të kryerësit të supozuar të ftuar me rregull.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimi të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë dhe provat si në vijim: Formulari për Njoftimin e mbajtjes së tubimit Publik me nr.159/17 i datës 22.09.2017, Shikohet CD me Video nga vendi ku ka qenë i paraparë mbajtja e tubimit publik, Lexohen deklarata e Zyrtarit Komunal Zgjedhor në Komunën e Glllogocit e datës 29.09.2017, Lexohet deklarata e drejtorit të Arsimit në Komunën e Glllogocit e datës 29.09.2017 dhe deklarata plotësuese e të njëjtit e datës 02.10.2017 dhe Lexohet

Raporti i Policisë i datë 26.09.2017.

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore provat e administruar, për secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se ankesa është pjesërisht e bazuar, për këto arsye:

Nga Formulari për Njoftimin e mbajtjes së tubimit Publik me nr.159/17 i datës 22.09.2017, paneli konstatoi se parashtruesi i ankesës ashtu siç edhe e ka theksuar në ankesë në afat të paraparë ligjor e ka njoftuar Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), në Komunën e Glllogocit, për mbajtjen e tubimit publik në Shkollën "Halil Bajraktari", të kësaj komune, dhe për të cilin tubim është lejuar mbajtja e të njëjtit nga KKZ-ja në Komunën e Glllogocit.

Me video CD, që gjendet në shkresat e lëndës, paneli konstaton se Polici, që ishte prezent në mbajtjen e tubimit publik të organizuar nga subjekti politik LVV, bisedon me telefon me drejtorin komunal të arsimit, dhe ja konfirmon se subjekti që ka parashtruar ankesë në këtë rast është në rregull me dokumentacion dhe duhet të lejohet të mbahet tubimi në fjalë. Po ashtu nga e njëjta video-CD, konstatohet se punëtori i sigurimit i shkollës ku është caktuar të mbahet tubimi, ka qëndruar para derës së hyrjes të kësaj shkolle, duke mos e lejuar askënd të futet brenda, pasi që e kishte urdhrin nga drejtori i shkollës G.H. kryerës i supozuar në këtë rast.

Nga parashtrësja e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Glllogocit e datës 29.09.2017, paneli konstaton se parashtruesi i ankesës e ka plotësuar brenda afatit ligjor formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit publik, i cili tubim publik është lejuar nga KKZ-ja në Glllogoc, dhe për të njëjtin tubim është njoftuar stacionin e Policisë në Glllogoc.

Me parashtrësat e datave 29.09.2017 dhe 02.10.2017, të T.H. në cilësinë e Drejtorit Komunal të Arsimit në Glllogoc, paneli konstatoi se drejtori i shkollës "Halil Bajraktari" G.H. në cilësinë e kryerësit të supozuar në këtë rast, nuk është urdhëruar nga T.H. në cilësinë e Drejtorit Komunal të Arsimit në Glllogoc, që mos të lejon subjektin politik N.N. për ta mbajtur tubimin publik me datën e lejuar nga KKZ-ja në Glllogoc.

Me raportin e policisë të datës 26.09.2017, paneli konstatoi se tubimi në fjalë ishte paraparë të mbahet me datën 26.09.2017, në objektin e shkollës fillore "Halil Bajraktari" në Glllogoc por se i njëjti

është mbajtur ne hyrje te objektit te shkollës pasi qe punëtorët teknik, nuk e kanë lejuar qe tubimi të mbahet ne objekt me arsyetimin se nuk e kane pëlqimin nga drejtori i shkollës, pasi qe paraprakisht nuk e kishin marre pëlqimin nga drejtorja e arsimit ne Glllogoc.

Paneli, për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, ndërsa në këtë rast nga provat e administruara, ka rezultuar se drejtori i shkollës "Halil Bajraktari" G.H. e ka penguar mbajtjen e tubimit publik të subjektit politik N.N., veprime këto qe janë ne kundërshtim me dispozitat ligjore Neni 4.2 i Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, është vendosur duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: *"Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite".* Pasi është vërtetuar nga paneli në mënyrë të pa dyshimit se drejtori G.H. në cilësinë e kryerësit të supozuar në këtë rast, e ka penguar mbajtjen e tubimit publik në fjalë gjatë fushatës zgjedhore.

Lidhur me pjesën e ankesës që është refuzuar nga paneli siç është vendosur në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, parashtruesi i ankesës nuk e ka provuar me asnjë se provë se drejtori në fjalë i përket ndonjë subjekti të caktuar politik, prandaj kërkesa e parashtruesit të ankesës në këtë pjesë është refuzuar si e pabazuar, ngase paneli shqipton një gjohë vetëm ndaj subjektit politik siç përcaktohet me dispozitën ligjore të nenit 120 par.1, pika c) të LZP-së.

Nga arsyet e theksuar më lart e duke bazuar nenin 44.2 dhe nenit 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL.Anr.88/2017, Përfshirja (përdorimi) i fëmijëve në fushatë zgjedhore

Organizata Jo Qeveritare N.N., me seli në Prishtinë, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar ankesë kundër kandidatit për kryetar të Komunës së X.X., nga radhët e subjektit politik X.X., për shkak se në spotin e tij në rrjetin social Facebook ka përdorur/përfshirë fëmijë të mitur gjatë bërjes së fushatës zgjedhore. Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se me këtë veprim kandidati për Kryetar të Komunës X.X. ka shkelur Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike, duke iu referuar kështu një deklaratë të Avokatit të Popullit se përdorimi i fëmijëve në fushata politike duhet të ndalohej.

PZAP-i, ankesën e parashtruar e ka pranuar si të bazuar, përfaktin se në rastin konkret parashtruesi i ankesës kishte argumentuar se kandidati për Kryetar të Komunës X.X. kishte përdorur fëmijë në spotin e tij gjatë fushatës zgjedhore, në rrjetin social Facebook. Paneli ka gjetur se ky veprim është në kundërshtim me nenin 5. paragrafi 2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton se: "Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet".

VENDIM

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës N.N. me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik X.X. i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3,500.00 euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

Arsyetim

Organizata N.N. me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 22.09.2017, me të cilën pretendon se Kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik X.X., L.Ç. në spotin e tij në rrjetin social Facebook, ka përdorur fëmijë të mitur. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë L.Ç. kandidat

për Kryetar të Komunës së Prishtinës nga radhët e subjektit politik X.X. ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, po ashtu Avokati i Popullit ka deklaruar se përdorimi i fëmijëve në fushata politike duhet të ndalohet.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një CD, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë X.X. të datës 29.09.2017, theksoi se lidhur me ankesën Anr.88 me të cilën iu ka bashkangjitur ankesës ka të bëjë me përmbledhjen e një aktiviteti të kandidatit në lagjen "Dardania" duke biseduar me qytetarët lidhur për problemet dhe shqetësimet e tyre dhe aktiviteti nuk ka qenë i mbyllur dhe nuk është thirrur asnjë qytetar për pjesëmarrje në këtë aktivitet. Subjekti politik X.X. në përgjigjen e tyre lidhur me fëmijët potencuan se rastësisht janë kapur nga kamerat të një grumbull mbeturinash nuk kanë qenë të ftuar dhe as nuk kanë qenë pjesë e aktivitetit të kandidatit për kryetar z.Ç..

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur disa foto të nxjerra nga video incizimi.

Subjekti politik X.X. kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga N.N. të hudhet poshtë sepse skena me fëmijët është e rastit dhe jo e përgaditur.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga CD e ofruara si provë nga parashtuesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se L.Ç. kandidat për Kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik X.X. ka përdorur fëmijë në spotin e tij, në rrjetin social Facebook, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: "Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet".

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik X.X. nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin qëkëtë subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar me arsyetimin e tyre që në spotin e inçizuar nga subjekti i tyre nuk kanë qenë të përfshirë fëmijët por kanë qenë vetëm të rastit, pretendimet e tilla nga ana e panelit janë të paqëndrueshme dhe nuk kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi me këtë gjob paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI – ZL.Anr.142/2017, Vendosja e njoftimeve të subjekteve politike në hapësira publike

Subjekti politik N.N. në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar ankesë, kundër subjektit politik X.X. me të cilën ka pretenduar se gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, nëpër shtylla elektrike ka vendosur njoftime për tubim elektoral me kandidatin për kryetar të Komunës X.X.

nga radhët e subjektit politik A.A.. Parashtruesi ka pretenduar se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të LZP-së Ligji Nr. 03/L-073, nenit 4. paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3. paragrafi 4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

PZAP-i, ankesën e parashtruar e ka miratuar si të bazuar për arsye se, në kuptim të nenit 117. paragrafi 2 të LZP-së, ka konstatuar se njoftimet për tubim me kandidatin për kryetar të Komunës X.X. nga radhët e subjektit politik A.A., janë vendosur në shtylla elektrike, prandaj edhe i është shqiptuar gjoba, në kuptim të nenit 120. paragrafi 1, pika c), dhe nenit 118. paragrafi 1, të LZP-së.

VENDIM

Pranohet si e bazuar ankesae subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik X.X. i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 550.00 (pesëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

Arsyetim

Me datën 08.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik N.N. me të cilën pretendon se me datën 07.10.2017, në rrugën "Xhavit Haziri" në Prishtinë, më konkretisht tek Rruga që njihet si ish reka e mbuluar, pranë tregut, te mulliri i Bankoviqit, nëpër shtylla elektrike ishte vendosur njoftimi për tubim me Kandidatin për Komunën e Prishtinës, A.A. nga radhët e X.X. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të LZP-së Ligji Nr. 03/L-073, nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së, duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur njoftim për tubim në hapësirë publike.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 09.10.2017, subjekti politik X.X. thekson se ankesa e subjektit politik N.N. është e pa bazuar për faktin se nuk mund të pretendohet se ka ndodhur shkelja e rregullave zgjedhore, pasi që fjala është për njoftim mbi tubimin elektorale, që ka karakter të një njoftimi të përkohshëm mbi zhvillimin e një ngjarje. Më tej subjekti politik X.X. kërkon që të hidhet si e pa bazuar ankesa e subjektit politik N.N..

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se njoftimi për tubim me kandidatin për kryetar të Komunës së Prishtinës, A.A. nga radhët e X.X. janë vendosur në shtylla elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: " Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike".

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik X.X. nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat

zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarre veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr njoftimet në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi me këtë gjobë paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen. Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

VENDIMI – ZL.Anr.170/2017, Vendosja e tendave në hapësirë publike

Subjekti politik N.N. në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP ka parashtruar pesë (5) ankesa, ndërsa subjekti politik X.X. një (1) ankesë, kundër subjektit politik Y.Y. Parashtruesit e ankesës kanë pretenduar se subjekti politik Y.Y., për qëllime elektorale ka vendosur objekte-tenda në hapësirat publike.

Paneli ankesat e parashtruara i ka miratuar si të bazuara, subjektit politik Y.Y. i ka shqiptuar më gjobën në shumë prej 7,500.00 € (shtatë mijë e pesëqind) euro, dhe ka urdhëruar këtë subjekt politik, që në afatin prej 24 orëve të bëjë përmirësimin e shkeljes së theksuar. Paneli ka vlerësuar se nga ana e subjektit politik Y.Y., është bërë shkelje e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se tendat dhe tavolinat e vendosura në hapësirat publike paraqesin veprime të ndaluara me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së, e cila parashikon që *gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatet e tij, ndalohen të bëjnë vendosjen e njoftimeve, pllakave dhe posterave, vendosjen e emrave të tyre, ose sloganeve, në lidhje me fushatën zgjedhore, brenda ose jashtë hapësirave, ose ndërtesave të zëna, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose në hapësira private, pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve tyre.*

VENDIM

I. Pranohen si të bazuara ankesate subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë me numër ZL. Anr. 170/2017 e datës, 10.10.2017, ZL. Anr. 187/2017, ZL. Anr. 188/2017, ZL. Anr.193/2017 te datës 11.10.2017, ZL. Anr. 222/2017 e datës 14.10.2017, dhe ankesa e subjekti politik X.X. me seli në Prishtinë, me numër ZL. Anr.186/2017 e datës 11.10.2017. Subjektit politik Y.Y. me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në shumë prej 7,500.00 (shtatë mijë e pesëqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët të cilën gjorbë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën **kërcënim të përmbarrimit**.

II. Urdhërohet subjekti politik Y.Y. që brenda afatit prej 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi, që ta përmirësoj shkeljet e përcaktuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

Arsyetim

N.N. me seli në Prishtinë, ka parashtruar 5 ankesat me numër ZL. Anr. 170/2017 të dt. 10.10.2017, ZL. Anr. 187/2017 të dt. 11.10.2017, ZL. Anr. 188/2017 të dt. 11.10.2017, ZL. Anr.193/2017 të dt.11.10.2017, ZL. Anr. 222/2017 të dt.14.10.2017 dhe 1 ankesë e parashtruar nga subjekti politik X.X. me seli në Prishtinë numër ZL. Anr.186/2017 e dt.11.10.2017 në PZAP, në të cilat pretendohet se subjekti politik Y.Y. për qëllime elektorale në hapësirat publike si: në oborrin e Postë Telekomit të Kosovës, në rrugën Xhorxh Bush, tek katedralja "Nëna Terezë", në rrugën "Justiniani", tek çerdhja e fëmijëve " Xixëllonjat", në rrugën " Bill Klinton" në lagjen Dardania, në rrugën " Luan Haradinaj" tek Neë Born në Prishtinë si dhe në sheshin "Ukë Meha" në Mitrovicë, kanë vendosur objekte-tenda në hapësira publike veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, si dhe në rrugën "Shefki Kuleta në Fushë Kosovë, ku kanë vendosur një tavolinë në rrugë publike nga ku dhe shpërndahen materialet zgjedhore nga ky subjekt politik për Zgjedhjet Lokale 2017.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankuesit kanë bashkangjitur disa fotografi, nga secili vende ku pretendohet të kenë ndodhur shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjet në ankesë të ofruara nga subjekti politik Y.Y. brenda afatit të paraparë, theksoi se Subjekti politik Y.Y. sipas nenit 4 të Rregullës së KQZ-së nr. 13/2013 kanë dorëzuar Formularët për Njoftime për mbajtjen e tubimeve politike tek Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve-ZLKZ si dhe tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për miratim, dhe të njëjtit iu ka lejuar të vendosin tendat dhe tavolina në vendet e lartcekura nga ana e Y.Y.. Pas pranimit të urdhrave për përmirësim të shkeljeve nga ana e PZAP-it, subjekti politik Y.Y. nuk ka ndërmarrë masat përmirësuese, duke u arsyetuar se të njëjtit posedojnë leje nga KKZ për vendosje dhe nga Drejtoria e Shërbimeve e Komunës së Prishtinës, Komunës së Mitrovicës dhe Komunës së Fushë Kosovës, dhe për të dëshmuar pretendimet e tyre, përgjigjeve iu kanë bashkangjitur kopjet e Formularëve si dhe pëlqimet e lëshuara.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.170/2017, për shkak të ekonomizimit të procedurës, pasi kemi të bëjmë me karakterin e njëjtë të rasteve, ankesat janë parashtruar ndaj të njëjtit subjekt politik dhe kanë pretendime të njëjta ankimore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesit e ankesave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka vërtetuar se subjekti politik Y.Y. për qëllime elektorale kanë vendosur objekte-tenda në hapësira publike si: në oborrin e Postë Telekomit të Kosovës, në rrugën Xhorxh Bush, tek katedralja "Nëna Terezë", në rrugën "Justiniani", tek çerdhja e fëmijëve "Xixëllonjat", në rrugën "Bill Clinton" në lagjen Dardania, në rrugën "Luan Haradinaj" tek Neë Born në Prishtinë dhe në sheshin "Ukë Meha" në Mitrovicë,

ndërsa në rrugën "Shefki Kuleta në Fushë Kosovë, është vendosur një tavolinë në rrugë publike nga ku dhe shpërndahen materialet zgjedhore nga ky subjekt politik, për Zgjedhjet Lokale 2017.

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt dhe padyshimtë, ka vërtetuar se nga subjekti politik Y.Y. me seli në Prishtinë, janë bërë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, tendat dhe tavolinat e vendosura në hapësirat publike, paraqesin veprime të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen vendosjen e njoftimeve, pllakave dhe posterave ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombtare, ose brenda ose në hapësira private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Nga arsyet e theksuara më lartë, ankesat e parashtruara nga subjektet politik N.N. dhe X.X. u miratuan si të bazuara pasi që pretendimet në ankesa janë të bazuara në fakte bindëse ku vërtetohet se subjekti politik Y.Y. ka bërë shkeljen e Kodit të Mirësjelljes. Paneli, vendimin e tij e mbështeti në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e subjekti politik Y.Y. nuk mundë të sanksionohen si shkelje e Kodit të Mirësjelljes, për arsye se Zyrtarët e Lartë të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, i kanë miratuar kërkesat e subjektit politik Y.Y. për mbajtjen e tubimeve politike dhe nga Drejtoria e Shërbimeve e Komunës së Prishtinës, Komunës së Mitrovicës dhe Komunës së Fushë Kosovës, iu është lejuar vendosja e tendave në hapësirat publike nga data 30.09.2017 deri më 20.10.2017 nga ora 11:00-20:00, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që me këto prova nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) e Rregullës 13/2013 ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre

zgjedhore duhet t'i bëjnë ne pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), Kodin e Mirësjelljes, të nxjerrur nga Komisioni i Pavarur i Mediave dhe ndonjë legjislacion tjetër në fuqi. Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit .

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së Y.Y. ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së urdhëroi subjektin politik Y.Y. që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet në afatin prej 24 orëve dhe nëse subjekti politik Y.Y. nuk vepron sipas urdhrin të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i , në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI – ZL.Anr.192/2017, Përdorimi i objekteve publike gjatë fushatës zgjedhore

Organizata Jo Qeveritare N.N. në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik X.X. për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore në objektet e institucioneve publike.

Paneli, ankesën e parashtruar e ka pranuar si të bazuar, dhe subjektit politik X.X. në kuptim të dispozitës së nenit 117. paragrafi 2 të LZP-së, X.X. i ka shqiptuar dënim më gjobë në vlerë prej 2,000.00 (dymijë) euro për shkak se subjekti në fjale ka bërë fushatë zgjedhore në objektet publike.

VENDIM

Pranohet si e bazuar ankesae organizatës N.N. me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik X.X. dega Gjakovë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2,000.00 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën **kërcënim të përmbarrimit**.

Arsyetim

Organizata N.N. me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 11.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Gjakovës nga subjekti politik X.X. A.Gj. duke i shfrytëzuar ndërmarrjet e zotëruara dhe të kontrolluara nga komuna e Gjakovës gjegjësisht KRM“Çabrati” me datën 10.10.2017 ka zhvilluar një takim publik me anëtarët e kësaj ndërmarrje. Parashtruesi i ankesës thekson se me këto veprime subjekti politik X.X. ka shkelur nenin 35.1 të LZP-së

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotot e marra nga faqja publike e facebookut të X.X. në Gjakovë ku pretendohet se ka ndodhur shkelja.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik X.X. të datës 12.10.2017, theksohet se vizita e kandidatit të tyre në KRM Çabrati është bërë me kërkesë të kësaj kompanie për tu njoftuar me problemin e mbeturinave në komunën e Gjakovës. I njëjti thekson se në qofte se

ka ndodhur shkelja atëherë e njëjta është bërë nga ana e kompanisë, dhe duke kërkuar nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre të hudhet poshtë. Si dëshmi ka bashkangjitur ftesën e bërë nga punëtorët e ndërmarrjes në fjalë për ta vizituar këtë kompani.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se A.Gj. kandidat për Kryetar të Komunës së Gjakovës nga radhët e subjektit politik X.X. ka bërë fushatë zgjedhore duke e vizituar KRM Çabrati në Gjakovë, të cilën vizitë e ka publikuar në facebookut e subjektit politik X.X. Gjakovë, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 35.1 të LZP-së që përcakton se personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyre ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke

pasur parasysh faktin se subjekti politik X.X. nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Si rrethanë, Paneli e mori edhe faktin që këtij subjekti politik, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre të njëjtit në arsyetimin e tyre theksojnë se vizita e realizuar është bërë me kërkesë të kësaj kompanie, e ku pretendimet e tilla nga ana e Panelit janë të vlerësuar si të paqëndrueshme pasi që dispozita ligjore e nenit 35.1 e LZP-së përcakton se *asnjë institucioni i administratës publike, ose edhe ndonjë ndërmarrje nuk mund të shfrytëzohen nga ndonjë subjekt politik në zgjedhje*. Andaj Paneli gjeti se vizita e realizuar në KRM Çabрати në Gjakovë nga kandidati në fjalë ka karakter të fushatës zgjedhore të subjektit politik në fjalë.

Ndërsa lidhur me pretendimet e subjektit politik X.X. se në qofte se ka ndodhur shkelja atëherë shkelja është bërë nga KRM Çabрати, Paneli thekson se Kodi i Mirësjelljes së Subjekteve Politike gjegjësisht neni 32.1 i LZP-së thekson se këtij kodi i detyrohen të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve politike dhe mbështetësit e tyre, andaj mbi këtë bazë janë të paqëndrueshme këto pretendime të subjektit politik X.X. që përgjegjësia të bie mbi kompaninë Çabрати.

Andaj bazuar në këtë kandidati në fjalë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjor duke bërë fushatë zgjedhore në objekte publike i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, me të cilën paneli vlerësoi se gjoba e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI – ZL.Anr.223/2017, Shpifje, nxitje dhe provokim në rrjete sociale gjatë fushatës zgjedhore

Subjekti politik N.N., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar ankesë kundër M.M., anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), nga radhët e subjektit politik X.X., për shkak të shpifjes dhe nxitjes në rrjete sociale, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale.

Paneli, në kuptim të nenit 117. paragrafi 2 të LZP-së, gjeti se ankesa e parashtruar është pjesërisht e bazuar, pasi që është vërtetuar se anëtari i KKZ-së në Komunën e M.M. nga radhët e subjektit politik X.X., ka rënë në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 120. paragrafi 3. pika d) të LZP-së, sepse në postimin-shkrimin e tij në rrjetin social "Facebook", është vlerësuar se, ka pasur elemente të përdorimit të gjuhës në formë të shkruar që nxitë dhe provokon një person tjetër, që garon në komunën ku edhe është i nominuar M.M. në cilësinë e anëtarit të KKZ-së, nga radhët e subjektit politik X.X.

VENDIM

I. PRANOHET pjesërishtsi e bazuar ankesa e subjektit politik N.N. me seli në Mamushë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.223/2017, e datës 16.10.2017, ashtu që M.M. anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Komunën e Mamushës nga radhët e subjektit politik X.X, me seli në Prishtinë, **I NDALOHET** pjesëmarrja në zgjedhje, si pjesë e stafit administrativ e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, duke i përfshirë edhe Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 22.10.2017.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa e ankesë e subjektit politik N.N. me seli në Mamushë, në raport me përgjegjësinë që mban subjektit politik X.X. me seli në Prishtinë, në këtë çështje juridike.

Arsyetim

N.N. ka parashtruar ankesë në PZAP, me datë 16.10.2017, me të cilën pretendon se me datë 16.10.2017, anëtari i KKZ-së në Mamushë nga radhët e subjektit politik X.X. M.M. përmes mediave sociale faqes së facebookit personal ka shpalosur shumë gënjeshtër dhe shpifje në emër të N.N. për votuesit, kopjen e të cilës ia kanë bashkangjitur ankesës. Parashtruesi i ankesës pretendon se pjesëmarrja e tij në aktivitet e zgjedhore dhe përkrahja publike për kandidatin e N.N. në Mamushë, bie ndesh me rregullat zgjedhore dhe mos përkrahjen e kandidatëve, dhe shtojnë se bashkëshortja e tij është kandidate nga lista për anëtare e këshillit të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik N.N. kjo flet edhe më shumë për një KKZ të paanshëm dhe mbrojtje të drejtës së votës dhe mos manipulimit me të. Me propozim për panelin që të ndërmerren masa ligjore ndaj zyrtarit të caktuar në fjalë.

Subjekti politik X.X. në përgjigje në ankesë të datës 17.10.2017, deklaron se ka kërkuar në mënyrë zyrtare nga KQZ që anëtari i KKZ-së në Mamushë nga radhët e subjektit politik X.X. të shkarkohet nga kjo pozitë, për arsye se ka përkrahur në mënyrë publike një kandidat të partisë tjetër. Me propozim që në raport me përgjegjësin e subjektit politik në këtë rast ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore provat e administruar, për secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se ankesa është pjesërisht e bazuar, për këto arsye:

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ), është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të Komunës, ku vepron, së bashku anëtarët që nominohen nga subjektet politike dhe që aprovohen nga KQZ-ja sipas LZP-së. Në këtë rast M.M. anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Komunën e Mamushës nga radhët e subjektit politik X.X. ka rënë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes që e ka nënshtruar, me rastin e emërimit të tij si KKZ, nga KQZ-ja, para fillimit të punës, sipas nenit 67 par.8 të LZP-së, sepse nga postimi i tij në rrjetin social "Facebook", rezulton se ka elemente të cilat janë të shprehur kundër një subjekti të caktuar politik në këtë rast kundër parashtruesit të ankesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes, nga anëtari i KKZ-së, në Komunën e Mamushës, M.M. nga radhët e subjektit politik X.X. paneli i vlerësoj si të qëndrueshme, dhe si të tillë e aprovoj , sepse anëtari i KKZ-së së lartpërmendur ka postuar në rrjetin social "Facebook", postimin që vlerësohet nga paneli se ka elemente të përdorimit të gjuhës në formë të shkruar që nxit, provokon një person tjetër, që është në kundërshtim me nenin 33 par. 1 pika l) të LZP-së.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikën -l-, të dispozitivit të këtij vendimi, vendosi duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: *"Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite".* Pasi që është vërtetuar nga paneli në mënyrë të pa dyshimit se anëtari i KKZ-së në Komunën e Mamushës M.M, nga radhët e subjektit politik X.X, ka rënë në kundërshtim me dispozitën e lartshkruar ligjore dhe në kundërshtim me Kodin i sjelljes për anëtarë të KKZ-së, në të cilin përcaktohet se çdo anëtarë i KKZ-së: *"Do të veprojë në mënyrë jo-partiake dhe neutrale në kryerjen e detyrave të mia zyrtare. Asnjëherë në cilësinë time zyrtare me asnjë veprim, qëndrim, mënyrë ose fjalim nuk do të shfaqë mbështetje për ndonjë parti politike, koalicion, iniciativë qytetare ose kandidati dhe nuk do të mbajë anim politik".* Sepse me postimin shkrimi të tij në rrjetin social "Facebook", është vlerësuar nga paneli se ka elemente të përdorimit të gjuhës në formë të shkruar që nxit dhe provokon një person tjetër, që garon në komunën që është territor ku edhe është i nominuar M.M. në cilësinë e anëtarit të KKZ-së, nga radhët e subjektit politik X.X.

Paneli me pjesën II të dispozitivit, refuzoi si të pabazuar pjesën e ankesës së subjektit politik N.N. me seli në Mamushë, në raport me përgjegjësinë që mban subjektin politik X.X. me seli në Prishtinë, në këtë çështje juridike pasi që subjekti politik X.X. në përgjigje në ankesë kanë theksuar se me parashtrësia e datës 17.10.2017,

drejtuar KQZ-së e ka kanë kërkuar në mënyrë zyrtare nga KQZ, të shkarkohet anëtarin e nominuar nga KKZ-së M.M. pasi që i njëjti në mënyrë publike e ka përkrahur një subjekt tjetër politik. Andaj, veprimi i kësaj natyre nga ana subjekti politik X.X. vlerësohet nga paneli si përpjekje serioze, për t'i parandaluar veprimet e kundërligjshme të çështjes lëndore siç edhe përcaktohet me nenin 32 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI – ZL.Anr.252/2017, Nxitje, provokim dhe urrejtje ndaj ekzistimit të shtetit të Kosovës

Organizata Jo Qeveritare N.N., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik X.X., për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët e tyre për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

Paneli ka gjetur se ankesa është e bazuar pasi ka vërtetuar se, subjekti politik X.X., për qëllime elektorale dhe me qëllim të promovimit të subjektit të tyre politik, nëpërmjet të Facebook-ut, ka publikuar në vazhdimësi një video - spot me përmbajtje politike zgjedhore, duke përdorur simbolet e hartës së shtetit të Serbisë brenda të cilës hartë është e përfshirë edhe Republika e Kosovës, ku po ashtu në këtë video - spot është paraqitur edhe përbërja qeveritare e Shtetit të Serbisë, duke bërë thirrje që “vota për X.X., është votë për Serbinë në Kosovë dhe Metohi”, dhe se i njëjti video - spot është publikuar edhe në web-faqen zyrtare të këtij subjekti politik.

Paneli i ka shqiptuar gjobën në shumë prej 22,000.00 euro, pasi ka vlerësuar se këto përbejnë veprime që nxisin ose provokojnë urrejtje kundër të tjerëve, që garojnë në zgjedhjet e njëjta lokale, të datës së lartë përmendur dhe të cilat paraqesin veprime që janë të ndaluara për subjektet politike, sipas dispozitës ligjore të nenit 33 pika 1 të LZP-së.

VENDIM

Pranohet si e bazuar ankesae N.N. me seli në Prishtinë, me numër ZL. Anr. 252/2017 e datës, 18.10.2017 dhe subjektit politik X.X. me seli në Mitrovicën e Veriut, i shqiptohet dënimi më gjobë, në shumë prej 22,000.00 € (njëzet e dymijë euro), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën **kërcënim të përmbarimit**.

Arsyetim

N.N. më datën 18.10.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendon se subjekti politik X.X. në rrjetin social Facebook ka publikuar një video, me anë të së cilës u bëhet thirrje qytetarëve që të dalin të votojnë në zgjedhjet lokale të 22 tetorit të këtij viti. Parashtruesi i ankesës thekson se një nder thëniet në videon e cila fton qytetarët që të votojnë është edhe ajo se “Vota për Listën Serbe është votë për Serbinë në Kosovë dhe Metohi”, ku me këtë rast një fotografi e përdorur në të njëjtën video, shihet një hartë e cila paraqet Republikën e Kosovës në kuadër të hartës së Serbisë. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33 pika l) të LZP-së. Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankuesit kanë bashkëngjitur CD-në e spotit të X.X. I kanë propozuar panelit që ankesa të pranohet në tërësi si e bazuar.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik X.X. thekson se, ankesa në fjalë nuk përmban një përshkrim të datës, kohës dhe shkeljes së pretenduar, pasi që në ankesë është theksuar faqja e Facebook-ut, por se nuk ceket cili është linku apo IP adresa e kësaj faqe të Facebook-ut, dhe se nuk është evidentuar se kur është publikuar vodeoklipi. Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se Facebook-u, është një rrjet social i cili është i hapur për publikun, ku të gjithë mund të hapin faqe pa ndonjë kufizim, ndërsa lidhur me pretendimet konkrete ankimore kanë deklaruar se X.X. nuk posedon faqe zyrtare te Facebook-ut të cilën e kane hapur personat e autorizuar apo zyrtarët e larte politik te X.X. Më tutje kanë theksuar se, ekzistojnë një numër i madh i faqeve të tilla në Facebook por pa ndonjë IP - adresë, linkut apo administratorit të asaj faqe, dhe

se nuk kanë mundësi që ta bllokojnë punën e asaj faqeje. Po ashtu në përgjigje në ankesë, subjekti politik X.X. thekson se, nuk mbajnë përgjegjësi për të gjitha faqet e Facebook-ut dhe videoklipet të cilat postohen në ato faqe, e të cilat faqe, nuk administrohen nga personat e autorizuar të subjektit politik X.X. dhe se këso videoklipe, mund të postojnë edhe kundërshtarët politik me qëllim të dëmtimit të subjektit të tyre politik duke i kopjuar videoklipet e tyre, dhe se profilet e rrejtshme të cilat mund ti hap çdokush. I kanë propozuar PZAP-it që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga video (CD-ja), e cila gjendet në shkresat e lëndës, paneli vërteton se subjekti politik X.X. cila garon në Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 22.10.2017, për qëllime elektorale dhe me qëllim të promovimit të subjektit të tyre politik, nëpërmjet të Facebook-ut, ka të publikuar në vazhdimësi një videospot, me përmbajtje politike zgjedhore, duke përdorur simbolet e hartës së Serbisë brenda të cilës hartë është e përfshirë edhe Kosova. Në këtë videospot është paraqitur përbërja qeveritare e Shtetit të Serbisë, duke bërë thirrje që "vota për X.X. është votë për Serbinë në Kosovë dhe Metohi". I njëjti videospot është publikuar edhe në web-faqen zyrtare të këtij subjekti politik. Paneli ka vlerësuar se, këto veprime përbëjnë veprime që nxisin ose provokojnë urrejtje kundër të tjerëve, që garojnë në zgjedhjet e njëjta lokale të datës së lartpërmendur dhe të cilat veprime janë të ndaluara për subjektet politike, sipas dispozitës ligjore të nenit 33 pika (l) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Kjo dispozitë ligjore përcakton se: Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: Përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokoj një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të

ketë ndikim të tillë. Dispozita e lart cituar ligjore mutatis mutandis, vlen edhe për zgjedhjet lokale sipas nenit 15 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

Pretendimet e subjektit politik X.X. të paraqitura përmes përgjigjes në ankesë, të cilët pretendojnë se nuk mbajnë përgjegjësi për veprimet e ndaluara siç pretendohet në ankesë, pasi që nuk dihet publikuesi, autori i video-spotit dhe nuk dihet data dhe ora e veprimit të ndaluar, paneli i vlerësoi si të pabazuara. Kjo për faktin se, nga video - CD-ja, e dërguar në panel nga parashtruesit e ankesës, e cila video është analizuar me ndërgjegje të kujdesshme nga paneli, konstatohet në mënyrë të pa dyshimt se spoti është publikuar në vazhdimësi në web-faqen zyrtare të subjektit politik X.X. veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 33 pika l), i LZP-së. Paneli vlerëson se ky subjekti politik mbahet përgjegjës edhe për veprimet e ndaluara që shkelin Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, siç përcaktohet me nenin 32 par.5 të LZP-së. Paneli ka konstatuar gjithashtu se, subjekti në fjalë nuk ka ndërmarr asnjë veprim për përmirësimin e veprimit të ndaluar, ashtu siç kërkohet me nenin 120 par.1 pika a) të LZP-së.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi mori parasysh shkeljet e lartpërmendura, dhe shqiptoj gjobën duke u bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c) LZP-së, lidhur me nenin 3 pika 11 Rregullores për Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, duke marr parasysh natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme, që konsiston në faktin se X.X. ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë që ka ndikuar në lartësinë e gjobës, paneli mori parasysh edhe rrethanën se i njëjti subjekt për

shkelje të natyrës pothuajse të njëjtëeshtë gjobitur në zgjedhjet e kaluara parlamentare, kurse rrethanë shtesë ka qenë edhe mos respektimi i urdhrit të panelit dhënë subjektit politik X.X. për ndërmarrjen e masave përmirësuese, dhe arsytimi se kinse nuk janë të njoftuar se ku mund të gjendet video-spoti lëndor, e cili video - spot, siç u vërtetua me lart në vazhdimësi ka qenë i publikuar në web – faqen zyrtare të subjektit politik X.X..

Paneli, duke u bazuar në arsyet e theksuara si më lart dhe në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 117 par.3 dhe nenit 118 par.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL.Anr.352/2017, Ndërrim i numrit në listën e votuesve

Kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal I.K. nga subjekti politik N.N., ka paraqitur apel në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), kundër vendimit të KQZ-së me të cilin janë certifikuar kandidatet e listës së subjektit politik, ku fillimisht është certifikuar si kandidat me nr.13, dhe është njoftuar se me këtë numër të kandidatit do të duhej të garonte në zgjedhje, ashtu që gjatë gjithë fushatës zgjedhore i ka ftuar votuesit që ta votojnë për numrin 13, mirëpo në ditën e votimit kur ka votuar e ka kuptuar se është i certifikuar si kandidat me numër 12, dhe për këtë ndryshim të numrit në fletën e votimit nuk është njoftuar nga KQZ-ja. I ka propozuar Panelit që votat e fituara të kandidatit të subjektit politik X.X. që figuron me nr. 12, të i barten votat të kandidati me nr. 13.

Paneli pas vlerësimit të afatshmërisë së apelit të njëjtin e ka hedhur si paskohshëm, pasi që parashtuesi i apelit, e ka ankimuar vendimin e KQZ-se për certifikimin e kandidatëve të subjekteve politike në ditën e votimit, respektivisht në ditën kur ka votuar kandidati, ndërsa në dispozitivin ligjor të nenit 122. paragrafi 1 të LZP-së, përcaktohet se: “Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda (24) orëve”.

VENDIM

Hidhet si e pas afatshme apeli i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal, në Skenderaj, I.K. kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga subjekti politik N.N. me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, ZL.A.nr.352/2017, e paraqitur me datë 23.10.2017, kundër X.X. për shkak të certifikimit të listës së kandidatëve me numër të gabuar, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

Arsyetim

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një apel, nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal, në Skenderaj, I.K. nga subjekti politik N.N. me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me të cilën pretendon se në KKZ ka figuruar me numër 13 dhe me të njëjtin numër ka bërë fushatë, ndërsa në KQZ figuron me numër 12. Më tej ka kërkuar që ti njihen votat me numër 13 dhe të rishikohet lista e KKZ-së në Skenderaj.

Subjekti politik AAK në përgjigje në ankesë, deklaroi me përgjegjësi të plotë se gabimi i bërë në radhitjen me numra të kandidatëve të N.N. në Komunën e Skenderajt për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal është në përgjegjësinë e plotë të administratës së KQZ-së. Më tej pretendon se anëtarët e KKZ-së në Komunën e Skenderajt është dashur ti njoftojnë kandidatët e kësaj Komune për çfarëdo ndryshimi në listat zgjedhore, sepse ka mos përputhje në mes të listës së KKZ Skenderaj, dhe listës së KQZ-së edhe mospërputhja me listën e publikuar në WEB faqen e KQZ-së.

KQZ në përgjigjen në apel pretendon se ankesa e I.K. është e pa bazuar sepse listat e kandidatëve për certifikim dorëzohen në zyrë nga zyrtari i autorizuar nga kryetari i subjektit politik i cili e nënshkruan atë listë si dhe e njëjta dorëzohet edhe në formë elektronike. Më tej KQZ thekson se lëvizja e numrit të kandidatit prej numrit 13 në numrin 12, është bërë me kërkesën e personit të autorizuar të subjektit politik N.N. që kandidati me numër 7 të decertifikohet, dhe për këtë arsye KQZ ka marrë vendim me nr. 1695/2017 të datës 16.09.2017. Po ashtu thekson se çdo subjekt

politik i certifikuar, mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së njoftim me shkrim jo më vonë se dy ditë të punës para datës së caktuar për tërheqje të shortit për zgjedhje, si dhe të gjitha kërkesat për të tërhequr një kandidat të certifikuar nga zgjedhjet i dorëzohen KQZ-së. Më tej ka theksuar se KQZ nuk merr vendim për caktimin e numrave të kandidatëve të subjekteve politike. Me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli pas shqyrtimit të afatshmërisë, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga I.K. kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga subjektit politik N.N. kundër X.X. është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 122 par.1 të LZP-së, ku përcaktohet: "Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda (24) orëve". Nga shkresat e lëndës del se me datën 16.09.2017 është bërë decertifikimi i kandidatit me numër 7 i subjektit politik N.N. sipas kësaj liste emri i anëtarit të Kuvendit Komunal, I.K. nga radhët e subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, ka qenë me numër 13 dhe me të njëjtin numër ka bërë fushatë. Me kërkesën e personit të autorizuar të subjektit politik N.N. është bërë ndryshimi i listës, ashtu që një kandidat me numër 7, është tërhequr dhe si pasojë e kësaj ka ardhë edhe deri te ndryshimi i listës së decertifikuar, në rastin konkret edhe i parashtruesit të ankesës I.K. nga radhët e subjektit politik N.N. dega në Skenderaj. Sipas këtij ndryshimi kandidati në fjalë, nga numri rendor 13 është kategorizuar në numrin rendor 12. KQZ-ja vendimin mbi ndryshimin e listës së subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, e ka publikuar në WEB faqe, me datën 25.09.2017. Në bazë të dispozitës së nenit 122.1 të LZP-së, afati për ankesë kundër vendimit të KQZ-së ka qenë 24 (njëzetekatër) orë pas publikimit të vendimit të KQZ-së. Apeli në PZAP është paraqitur me datën 23.10.2017, çka do të thotë se apeli është parashtruar pas afatit të përcaktuar me dispozitën Ligjore të nenit 122 pa.1 të LZP-së, konkretisht pas 28 (njëzetetë) ditëve

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë ne kuptim të nenit 115.1 dhe 122.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI- ZL.Anr.442/2017, Thyerja e heshtjes zgjedhore në afërsi të Qendrës së Votimi (QV-së)

Subjekti Politik N.N., dega në komunën X.X., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik X.X. dega në komunën X.X., për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017. Parashtruesi ka pretenduar se subjekti politik në fjalë disa herë ka shkelur rregullat lidhur me zgjedhjet lokale në komunën X.X., kandidatët e së cilës janë për anëtarë të Kuvendit Komunal A.M., S.P., I.P., para qendrës së votimit 1201B; N.V. para QV-së 1205B, gjatë ditës së votimit disa herë kanë qëndruar në hyrjet e QV-ve dhe në afërsi të tyre, në një distancë më të shkurtë se 25m., me qëllim të ndikimit ndaj votuesve. Po ashtu, kandidati për kryetar të komunës Z.T., në bashkëpunim me kryesuesen e vendvotimit 1201B/02R A.B. ka bërë ndikim ndaj votuesve para QV-së 1201B.

Paneli ka vlerësuar se ankesa e parashtruar është e pa bazuar, pasi që nuk gjeti se personat që pretendohet se kanë qëndruar afër QV-së ishin të subjektit X.X. Parashtruesi i ankesës nuk ka prezantuar asnjë person me emër apo mbiemër, për të identifikuar se cilit subjekt politik i përkisnin, si dhe kohën e qëndrimit të tyre, dhe ndikimin eventual të tyre tek votuesit.

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e N.N. dega në Lepsaviq, e cila identifikohet me numër ZL.Anr.442/2017e datës 22.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik X.X. dega në Lepsaviq, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

Arsyetim

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga N.N. dega në Leposaviq, me të cilën pretendon se subjekti politik X.X. disa herë ka shkelur rregullat lidhur me zgjedhjet lokale komunale në Leposaviq me të cilën kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal, A.M., S.P., I.P., para qendrës së votimit 1201B në Leposaviq; N.V. para QV-së 1205B në Lesak, gjatë ditës së votimit disa herë kanë qëndruar në hyrjet e QV-ve dhe në afërsi të tyre, në një distancë më të shkurtë se 25 metra, me qëllim të ndikimit ndaj votuesve. Më tej parashtuesi i ankesës thekson se kandidati për kryetar të komunës, Z.T. në bashkëpunim me kryesuesen e vendvotimit 1201B/02R, AB. ka bërë ndikim ndaj votuesve para QV-së 1201B në Leposaviq me të cilën pretendon se shihet edhe nga fotografitë e bashkangjitura. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika a).

Parashtuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi, lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore të parashtuesit të ankesës së subjektit politik N.N. lidhur me shkeljen e pretenduar të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, Paneli i vlerësoj si të pabazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsye se nga video CD dhe fotografitë e ofruara të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohen se personat të cilët janë duke qëndruar në oborrin e QV-e dhe janë të subjektit politik X.X. Meqenëse nga shkresat e lëndës nuk është vërtetuar se personat që pretendohet se kanë qëndruar afër QV-së janë të X.X. pasi që parashtuesi i ankesës nuk i ka prezantuar asnjë emër apo mbiemër për të identifikuar se cilit subjekt politik i përkasin si dhe kohën e qëndrimit të tyre, dhe ndikimin eventual të tyre tek votuesit.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL.Anr.560/2017, Anulim i zgjedhjeve për kryetar të komunës - Raundi i parë (Rivotimi)

Kandidati N.N. për kryetar në komunën X.X. nga subjekti politik X.X., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka parashtruar apel me të cilën ka pretenduar se në rezultatet përfundimtare të KQZ-së, të publikuara me datë 01.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, nuk është bërë përmirësimi i shkëlqes ku është pretenduar se në ditën e votimit kandidati N.N. për kryetar komune, i subjektit politik Y.Y., ka bërë blerjen e votës nga 30€ deri në 50€. I ka propozuar panelit që ta aprovojë apelin si të bazuar dhe të anulohet rezultati vetëm sa i përket kandidatëve për kryetar të kësaj komune.

Paneli, apelin e parashtruar e ka pranuar si të bazuar, pasi që e vlerësoi se kandidati i subjektit politik N.N., për kryetar të Komunës N.N., ka minuar integritetin e zgjedhjeve duke dhënë shpërblim financiar me qëllim të përfitimit të votuesve dhe për këto arsye ka urdhëruar KQZ-në të bëjë përsëritjen e votimit për kryetar komune në Qendrën e Votimit (QV) 3601d Budrigë e Poshtme, QV3602d Partesh dhe në QV3603d Pasjan, të gjitha në Komunën e Parteshit.

VENDIM

I. PRANOHET si i bazuar apeli i kandidatit për kryetar të Komunës në Partesh, N.N. nga radhët e subjektit politik X.X. e cila mban shenjën ZL.Anr 560/2017, e datës 01.11.2017, ANULOHEN rezultatet e Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017, vetëm për kryetar Komune, në Qendrën e Votimit (QV) 3601d Budrigë e Poshtme, QV3602d Partesh dhe në QV3603d Pasjan, të gjitha në Komunën e Parteshit, për shkak të minimit të integritetit të zgjedhjeve si rezultat i shpërblimit financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve.

II. URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, ta përsërisë votimin vetëm për kryetar komune në Qendrën e Votimit (QV) 3601d Budrigë e Poshtme, QV3602d Partesh dhe në QV3603d Pasjan, të gjitha në Komunën e Parteshit.

Arsyetim

PZAP-i më datë 01.11.2017, ka pranuar një apel nga kandidati për kryetar të Komunës në Partesh, N.N. nga subjekti politik X.X., me të cilën ka pretenduar se me datë 01.11.2017, KQZ ka publikuar rezultatet përfundimtar për zgjedhjet lokale të datës 22 tetor 2017, dhe sipas këtij publikimi fitues i zgjedhjeve është Y.Y. kandidat nga radhët e subjektit politik Z.Z. Sipas parashtruesit të ankesës këto zgjedhje kanë qenë të manipuluar dhe nuk e paraqesin vullnetin real të banorëve serb të kësaj komune sepse nuk janë eliminuar parregullsitë as me rastin e publikimit përfundimtar andaj dhe kërkojnë nga PZAP-i, që të anulohet procesi zgjedhor në Komunën e Parteshit, për shkak të manipulimit dhe blerjes së votave nga ana e subjektit politik Lista Serbe, dhe që KQZ të obligohet që të organizoj zgjedhje të reja në këtë komunë. Në mbështetje të pretendimeve ankimore kanë bashkangjitur listën e rezultatit përfundimtar të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), një CD-audio inqizim lidhur me rastin në fjalë si dhe fotografi të printuara të SMS-ve.

Në përgjigjen në apel të datës 01.11.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka theksuar se QNR-ja, të gjitha materialet sensitive dhe jo sensitive të cilat dorëzohen nga KVV-të dhe KKZ-të bënë verifikimin, hetimin dhe auditimin e materialeve zgjedhore dhe në rast se gjenë mospërputhje të rezultateve në mes FRP-ve dhe FRK-ve i rekomandon KQZ-së për rinumërim apo anulim të rezultati për vendvotimet e caktuara. Mirëpo, lidhur me rezultatet për Komunën e Parteshit, KQZ nuk ka gjetur arsye për ta bërë anulimin e rezultati zgjedhor sipas pretendimeve për manipulim dhe keqpërdorim të votave.

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, në raport me provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga CD-ja me Audio incizim Paneli në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet faktin se personalisht kandidati për kryetar i Komunës së Parteshit Y.Y. nga radhët e subjektit politik Z.Z. bisedon me një

person përmes telefonit, për mundësit e shpërblimit financiar të votuesve nga 30 deri 50 euro, për votues, me mundësi që të njëjtat mjete financiare do t'ia kthej shpërblyesit gjatë mandati katër vjeçar, me kamatë ligjore.

Nga Raporti Policor i datës 01.11.2017, Sektori Rajonal i Hetimeve në Gjilan-Njësi i Hetimeve për vepra penale, vërtetohet se pikërisht për pretendimet që lidhen me procesin zgjedhor që janë në lidhshmëri me rastin që objekt i shqyrtimit, procedura penale ka filluar në drejtim të veprës penale "Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin", vepër penale e sanksionuar me nenin 215 të KPRK-së.

Nga shkresa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, e datës 02.11.2017, paneli vërteton se personalisht kandidati për kryetar të Komunës së Parteshit Y.Y. nga radhët e subjektit politik Z.Z. ka komunikuar përmes telefonit me M.M. i cili dyshohet se është përfaqësues i një këmbimorje në fshatin Shillovë, që të ju shpërndaj mjete financiare qytetarëve në këmbim të votës, në shuma nga 30 deri 50 euro. Po ashtu nga e njëjta shkresë e Prokurorisë Themelore në Gjilan, paneli konstatoi se personi me të cilën ka biseduar përmes telefonit kandidati për kryetar të Komunës së Parteshit Y.Y. në fazën e procedurës parapenale e ka pranuar se i ka shpërndarë 90 euro, tre personave nga 30 euro, në këmbim të votës, por pa e potencuar se a janë ato për zgjedhje apo kinse për çështje humane.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikat -I- dhe -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindës siç përcaktohen me nenin 117 par.3 të LZP-së, në të cilën përcaktohet se: "Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i, mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse" siç edhe ishin në rastin konkret. Po ashtu pikat e lartpërmendura të dispozitivit, paneli i ka bazuar edhe nenin 120 par.1 pika b), i LZP-së, në të cilin përcaktohet se: "Para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anuloi rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhëroj KQZ-në të përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale". Në këtë rast paneli vlerëson se vetë fakti i kontaktimit të drejtpërdrejtë i një kandidati për kryetar komune,

siç është në këtë rast Y.Y. me një përfaqësues të një këmbimorje, dhe nga i cili kërkon që t'i shpërblej votuesit me nga 30 euro apo 50 euro, e të cilat mjete vetë kandidati i premton shpërblyesit se do t'ia kthen gjatë mandatit katër vjeçar, rezulton se ka pas ndikim në rezultatin përfundimtar aq me shumë kur kemi të bëjmë me një komunë e cila përbëhet vetëm prej tri qendrave të votimeve, e të cilat parregullsi nuk janë eliminuar nga KQZ-ja edhe pse e njëjta ka qenë e njoftuar publikisht përmes RTK-së, me rastin e shpalljes së rezultateve për kryetar të komunave, për zgjedhjet lokale të datës 22.10.2017.

Për më tepër kandidati në fjalë nuk ka përmend numër të kufizuar se sa persona do të shpërblehen në këmbim të votës, ky veprim e minon në masë të madhe integritetin e zgjedhjeve dhe si rezultat i këtij minimi ndikon në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Komunën e Parteshit.

Vendimi i panelit, është vendim administrativ sipas LZP-së, me të cilin nuk paragjykohet sanksionimi penal që mund të pasoj, sipas nenin 120 par.5 të LZP-së.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI-ZL A.nr. 776/2017, Mospërputhje e votave në Formularët e Rezultateve të Kandidateve (FRK)

N.N. kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në komunën N.N. nga subjekti politik M.M., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apel kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, duke i kontestuar Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal, të mbajtura më datë 22.10.2017. Parashtruesja e apelit ka theksuar se në Formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) ka mospërputhje në numrin e votave të fituara.

Paneli pasi vlerësoi se pretendimet e apeluesit janë të provuara përmes provave, ka pranuar si të bazuar apelin dhe ka urdhëruar KQZ-në që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatës N.N. nga subjekti politik M.M., në Vendvotimet: 2423A/01R, 2411A/01D dhe 2416A/01D. Gjithashtu PZAP-i, ka urdhëruar që rezultati nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

VENDIM

I. PRANOHET si i bazuar apeli i N.N. kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Suharekë nga subjekti politik M.M. dega në Suharekë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtare të Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatës N.N. nga subjekti politik M.M. në Vendvotimet: 2423A/01R, 2411A/01D dhe 2416A/01D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 09.11.2017 ka pranuar një apel nga N.N. kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Suharekë nga subjekti politik M.M. dega në Suharekë, me të cilin ka theksuar se në vendvotimin 2423A/01R fshati Sllapuzhan ditën e zgjedhjeve drejtpërdrejt nga qendra e votimit janë raportuar me telefon se janë 8 vota, ndërsa në procesverbalet e komisionarëve figurojnë 5 vota. Më tej ka shtuar se në vendvotimin 2411A/01D fshati Mohlan, nga raporti i vëzhguesit ka 14 vota, ndërsa në procesverbal nga komisionarët e KQZ-së ka 13 vota. Po ashtu parashtruesja e ankesës ka theksuar se në vendvotimin 2416A/01D, kanë votuar dy familjarë të saj ndërsa në raport nga komisionarët janë zero (0) vota.

Parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një CD dhe raportin e votave për kandidatët për

Kuvendin Komunal nga Vëzhguesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoi pretendimet ankimore dhe shkresat e tjera si dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, shihet qartë se parashtrueses së ankesës i janë shënuar më pak vota nga sa realisht janë raportuar ditën e Zgjedhjeve e cila gjë vërtetohet edhe nga CD- e ofruar si dëshmi. Andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidaten e subjektit politik Nisma për Kosovën N.N. në vendvotimet 2423A/01R, 2411A/01D dhe 2416A/01D, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI – ZL.Anr.1072/2017, Vëzhguesi i certifikuar nga KQZ ka bërë fushatë zgjedhore për një subjekt politik të caktuar

Subjekti politik N.N. në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka parashtruar ankesë kundër OJQ-së X.X., për shkak së gjatë fushatës zgjedhore për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, ka bërë fushatë për një subjekt të caktuar politik.

Paneli, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesës, gjeti se ankesa është e bazuar, sepse vëzhguesja e akredituar E.K. si vëzhguese e Organizatës Z.Z., e cila gjatë procesit zgjedhor ka vepruar nën menaxhimin e Koalicionit të Organizatave Jo Qeveritare X.X., nuk i është përmbajtur neutralitetit si vëzhguese e një Koalicioni të OJQ-ve, pasi që në postimet e saj në rrjetin social facebook dhe prononcimin e saj në gazetën e re Online, ka anuar nga subjekti politik, duke e tejkaluar kështu mandatin e një vëzhguesi të akredituar.

VENDIM

Pranohet si e bazuar ankesa ZL.Anr.1072/2017 e datës 15.11.2017 e parashtruar, nga subjekti politik N.N. me seli në Prishtinë, dega Gjakovë, ashtu që vëzhgueses së organizatës X.X. E.K. i ndalohej për 3 (tre) vite të marrë pjesë si vëzhguese në zgjedhje që organizohen nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në Republikën e Kosovës, duke përfshi edhe rundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale që do të mbahen me datë 19.11.2017.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 15.11.2017 nga subjekti politik N.N. me të cilën pretendon se vëzhguesja e OJQ-së X.X. E.K. gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 22.10.2017, ka treguar animin e saj politik ndaj subjektit politik Y.Y. me të cilën është anëtar dhe funksionar edhe babai i saj z. M.K. Po ashtu në vazhdimësi për balotazhin e Zgjedhjeve Lokale 2017 që do të mbahen më 19.11.2017, bënë fushatë të hapur duke përkrahur subjektin politik Y.Y. në rrjete sociale si dhe në deklaratën e dhënë në portalin Gazeta e Re shihet deklaratat e saj dhe postimet përmes rrjeteve sociale ka për qëllim nxitjen e votuesit që të votojnë për kandidatin e Y.Y. në Balotazh. Në deklaratën e dhënë në portalin Gazeta e Re thotë se qyteti i Gjakovës edhe në përvojat e kaluara gjithnjë ka shprehur gatishmërinë për të pranuar ndryshimet. Sipas saj po vërehet disponimi i qytetarëve dhe i partive politike për ndryshim ashtu siç e ka cituar në këtë portal. Parashtruesi i ankesës thekson se vëzhguesja nga organizata X.X. E.K.B. është shkelur neni 15 i Ligjit 04/L-57 për Lirinë e Asocimit për Organizatat Jo qeveritare

me të cilën është e ndaluar mbështetja e kandidatëve dhe partive politike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur deklaratën e plotë e dhënë në portalin Gazeta e Re si dhe një listë me mesazhe dhe postime reklamuese të subjektit politik Y.Y. me të cilat pretendohet se është bërë veprimi i ndaluar

Në përgjigjen e pranuar nga organizata X.X. më datë 16.11.2017 theksohet se nuk kanë gjetur asnjë element i cili mbështet pretendimet e ankuesit sepse në fotografinë e parë shihet vetëm një objekt me mbishkrimin Gjakova me një zemër dhe nga kjo nuk shihet asgjë politike. Në provën numër dy Eranda ka shpërndarë një lajm nga një gazetë online me mbishkrimin e saj "Vendim shumë i mirë" dhe lajmi ka të bëjë me urdhrin e kryeministrit për ndalimin e përdorimit të automjeteve shtetërore në fushatë. Në provën numër tre Eranda ka postuar pamjet e qytetit dhe si qytetare ka të drejtë të paraqes shqetësimet e veta në faqen e saj në facebook. Në provën numër katër Eranda paraqet një qëndrim të saj si pjesë e shoqërisë civile e asnjëherë si pjesë e X.X. apo në cilësinë e monitorueses së fushatës. Si dhe prova e fundit e postuar në facebook me mbishkrimin "Natën e mirë 2013" nuk ka asnjë element politik apo partiak, kjo për faktin se faqja e kësaj është personale dhe nuk mund të supozojmë se në çfarë kuptimi e ka shkruar. Lidhur me pretendimet se vëzhgueses E.K.B. se ka bërë thirrje për një subjekt të caktuar politik, e njëjta nuk ka qenë e akredituar si vëzhguese pasi që sipas vendimit me numër 2095-2017 tëlëshuar nga KQZ më datën 26.10.2017 janë anuluar të gjitha distinktivët e vëzhguesve të subjekteve politike dhe organizatave jo qeveritare, të cilat janë marrë me vëzhgimin e zgjedhjeve lokale me të cilën shihet në provën numër 16. X.X. thekson se e kanë vizituar faqen e E. në Facebook dhe ka gjetur shumë prova tjera të cilën e bëjnë E. plotësisht jopolitik pasi që postimet e saj janë familjar, miq, shoqëri si dhe fotografi nga puna e saj me organizatë. Lidhur me pretendimin se prindi i saj është kandidat për asamble nga radhët e një subjekti tjetër politik në përgjigjen e organizatës X.X. thuhet se nuk është aspak relevant për faktin se secili person është i lirë në Kosovë të zgjedhë apo të zgjidhet, përderisa nuk vendoset ndryshe

me një vendim të plotfuqishëm të gjykatës. Kërkon nga PZAP-i të refuzohet si e pabazuar në tërsi ankesa e subjektit politik N.N..

Në përgjigjen në ankesë E.K.B. me datë 16.11.2017 vëzhguese e angazhuar në kuadër të koalicionit X.X. në Komunën e Gjakovës thekson se nuk ka përmendur emra kandidatësh as subjekte politike ose numrat zgjedhor që do të mund të konsiderohej si fushatë zgjedhor. Në vazhdim të përgjigjes thekson se subjekti politik N.N. prononcimit të saj i ka bërë interpretim paragjykses pasi ajo nuk ka favorizuar dhe nuk favorizon asnjë kandidat ose subjekt politik. Lidhur me postimet në rrjetin social facebook në (llogarinë personale) nuk ka përmendur asnjë rast emrash kandidatësh ose numra të subjekteve politike dhe asnjëherë nuk ka bërë thirrje dhe nuk ka nxitur të votohet ndonjë kandidatë. Me tej në përgjigje në ankesë thekson se gjatë punës së saj në kuadër të zgjedhjeve në Kosovë ju ka referuar gjithmonë me ndërgjegje dhe pastërti të plotë Ligjit Nr.04/L-57 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare që i referohet subjekti N.N. Lidhur me këtë thekson se formularët të cilët i kanë plotësuar dhe dërguar në X.X. gjatë procesit të monitorimit të fushatës zgjedhore në Komunën e Gjakovës janë dëshmi të cilët tregojnë transparencën dhe paanshmërinë politike të saj. Më propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga parashtresa e KQZ-së, me numër 1072/6 e datës 16.11.2017, vërtetoi se gjatë procesit të akreditimit të vëzhguesve është akredituar edhe E.K.B. me numër të kartelë 501, e cila kartelë është valide deri me datë 18.11.2017, si vëzhguese e Organizatës Z.Z. e cila gjatë procesit zgjedhor ka vepruar nën menaxhimin e Koalicionit të Organizatave jo qeveritare X.X..

Koalicioni i Organizatave jo qeveritare X.X. në një proces zgjedhor qoftë ditën e votimit apo edhe gjatë gjithë fushatës zgjedhore, me të gjithë vëzhguesit e saj duhet të jenë neutral dhe të paanshëm në të gjitha publikimet e tyre qoftë edhe të postuar në çfarë do rrjeti social. Në këtë rast kartela e akreditimit të vëzhgueses E.K.B. është

valide deri me datë 18.11.2017, e cila nuk ju ku përmbajtur neutralitetit si vëzhguese e një Koalicioni të Organizatave joqeveritare për çka edhe janë akredituar sepse nga postimet e saj në rrjetin social facebook dhe prononcimin e saj në gazetën e re Online, paneli vlerësoi se vëzhguesja E.K.B. ka anuar nga subjekti politik e që nuk është në mandatin e një vëzhguesit të bënë prononcime të asaj natyre, siç janë bërë nga vëzhguesja në këtë rast, përderisa një vëzhgues është i akredituar.

Me rastin e vendosjes në këtë rast paneli mori parasysht edhe pretendimet e Koalicionit X.X. të cilët kanë theksuar se nuk është në kompetencë të PZAP-it, qe të vendos për këtë rast, mirëpo këto pretendime paneli i vlerësoi si të pabazuar në ligj sepse dispozita ligjore e nenit 121 par. 1 i LZP-së, përcakton se: *"PZAP-i, mund të revokojë akreditimin e një organizatë vëzhguese nëse ajo organizatë vëzhguese në mënyrë sistematike ose në mënyrë të organizuar ka shkelur ligjin ose rregullat zgjedhore"*. Nga kjo dispozitë ligjore rezulton edhe kompetenca e PZAP-it, për të vendosur lidhur me organizatat vëzhguese dhe të akredituara nga KQZ-ja, në zgjedhje siç është në këtë rast për vëzhguesin e Koalicionit të akredituar për vëzhgim, X.X..

Prandaj në bazë të nenit 4 par. 6 të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2013, përcaktohet se: *KQZ-ja apo PZAP-i, mundet me vetë iniciativë ose pas njoftimit nga Zyra ose cilido nga ZKZ-të, t'ia anuloi akreditimin cilido vëzhgues që nuk e ka respektuar Rregullat Zgjedhore Nr.07/2013 Vëzhguesit e Zgjedhjeve ose që në çfarëdo mënyre e pengon procesin e zgjedhjeve"*.

Andaj në bazë të arsyeve të theksuara më lart, e në kuptim nenit 115 par.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL A.nr.1086/2017,**Thyerja e heshtjes zgjedhore duke i udhëzuar votuesit të votojnë për kandidatin e caktuar**

Përfaqësuesi i Organizatës Jo Qeveritare N.N. ka parashtruar ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, nën pretendimin se janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 36. paragrafi 1 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP-së), në të cilën thekson se kryetari i subjektit politik Y.Y., gjatë heshtjes zgjedhore me datën 18 Nëntor 2017 në ora 18:35 përmes rrjetit social facebook ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin M.H. me numër 10, nga subjekti politik X.X..

Paneli duke u bazuar në nenin 32. paragrafi 3, 4, 5 dhe 6, nenin 36. paragrafi 1 (b), nenin 118. paragrafi 1 dhe neni 120. paragrafi 1 (c) të LZP-së, ka pranuar si të bazuar ankesën e subjektit politik N.N., ashtu që këtij subjektit politik i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 4,100€ (katërmijënjëqind, euro), për faktin se kandidati për kryetar Z.B., i subjektit politik Y.Y., i cili për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës X.X., ka lidhur koalicion në nivelin lokal me kandidatin e subjektit politik X.X. për kryetar të komunës X.X., gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka bërë fushate zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet kandidati për kryetar të komunës X.X. me numër 10, nga subjekti politik X.X., si dhe i njëjti ka përdorur fjalorë denigrues, ku me këtë veprim ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

VENDIM

Pranohet si e bazuar ankesae N.N. ashtu që subjektit politik X.X. i shqiptohet dënimi më gjobë nëshumë prej 4100 (katërmij e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

Arsyetim

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga N.N. me të cilën pretendon se kryetari i subjektit politik Y.Y. dega në Prizren Z.B. gjatë heshtjes zgjedhore me datën 18 Nëntor 2017 në ora 06:35 minuta mbas dite përmes rrjetit social facebook ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin me numër 10 nga X.X., M.H. duke bërë fushatë ndaj kandidatit tjetër me fjalët " Të nderuar miq, të dielën dilni votoni dhe ndëshkoni krimin, korrupsionin e klanin pronto duke votuar nr. 10 M.H.". Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me nenin 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik X.X. thekson se marveshjet politike ndërmjet X.X. dhe Y.Y. nuk ka asnjë efekt juridik mbi bazën e të cilit do të mund ti shqiptohet ndonjë gjobë subjektit politik X.X. për shkak të publikimit të postimit në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se kryetari i subjektit politik Y.Y. dega në Prizren Z.B. i cili për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës së Prizrenit ka lidhur koalicion në nivelin lokal me kandidatin e X.X. për kryetar të komunës së Prizrenit, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka bërë fushatë zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet kandidati për kryetar të komunës së Prizrenit me numër 10 nga subjekti politik X.X. dega në Prizren, si dhe i njëjti ka përdorur fjalor denigrues, ku me këtë veprim ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Lidhur me pretendimet e subjektit politik X.X. se marveshjet politike dhe koalicioni ndërmjet X.X. dhe Y.Y. dega në Prizren nuk kanë asnjë efekt juridik mbi bazën e të cilit do të mund të shqiptohet

ndonjë gjobë ndaj subjektit politik X.X. Paneli konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që në bazë të nenit 32 par 3, 4 dhe 5 të LZP-së subjektet politike i informojnë anëtarët, mbështetësit e tyre dhe kandidatët rreth dispozitave të këtij kodi, dhe duhet të ndermarin të gjitha hapat e nevojshme për ti parandaluar nga shkelja e këtij kodi, në të kundërtën ato mbahen përgjegjëse për shkeljen e këtij kodi. Me këtë rast Paneli konstaton se Z.B. në cilësinë e përkrahësit dhe mbështetësit të kandidatit të X.X. për kryetar të komunës së Prizrenit gjatë heshtjes zgjedhore ka bërë fushatë për kandidatin e X.X. M.H..

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik LVV është përgjegjëse për veprimet e tij duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohej bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, përdorimin e fjalorit denigrues, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së X.X.-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatat, që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL A.nr. 1114/2017, Manipulum i votimit me postë i votuesve jashtë Kosovës.

Përfaqësuesi i subjektit N.N., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar ankesë me të cilën ka pretenduar se ka pasur shkelje në procesin e votimit me postë, dhe në listën e votuesve jashtë vendit, janë përfshirë personat e vdekur.

Paneli ankesën e parashtruar e ka pranuar si të bazuar për arsye se, ka vlerësuar se pohimet e ankuesit janë të argumentuara dhe të dëshmuara me prova relevante, dhe Paneli ka urdhëruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, ta përsërisë votimin e raundit e dytë të Zgjedhjeve Lokale, për Kryetar të Komunës X.X.. Paneli ka vlerësuar se fletëvotimet me postë për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për Kryetar të Komunës X.X., janë determinuese në rezultatin final, dhe mënyra e votimit se si është votuar në këtë rast e dëmton seriozisht dhe e minon procesin zgjedhor të raundit e dytë të zgjedhjeve për Kryetar në Komunën X.X.

VENDIM

I. PRANOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, e cila mban shenjë ZL.Anr.1114/2017, e datës 24.11.2017, ANULOHEN rezultatet e Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017, për Rundin e Dytë, të mbajtura me datë 19.11.2017, për kryetar të Komunës në Istog.

II. URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, ta përsërisë votimin e Rundit e dytë të Zgjedhjeve Lokale, për Kryetar të Komunës së Istogut.

Arsyetim

Më datën 24.11.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik N.N. me të cilën pretendon se ka pasur shkelje në procesin e votimit me postë, sepse numri i votuesve me postë për Komunën e Istogut, është tejet i lartë ngase 58% e votave me postë në nivel të

Kosovës, janë vetëm për Komunën e Istogut. Këto fletëvotime me postë janë në pliko të njëjta, fletëvotime të printuara të gjitha njëjtë, të dërguara me postën e njëjtë dhe për të njëjtin kandidat (X.X. – Y.Y. 99% të votave me postë, M.M. – N.N. 1%). Më tej parashtuesi i ankesës pretendon se qytetarëve të shumtë i është vjedhur identiteti me rastin e aplikimit si votues jashtë Kosovë, duke ua keqpërdorur të dhënat personale dhe duke aplikuar dhe votuar në emër të tyre, ndërsa të njëjtit janë banorë të përhershëm të Istogut, të cilët meqë janë larguar nga Lista Përfundimtare e Votuesve në Komunën e Istogut, janë detyruar që personalisht të votojnë me kusht në vendvotim, ka pasur votim në emër të qytetarëve të vdekur, votim të qytetarëve (kryesisht të komuniteteve pakicë) që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës, por që në emër të të cilëve është votuar, kryesisht nga Mali i Zi, Sllovenia dhe Austria. Me propozim për panelin që të anulohet në tërësi procesi i votimit përmes postës për Komunën e Istogut, si dhe rezultati i votave me postë për secilin kandidat për Komunën e Istogut të përjashtohet nga rezultati përfundimtarë i zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut.

KQZ, në përgjigjen në ankesën e datës 24.11.2017, ka theksuar se Periudha e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve jashtë Kosovës, ka filluar me datë 16.07.2017 dhe ka përfunduar me datë 23.08.2017, ku përgjatë kësaj periudhe, janë pranuar 11,813.00, aplikacione për regjistrim, prej tyre: 4,729 zarfe me aplikacione janë pranuar përmes postës, në fahun postar të KQZ-së, 63 aplikacione janë pranuar përmes faksit dhe 7,023 aplikacione të pranuar përmes e-mail-it. Më tej thekson KQZ, në përgjigje në ankesë se për Raundin e Dytë të zgjedhjeve të datës 19.11.2017, për Kryetarë të Komunës, votuesit që kanë aplikuar suksesshëm për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës, kanë pasur të drejtë që të votojnë, duke dërguar pakon me fletëvotim përmes postës, më së voni deri me datën 17.11.2017. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksohet se vlerësimin e pakove me fletëvotime e ka bërë në pajtim me Rregullën Zgjedhore nr. 03/2013.

Subjekti politik Y.Y. me seli në Prishtinë, në përgjigje në ankesë, ka theksuar se lista e njëjtë e votuesve, që është shfrytëzuar për zgjedhjet lokale të rëndit të parë, është përdorur edhe në raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave, në bazë të Rregullores Zgjedhore nr. 10/2013. Ndërsa kjo listë ka qenë e publikuar dhe

secili ka pasur të drejtë ankese, mirëpo sipas raporteve të KQZ-së nuk ka pasur kundërshtim nga votuesit me të drejtë vote, lidhur me pasaktësitë dhe mangësitë në listën e votuesve, në raundin e parë. Më tej lidhur me pretendimet se votat janë dërguar nga një postë e vetme nga Mali i Zi, Y.Y. thekson se në vitin 2013 dhe 2014 në Nish ka ekzistuar qendra e grumbullimit të votave, pra është bërë votim i organizuar dhe kjo mënyrë e votimit ka qenë e pranuar nga KZAP (tash PZAP). Më tej ka theksuar se nuk ka pasur fare ndryshime në mes të votuesve të cilët kanë votuar në raundin e parë edhe në raundin e dytë të këtyre zgjedhjeve nga Mali i Zi, Sllovenia dhe Austria. Më tej lidhur me pretendimet se ka pasur votim edhe nga qytetarët e vdekur Y.Y. ka theksuar se personat e njëjtë që janë të vdekur kanë votuar edhe në Raundin e Parë të zgjedhjeve, dhe lëshimet eventuale të KQZ-së, nuk mund ta anulojnë gjithë procesin zgjedhor për zgjedhjet lidhur me mos pastrimin e listave të votuesve të vdekur që kanë mundur të bëhen nga ana e KQZ-së, se si votues kanë qenë edhe persona të vdekur të anulohet vullneti i lirë i qytetarëve të Komunës së Istogut. Andaj ka kërkuar që të refuzohet ankesa e ankuesit si e pabazuar. Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur Rregullën Zgjedhore nr.10/2013 për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave; Vendimin e KQZ-së për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale nr.2232/2017 dhe vendimin për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet Lokale 2017, nr. 1762/2017.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lendes, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimi ankimor se në listën e votuesve, për votuesit jashtë vendit kanë aplikuar, për të hyr në listën e votuesve personat e vdekur, e cila periudhë kohore e Aplikimit për Regjistrim ka qenë nga data 16.07.2017 deri më 23.08.2017, dhe të njëjtit kanë votuar, paneli e vlerëson këtë pretendim se është i qëndrueshëm sepse Votuesja Jaglika Ostojic me numër personal 00000 e lindur me datë 06.07.1935, ka vdekur me datën 08.08.2017, siç konstatohet nga Certifikata e Vdekjes, e datës 21.11.2017, Votuesi Mladen Belosevic me numër personal 000000 i lindur me datë 23.03.1933,

ka vdekur me datë 09.10.2017, siç konstatohet nga Akti Vdekja e datës 31.10.2017, Votuesi Tafë Gjukaj i lindur me datë 13.04.1949, ka vdekur me datë 26.12.2012, siç konstatohet nga fotografia e lapidarit të këtij votuesi tani të ndier, Votuesja Bozhana Tijanica i lindur me datë 15.12.1935, ka vdekur në vitin 2009, siç konstatohet nga fotografia e lapidarit të kësaj votuesje tani e ndier, Votuesi Rajko Belloshevic i lindur me datë 21.02.1935, ka vdekur në vitin 2011, siç konstatohet nga fotografia e lapidarit të këtij votuesi tani të ndier, Votuesi Murat Colakovic me numër personal 000000, i lindur me datë 30.07.1945, ka vdekur me datë 21.03.2001, siç konstatohet nga certifikata e vdekjes, me Nr.9 e datës 04.05.2001, Votuesi Salih Erovic me numër personal 0000000, i lindur me datë 30.09.1940, ka vdekur me datë 04.12.2012, siç konstatohet nga Regjistri i të Vdekurve me numër 013 i datës 21.12.2012, Votuesi Izet Hysenaj me numër personal 000000, i lindur me datë 02.02.1958, ka vdekur me datë 11.03.2017, siç konstatohet nga Certifikata e Vdekjes e datës 23.11.2017, Votuesja Ajka Destanovic e lindur me datë 16.05.1942, ka vdekur në vitin 2003, siç konstatohet nga fotografia e lapidarit të kësaj votuesje tani e ndier, Votuesi Cemal Catovic me numër personal 00000000 i lindur me datë 30.12.1982, ka vdekur me datë 19.12.2010, siç konstatohet nga Regjistri i të Vdekurve me numër 05 i datës 07.02.2011.

Paneli vlerëson se për të gjithë personat e lartpërmendur është aplikuar për tu regjistruar si votues jashtë Kosove, me çka konstatohet nga parashtrësia e KQZ-së, në formë tabelare dhe po ashtu nga parashtrësia e KQZ-së, me numër 1114/7 e datës 26.11.2017, konstatohet se pakot e fletëvotimeve të personave të lartpërmendur janë dërguar në QNR, për procesin e numërimit. Nga kjo rezulton se edhe fletëvotimet e personave të vdekur siç u konstatuar me lart, që dikush ka dërguar pako të fletëvotimeve në emër të këtyre personave dhe të njëjtat janë të numëruara si fletëvotime të rregullta, e që e bëjnë procesin e votimit me postë për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut të paligjshëm.

Ngakonstatimi zyrtari PZAP-it, i datës 26.11.2017, paneli konstaton se nga 60 (gjashtëdhjetë) votuesit nga Austria, me të cilët është tentuar nga PZAP-i, të kontaktohet përmes numrit të telefonit të cilin e kishin paraqitur votuesit me rastin e aplikimit si votues jashtë

Kosove, në Formularin e Aplikimit të Votimit Jashtë Kosovës, për ti pyetur se a kanë aplikuar si votues jashtë Kosove dhe a kanë votuar, në rundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetarin e Komunës së Istogut, rezulton se nga 60 tentimet për te kontaktuar me votuesit, 56 prej tyre nuk janë lajmëruar, por vetëm është lajmëruar sekretaria e operatorit se numri konkret është i pa qasshëm, ndërsa 2 votues në emër të tyre janë lajmëruar dy gjerman folës, 1 votues, ka deklaruar se ka aplikuar si votues jashtë Kosove, por nuk ka votuar në Rundin e Dytë të Zgjedhjeve, ndërsa në shkresat e lëndës rezulton se i njëjti ka votuar, kurse një votues tjetër, është paraqitur në emër të bashkëshortes së tij e cila ishte votuese në këtë rast, por njëjti deklaroi se bashkëshortja e tij, nuk ka votuar dhe asnjëherë nuk ka aplikuar për tu regjistruar si votuese jashtë Kosove. Për më shumë të dhëna lidhur me identifikimin e votuesve të lartpërmendur gjenden në konstatimin zyrtar të PZAP-it, të datës 26.11.2017.

Nga konstatimi zyrtar i PZAP-it, i datës 27.11.2017, paneli konstaton se nga 10 (dhjetë) votuesit nga Mali i Zi, me të cilët është tentuar nga PZAP-i, të kontaktohet përmes numrit të telefonit të cilin e kishin paraqitur votuesit me rastin e aplikimit si votues jashtë Kosove, në Formularin e Aplikimit të Votimit Jashtë Kosovës, për ti pyetur se a kanë aplikuar si votues jashtë Kosove dhe a kanë votuar, në rundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetarin e Komunës së Istogut, rezulton se nga 10 tentimet për te kontaktuar me votuesit, 8 prej tyre nuk janë lajmëruar por vetëm është lajmëruar sekretaria e operatorit se numri konkret është i pa qasshëm, ndërsa për 2 votues, në emër të tyre janë lajmëruar dy persona dhe që te dy kanë deklaruar se keni thirrur në numrin e gabuar dhe personin që e kërkoni nuk e posedon këtë numër të telefonit. Për më shumë të dhëna lidhur me identifikimin e votuesve të lartpërmendur gjenden në konstatimin zyrtar të PZAP-it, të datës 27.11.2017.

Nga konstatimi zyrtar i PZAP-it, i datës 27.11.2017, paneli konstaton se nga 10 (dhjetë) votuesit nga Sllovenia, me të cilët është tentuar nga PZAP-i, të kontaktohet përmes numrit të telefonit të cilin e kishin paraqitur votuesit me rastin e aplikimit si votues jashtë Kosove, në Formularin e Aplikimit të Votimit Jashtë Kosovës, për ti pyetur se a kanë aplikuar si votues jashtë Kosove dhe a kanë votuar, në rundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetarin e Komunës së Istogut, rezulton se nga 10 tentimet për te kontaktuar me votuesit,

9 prej tyre nuk janë lajmëruar por vetëm është lajmëruar sekretaria e operatorit se numri konkret është i pa qasshëm, ndërsa për 1 votues, në emër të tij është lajmëruar një person që është paraqitur në gjuhën Sllovene, dhe i cili ka refuzuar të komunikoj për arsyen e thirrjes. Për më shumë të dhëna lidhur me identifikimin e votuesve të lartpërmendur gjenden në konstatimin zyrtar të PZAP-it, të datës 27.11.2017.

Paneli nga hetimi i bërë lidhur me zarfet e jashtme për votuesit me post, Bazuar nën 4 par.2 të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, përcaktohet se një votues me post, duhet që të dërgon fletëvotimin me dy zarfe, dhe atë në zarfin e parë apo të jashtëm duhet të jetë një fotokopje e dokumentit identifikues që përmban të dhënat personale të votuesit, vlerëson se të gjithë votuesit me Postë, nga Austria, Mali i Zi dhe Sllovenia, që kanë votuar për rundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale për Komunën e Istogut, i kanë dërguar zarfet e jashtme, për votim të plotësuar njëjtë, dhe për nga formati zarfet janë të njëjtë, poashtu edhe për nga ngjyra dhe firma "SIL", janë të njëjtë, edhe pse të njëjtit janë dërguar nga votues të ndryshëm dhe të shteteve të ndryshme.

Paneli duke u bazuar në Rregullën Nr.4/2015 të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet lidhur me pretendimet ankimore, duke e hetuar materialin zgjedhor brenda kutive të votimit me postë për Komunën e Istogut, siç janë: BM106/001, BM106/002, BM106/003, BM106/004, BM106/005 dhe BM106/006, nga të cilat hetime ka rezultuar:

- Në kutinë e votimit BM106/001, është konstatuar se pas hapjes së kutisë së votimit, brenda kësaj kutie janë gjetur zarfet e zbrazëta në të cilët kanë qenë fletëvotimet, numri i zarfeve ka qenë 226 gjithsejtë, prej të cilëve 218 zarfe, konstatohet nga procesverbali i hetimit se janë të njëjtit si për nga formati, ngjyra dhe firma "Monique" edhe pse të njëjtit janë dërguar nga votues të ndryshëm dhe të shteteve të ndryshme.

- Në kutinë e votimit BM106/002, është konstatuar se pas hapjes së kutisë së votimit, brenda kësaj kutie janë gjetur zarfet e zbrazëta në të cilët kanë qenë fletëvotimet, numri i zarfeve ka qenë 201 gjithsejtë, prej të cilëve 194 zarfe, konstatohet nga procesverbali i hetimit se janë të njëjtit si për nga formati, ngjyra dhe firma "Monique" edhe pse të njëjtit janë dërguar nga votues të

ndryshëm dhe të shteteve të ndryshme.

- Në kutinë e votimit BM106/003, është konstatuar se pas hapjes së kutisë së votimit, brenda kësaj kutie janë gjetur zarfet e zbrazëta në të cilët kanë qenë fletëvotimet, numri i zarfeve ka qenë 225 gjithsejtë, prej të cilëve 223 zarfe, konstatohet nga procesverbali i hetimit se janë të njëjtit si për nga formati, ngjyra dhe firma "Monique" edhe pse të njëjtit janë dërguar nga votues të ndryshëm dhe të shteteve të ndryshme.

- Në kutinë e votimit BM106/004, është konstatuar se pas hapjes së kutisë së votimit, brenda kësaj kutie janë gjetur zarfet e zbrazëta në të cilët kanë qenë fletëvotimet, numri i zarfeve ka qenë 221 gjithsejtë, prej të cilëve 216 zarfe, konstatohet nga procesverbali i hetimit se janë të njëjtit si për nga formati, ngjyra dhe firma "Monique" edhe pse të njëjtit janë dërguar nga votues të ndryshëm dhe të shteteve të ndryshme.

- Në kutinë e votimit BM106/005, është konstatuar se pas hapjes së kutisë së votimit, brenda kësaj kutie janë gjetur zarfet e zbrazëta në të cilët kanë qenë fletëvotimet, numri i zarfeve ka qenë 254 gjithsejtë, prej të cilëve 252 zarfe, konstatohet nga procesverbali i hetimit se janë të njëjtit si për nga formati, ngjyra dhe firma "Monique" edhe pse të njëjtit janë dërguar nga votues të ndryshëm dhe të shteteve të ndryshme.

- Në kutinë e votimit BM106/006, është konstatuar se pas hapjes së kutisë së votimit, brenda kësaj kutie janë gjetur zarfet e zbrazëta në të cilët kanë qenë fletëvotimet, numri i zarfeve ka qenë 194 gjithsejtë, prej të cilëve 187 zarfe, konstatohet nga procesverbali i hetimit se janë të njëjtit si për nga formati, ngjyra dhe firma "Monique" edhe pse të njëjtit janë dërguar nga votues të ndryshëm dhe të shteteve të ndryshme.

Nga kreu ajo çka u theksua me lart, lidhur me votimin me postë nga votuesit e Malit të Zi, Austrisë dhe Sllovenisë, për rundin e dytë të zgjedhjeve lokale, për kryetar të Komunës së Istogut, paneli vërtetoi se mënyra e votimit dhe dërgimi i pakove të fletëvotimeve, është bërë në mënyrë të organizuar, dhe nga shkresat e lëndës nuk rezultoi se votuesit në fjalë kanë votuar dhe kanë dërguar pako të fletëvotimeve personalisht. Andaj, mënyra e tillë e organizimit të votimit, vlerësohet nga paneli, si jo i ligjshëm dhe si i tillë e dëmton seriozisht dhe e minon procesin zgjedhor të raundit e dytë për

Kryetar në Komunën e Istogut. Për hetime të mëtejshme lidhur me elementet e veprës penale në këtë rast konkret, paneli duke u bazuar nënin 3 par.11 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me Nr.02/2015, lëndën do ta dërgon në Prokurorinë e Shtetit.

Paneli me rastin e vendosjes në këtë rast ka marr parasysh edhe pretendimet e subjektit politik Y.Y. të paraqitura nëpërmes përgjigjes në ankesë, në të cilën kanë theksuar se lista e njëjtë e votuesve jashtë Kosove, është shfrytëzuar edhe për rundin e parë të këtyre zgjedhje lokale, dhe se votuesit e njëjtë kanë votuar si në rundin e parë ashtu edhe në rundin e dytë të këtyre zgjedhjeve. Pretendimet e kësaj natyre të subjektit politik Y.Y. vlerësohen nga paneli si të paqëndrueshme sepse objekt shqyrtimi në këtë rast kanë qenë pretendimet e parashtruar nga ankuesi sipas ankesës së datës 24.11.2017, që ka të bëjë me votuesit me postë, nga shtetet siç janë Mali i Zi, Sllovenia dhe Austria për rundin e dytë të zgjedhjeve lokale për kryetar të Komunës së Istogut.

Paneli duke u bazuar në të gjitha shkeljet e theksuar me lart dhe arsyet e dhëna, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 120 par.1 pika b) të LZP-së, ku përcaktohet: "para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anuloi rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, ta urdhëroi KQZ-në, ti përsërisë votimin, në një qendër të votimit, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatin final, dhe në rrethana të jashtëzakonshme është në zgjedhjen e PZAP-së, për të anuluar rezultatet në një vendvotim". Pasi që konsiderohet nga paneli se fletëvotimet me postë për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për Kryetar të Komunës së Istogut, janë dëterminuese në rezultatin final dhe mënyra e votimit se si është votuar në këtë rast e dëmton seriozisht dhe e minon procesin zgjedhor të raundit e dytë të zgjedhjeve, për Kryetar në Komunën e Istogut.

Paneli vlerëson se në këtë situatë zgjidhja e vetme e drejtë, është që rundi i dytë i Zgjedhjeve Lokale, për Kryetar të Komunës së Istogut, të përsëritet dhe të shkohet në rivotim, pasi nuk është e drejtë që të anulohen vetëm fletëvotimet me postë, ndonëse është e qartë që me këto vota është manipuluar, nuk e kemi sigurinë e plotë të themi se të gjitha janë të manipuluar, sepse ka mundësi që në mesin e këtyre votave ka pasur edhe vota të rregullta, me qëllim që çdo votë e qytetarëve të shkojë në destinimin e saj, e vetmja

zgjidhje e drejtë dhe jo diskriminuese është rivotimi edhe atë në të gjitha vendvotimet e Komunës së Istogut.

KQZ-ja, me rastin e riorganizimit të rivotimit të rundit të dytë, të ndërmarrë të gjitha masat ligjore për të eliminuar parregullsitë e evidentuara, të lartcekura.

Andaj, paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120.1 pika b) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI -ZL A.nr. 1119/2017, Ligjshmëria e kandidaturës për kryetar të komunës.

Kandidati SH.S. për kryetar të Komunës X.X. nga subjekti politik N.N., ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Y.Y., me të cilën ka pretenduar se kandidati për kryetar të Komunës X.X., nga radhët e subjektit politik M.M., është certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi që kandidati në fjalë nuk ka qenë banor se paku 3 vite në Komunën X.X., për kryetar të se cilës ka kandiduar ashtu siç e përcakton ligji.

Paneli ankesën e parashtruar e ka hedhur si të pasafatshme për arsye se ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 26. paragrafi 6 të LZP-së i cili përcakton se: "Ankesa e cilit do subjekt politik ndaj vendimit të KQZ-së për të refuzuar certifikimin e listës së kandidatëve tek PZAP-i , bëhet brenda afatit prej pesë (5) ditë pune pas njoftimit të atij subjekti politik me vendimin".

VENDIM

HUDHET SI I PASAFATSHËM apeli i kandidatit për kryetar të Komunës së Kamenicës, SH.S. nga radhët e subjektit politik X.X. me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, me shenjen ZL.Anr.1119/2017 i datës 30.11.2017, kundër vendimit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Raundin e dytë, për Kryetar të Komunës, për shkak të ligjshmërisë së kandidaturës për kryetar të Komunës së N.N., Y.Y. nga radhët e subjektit politik M.M. për Zgjedhjet Lokale 2017.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 30.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Kandidati për Kryetar të Komunës së N.N., SH.S. nga radhët e subjektit politik X.X. paraqitur kundër vendimit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Raundin e dytë, për Kryetar të Komunës së N.N., paneli e ka trajtuar ankesën dhe procedura në këtë fazë të procesit zgjedhor si apel, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 3 par.8 Rregullës Nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. Sipas nenit 2 të Rregullës Nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Apel do të thotë mjetë i rregullt juridik, kundër vendimeve të organit të shkallës së parë, siç është KQZ-ja, në këtë rast, lidhur me nenin 122 të LZP-së.

Parashtresit e apelit, Kandidati për Kryetar të Komunës së N.N., SH.S. nga radhët e subjektit politik X.X., ku pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së N.N., Y.Y. nga radhët e subjektit politik M.M. është certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në kundërshtim me dispozitën e nenit 9.2 të Ligjit Nr. 03/L-072 , pasi që kandidati në fjalë ka qenë banor në Komunën e Prishtinës, pa qenë banor së paku 3 vite në Komunën e N.N., këtë kusht nuk e ka plotësuar. Po ashtu, Z.Z. drejtor i Administratës Komunale, tani nënkryetar i Komunës së N.N., e ka lajmëruar rastin në ARC, një ditë para certifikimit të kandidatëve për kryetar të Komunave të Republikës së Kosovës nga KQZ-ja, më datë 21.08.2017. Regjistrimi i Y.Y. si banor në Komunën e N.N. është bërë në kundërshtim me nenin 5.3 dhe 6.3 të Ligjit Nr. 02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin, pasi që ndërrimi i vendbanimit është bërë pa prezencën e personit në fjalë dhe pa dëshmi. Kërkon nga paneli që të vlerësoj ligjshmërinë e kandidaturës të Y.Y. për kryetar të Komunës së N.N. dhe me që kjo është bërë në mënyrë të kundërligjshme, ti anuloj zgjedhjet për kryetar të Komunës së N.N. Apelit i ka bashkangjitur Fletëregjistrimin e datës 21.08.2017, email i drejtorit të Administratës Komunale, Vërtetimi për lajmërimin/çlajmërimin e vendbanimit/vendqëndrimit i datës 21.08.2017 dhe Vërtetimi i datës 21.08.2017.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Pas përfundimit të procedurave për aplikim për certifikim, KQZ-ja me vendimin nr. 1545/3-2017 të datës 30.08.2017, ka miratuar rekomandimin e Zyrës për Certifikimin e Partisë Politike, M.M. për pjesëmarrjen në Zgjedhje Lokale, me kandidatët për kryetar të Komunave dhe kandidatët për anëtar të Kuvendeve Komunale me gjithsejtë 875 (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) kandidatë nga subjekti politik M.M. në mesin e këtyre kandidatëve është edhe Y.Y., kandidatë për Kryetar të Komunës së N.N. Afati për paraqitjen e ankesës kundër këtij vendimi ka qenë deri më datë 04.09.2017, dhe ndaj këtij vendimi palët nuk kanë ushtruar ankesë që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 26.6 të LZP-së i cili përcakton se: "Ankesa e cilit do subjekt politik ndaj vendimit të KQZ-së për të refuzuar certifikimin e listës së kandidatëve tek PZAP-i bëhet brenda afatit prej pesë (5) ditë pune pas njoftimit të atij subjekti politik me vendimin".

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë ne kuptim të nenit 118, neni 26.6 të LZP-së si dhe neni 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI-ZL A.nr. 1125/2017, Parregullsi gjatë ditës së votimit dhe shpallja e rezultateve përfundimtare

Kandidati A.A. për Kryetar të Komunës X.X. nga subjekti politik N.N., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), ka parashtruar apel kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar për raundin e dytë të zgjedhjeve, duke pretenduar që KQZ-ja me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nuk e ka marr parasysh eliminim e shkeljeve që janë bërë nga subjekti politik V.V., në ditën e votimit, ngase subjekti politik VV ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, duke ndikuar në votues përmes simpatizantëve dhe anëtareve të këtij subjekti politik në mënyrë të organizuar, përmes shfrytëzimit të shërbimeve të transportit, shërbimeve telefonike, dërgimit e SMS-ve, e krejt me qëllim që të i organizojë votuesit dhe të i dërgojë

për të votuar në QV-të. Këto veprime të subjektit politik VV sipas parashtruesit të ankesës janë të kundërligjshme dhe kanë ndikuar në vullnetin e lirë të qytetarëve me të drejtë vote në komunën X.X., si në vendvotimet e paraqitura në apel, dhe duke pretenduar se në këtë rast, nga i njëjti subjekt politik ka pasur edhe votim zingjiror, apo i njohur nga praktika si “treni bullgar”. I ka propozuar panelit që apeli të aprovohet si i bazuar dhe të rinumërohen fletëvotimet në vendvotimet e paraqitura në formë tabelare.

Paneli pjesën e ankesës që ka të bëjë me të gjitha pretendimet që ndërlidhen me parregullsitë në ditën e votimiti hedh si të palejueshme, sepse këto pretendime nga parashtruesi i apelit janë ushtruar në panel me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për raundin e dytë, e siç dihet në këtë fazë të procesit zgjedhor janë të lejuara ankesat vetëm sa i përket publikimit të rezultatit, por jo për parregullsitë që ndërlidhen me ditën e votimit.

Ndërsa lidhur me pjesën e ankesës që ka të bëjë me shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotimet e parashtruara nga ankuesi e ka refuzuar si të pabazuar, pasi që paneli i ka hapur dhe rinumëruar 31 kuti të votimeve, dhe ka vlerësuar se parregullsitë e gjetura pas hetimit kanë qenë pa ndikim në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

VENDIM

I. HIDHET I PALEJUESHËM,

apeli i Kandidatit për Kryetar të Komunës së Prishtinës A. A. nga radhët e subjektit politik X.X. në pjesën që ka të bëjë me parregullsitë e paraqitura për ditën e votimit, të Raundit të Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Prishtinës, të mbajtura me datë 19.11.2017.

II. REFUZOHET si i pabazuar apeli Kandidatit për Kryetar të Komunës së Prishtinës A.A. nga radhët e subjektit politik X.X. dhe i subjektit politik X.X. me seli në Prishtinë, në pjesën që ka të bëjë me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Raundit të dytë, për Kryetar të Komunës së Prishtinës, të mbajtura me datën 19.11.2017.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 30.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Kandidati për Kryetar të Komunës së Prishtinës A.A. nga radhët e subjektit politik X.X. dhe të subjektit politik X.X. me seli në Prishtinë, paraqitur

kundër vendimit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Raundin e dytë, për Kryetar të Komunës së Prishtinës, paneli e ka trajtuar dhe proceduar në këtë fazë të procesit zgjedhor si apel, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 3 par.8 Rregullës Nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. Sipas nenit 2 të Rregullës Nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Apel do të thotë mjetë i rregullt juridik, kundër vendimeve të organit të shkallës së parë, siç është KQZ-ja, në këtë rast, lidhur me nenin 122 të LZP-së.

Parashtruesit e apelit, Kandidati për Kryetar të Komunës së Prishtinës A.A. nga radhët e subjektit politik X.X. dhe subjekti politik X.X., me seli në Prishtinë, kanë pretenduar se, subjekti politik Y.Y. gjatë raundit të dytë të zgjedhje për kryetar Komune në Prishtinë, të mbajtura me datë 19.11.2017, ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Rregullat Zgjedhore dhe gjithashtu ka shkelur të drejtat që janë të garantuar me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me Konventat Ndërkombëtare, sipas parashtruesit të ankesës. Të cilat shkelje kanë ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të këtyre zgjedhjeve. Sepse subjekti politik Y.Y. përmes personave/simpatizantëve dhe anëtarëve të tyre në mënyrë të organizuar përmes shfrytëzimit të shërbimeve të transportit rrugor/taksive, thirrjeve telefonike dhe dërgimit të SMS-ve nga ata persona të organizuar nga Y.Y. ka ndikuar jo ligjshëm në vullnetin e lirë të qytetarëve me të drejtë vote në Komunën e Prishtinës, duke bartur qytetarët në vendet e tyre të votimit. Këto veprime janë pranuar publikisht nga kryetari i subjektit politik Y.Y. V.Y, më datë 21.11.2017. Më tej parashtruesi i apelit ka theksuar se është shkelur parimi i fshehtësisë së votës nga shkaku se nga ata qytetar që janë bartur përmes atij organizimi antiligjor nga ana e subjektit politik Y.Y. dhe është kërkuar që të japin votën në ditën e zgjedhjeve për subjektin e tyre dhe kjo është në kundërshtim me të drejtën kushtetuese të secilit, për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike. Duke pasur parasysh rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të shpallur nga KQZ-ja, për Komunën e Prishtinës që është shumë i ngushtë në vota dhe ka një numër të madh të fletëvotimeve të pavlefshme të cilat nëse verifikohen për nga saktësia lehtësisht mund të jenë vota të vlefshme. Po ashtu

duke marr parasysh edhe faktin se nuk ka përputhje të votave nga ana e KQZ-së me raportet e subjektit politik X.X. kjo vë në dyshim saktësinë e fletëvotimeve të pavlefshme si dhe komplet e votave të përgjithshme në Komunën e Prishtinës. Gjatë numërimit në vendvotime të caktuara dhe sidomos në vendvotimet në të cilat për nga numri i votave prinë kandidati A.A. i subjektit politik X.X. këtë e dëshmojnë edhe vëzhguesit e X.X. me foto apo të shënuar në Libër Votimi 1903e (Sh.F. "Faik Konica"), 1904e Sh.F "Dardania", 1906e Fakulteti Filologjik dhe 1909e Sh.f. "Hasan Prishtina". Prandaj fletëvotimet në fjalë sikur edhe fletëvotimet e zbrazëta dhe të dëmtuara janë konsideruar/shpallur si të tilla në kundërshtim me standartet e përcaktuara të KQZ-së, të cilat janë të përshkruara në Doracakun e KQZ-së. Nga formularët në të cilat shihet haptas se është ndërhyrë nga ana e kryesueseve të KVV-ve, e të cilat pavarësisht përputhjeve matematikore që mund ti gjejmë, organet kompetente, në këtë rast KQZ nuk ka arritur të ofroj prova bindëse se votat janë sipas ndërhyrjes apo ashtu siç kanë qenë para ndërhyrjes. Gjithashtu, gjatë procesit të administrimit të numërimit në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR), është vërejtur se në disa raste tek zarfet e fletëvotimeve me kusht kanë munguar fletëvotimet brenda tyre, si rrjedhojë, nga praktikat e deri tanishme, ne e dimë që sa herë mungojnë fletëvotimet në këtë mënyrë, ka shumë gjasa prandaj edhe ne besojmë të ketë ndodhur praktika e "Trenit bullgar" që është një praktikë e njohur ndërkombtarisht.

Këto veprime kanë ndikuar në rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja, ku ankuesi i parë kandidati A.A. del si humbës në zgjedhje me një dallim shumë të vogël të votave. Nisur nga fakti se rezultati është jashtëzakonisht i ngusht dhe standardi deri në një përqindje të dallimit në votë shërben ndërkombtarisht si pikë referimi për rinumërim të votave në rast të konstatimit dhe sipas ankesës së shtruar nga pala kandidat i pakënaqur, rinumërimi i tërësishëm i votave në Komunën e Prishtinës del si i domosdoshëm dhe ligjërish i bazuar. Subjekti politik X.X. ka kërkuar nga PZAP që të urdhëroj KQZ-në që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e rregullta, vlerësoj fletëvotimet e pavlefshme, të zbrazëta dhe të dëmtuara dhe të kontrolloj zarfet e fletëvotimeve me kusht të cilat nuk janë konfirmuar dhe nuk janë hapur fare. Me vendimin e datës 29.11.2017, KQZ-ja ka shkëlur parimet e lartë cekura përkatësisht ka legjitimuar

veprimet e subjektit politik Y.Y. në kundërshtim me rregullat e KQZ-së, Ligjin mbi Zgjedhjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KQZ, me përgjigjen në apel të datës 01.12.2017, ka theksuar se duke u bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.06/2013, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), të gjitha materialet sensitive dhe josensitive, të cilat dorëzohen nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), në QNR, pas pranimit të materialit zgjedhor ka bërë verifikimin, hetimin dhe auditimin e materialit zgjedhor dhe mos përputhjet në mes të Formularëve të Përputhjes së Rezultateve (FPR) dhe Formularëve të Rezultateve të Kandidatëve (FRK) dhe i rekomandon KQZ-së, për rinumërim apo anulim të ati rezultatit për vendvotimet e caktuara. Andaj, nuk ekziston bazë ligjore në pretendimet e palës ankuese se fletëvotimet e pavlefshme si dhe ato të zbrazëta të konsiderohen si prova për rinumërim. Po ashtu anëtarët e Këshillit të Vendvotimit (KVV), e nënshkruajnë FPR-në dhe FRK-në, pas përfundimit të procesit të votimit dhe numërimit, kjo nënkupton se në momentin e nënshkrimit, të formularëve të lartcekur, KVV-të, janë pajtuar me përmbylljen e procesit dhe se i njëjti bartet në KKZ e pastaj në QNR.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë dhe bazueshmërisë së apelit, në kuptim të nenit 117 par. 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se pretendimet e parashtruesit të apelit në pjesën që ka të bëjë me parregullsitë për ditën e votimit të datës 19.11.2017, në këtë fazë të procesit zgjedhor janë të palejueshme siç është vendosur në pjesën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ndërsa pretendimet që ndërlidhen me administrimin në QNR dhe rezultatin përfundimtar, refuzohen si të pabazuara, siç është vendosur në pjesën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, për këto arsye:

Siç është e përcaktuar me LZP dhe me Rregulla Zgjedhore, secila fazë e procesit zgjedhor, i ka afatet e caktuara ligjore, për të parashtruara ankesa dhe apele në PZAP, që ndërlidhen me fazën e procesit zgjedhor, që është duke u zhvilluar. Në këtë rast konkret, tani jemi në fazën e procesit zgjedhor, pas publikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve lokale për raundit të dytë, të mbajtura me datë 19.11.2017, për kryetar të komunave.

Paneli vlerëson se kjo fazë e procesit zgjedhor, është e ankimeshme vetëm sa i për ketë vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar, për kryetar të komunave dhe atë për parregullsitë e shkaktuar gjatë administrimit të të dhënave në QNR,

mospërputhjet e FPR-ve, FRK-ve, dhe provave që eventualisht i sjell pala që ka interes ligjor, e të cilat prova nuk përputhen me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, apo parregullsitë të cilat kanë qenë të ditura publikisht dhe që janë konsideruar nga paneli se mund të kenë ndikim drejtpërdrejt në rezultat final dhe që minojnë procesin zgjedhor, por nuk janë përmirësuar respektivisht nuk janë eliminuar nga KQZ-ja, edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, siç është rasti i Parteshit, i vendosur nga PZAP-i, për parregullsitë për ditën e votimit me vendimin ZL.Anr.447/2017 i datës 25.10.2017 dhe vendimi i PZAP-it, për të njëjtën komunë, i vendosur pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, për kryetar të kësaj Komune, ZL.Anr.560/17 i datës 02.11.2017, dhe i vërtetuar me vendimin e Gjykatës Supreme U.ZH.-A.A.nr.28/2017 i datës 06.11.2017.

Prandaj, pretendimet ankimore të parashtruesve të apelit, se në ditën e votimit për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale të mbajtura me datë 19.11.2017, se subjekti politik Y.Y. përmes personave/simpatizantëve dhe anëtarëve të tyre në mënyrë të organizuar përmes shfrytëzimit të shërbimeve të transportit rrugor/taksive, thirrjeve telefonike dhe dërgimit të SMS-ve, nga persona të organizuar, duke bartur qytetarët në vendet e tyre të votimit, e që sipas parashtruesve të apelit, kanë ndikuar jo ligjshëm, në vullnetin e lirë të qytetarëve, me të drejtë vote në Komunën e Prishtinës, janë pretendime të cilat në këtë fazë të procesit zgjedhor paneli i vlerëson si të paluejshme, sepse për të gjitha parregullsi që ndërlidhen me ditën e votimit, afati për të parashtruar ankesë në PZAP, ka qenë 24 orë nga mbyllja e Qendrave të Votimit, në këtë rast afati për të parashtruar ankesë në PZAP, ka qenë deri me datë 20.11.2017, në ora 19:00.

Dispozita ligjore e nenit 119 par.1 të LZP-së me Nr.03/L-073, i ndryshuar dhe i plotësuar me LIGJIN Nr. 03/L-256, parasheh se: "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore,, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa".

Për më tepër paneli, lidhur me pretendimet ankimore respektivisht

për parregullsitë në ditën e votimit të raundit të dytë të zgjedhjeve lokale të mbajtura me datë 19.11.2017, ka vendosur me vendimin ZL.Anr.1102/2017 i datës 22.11.2017, pas ankimit ndaj këtij vendimi nga pala me interesi ligjor, është vendosur edhe nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës sipas Aktvendimit AA.Nr.52/2017 i datës 25.11.2017.

Andaj, paneli nga arsyet e theksuara me lart dhe duke u bazuar në dispozitën e lart cituar ligjore vendosi si në pjesën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, lidhur me pretendimet e parashtruesve të apelit që ndërlidhen me ditën e votimit.

Ndërsa lidhur me pretendimet e parashtruesve të apelit se edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, nuk janë eliminuar parregullsitë në QNR, siç janë rivlerësimi i votave të pavlefshme, më këtë rast parashtruesi i apelit, i ka bashkangjitur një listë statistikore të KQZ-së, me 31 vendvotime, ku në secilin vendvotim shihet se janë shpallur nga 5 (pesë) fletëvotime, deri në 9 (nëntë) fletëvotime, të pavlefshme, për vendvotim.

Paneli me qëllim të hetim, dhe verifikim të pretendimeve ankimore përkitazi me parregullsitë e fletëvotimeve si të pavlefshme dhe pretendimin se në zarfet e votave me kusht kanë munguar disa fletëvotime, e që pretendohet në parregullsitë zingjirore gjatë procesit të votimit apo siç është e njohur në publik "treni bullgar" me datën 01.12.2107, ka angazhuar ekipet hetuese të PZAP-it, për të zhvilluar hetimet në QNR, konform Nenit 14 të Rregullës nr.02/2015 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së, i cili përcakton se; "Kur PZAP-i pranon një ankesë që konsiderohet të jetë e rregullt, dhe kur një ankesë apo apel është e dyshuar për veprimtari mashtruese që përfshin materialin zgjedhor, Paneli vendimmarrës do të autorizoj një anëtar të panelit, si hetues kryesor si dhe zyrtarin ligjor të ngarkuar në çështjen konkrete që ti zhvilloj hetimet".

Ekipet hetuese të PZAP-it, të kryesuara prej 8 (tetë) gjyqtarëve dhe 10 (dhjetë) zyrtarëve të sekretariatit, i kanë shikuar dhe rivlerësuar votat e pavlefshme, i kanë rinumëruar votat e rregullta dhe i kanë shikuar, vultat e fletëvotimit a po përputhën me numrin e vendvotimit në mënyrë që të eliminohen dyshimet se kanë ekzistuar parregullsitë e pretenduara zingjirore gjatë procesit të votimit, e që nuk janë eliminuar nga KQZ-ja, as me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar. Vendvotimet të cilat kanë qenë objekt

i hetimit nga PZAP-it, janë ato vendvotime, siç u theksua me lart, që vetë parashtruesit e apelit i kanë bashkangjitur apelit, një tabelë statistikore, si dëshmi se nga sa fletëvotime janë shpallur si të pavlefshme në secilin vendvotim, e të cilat vendvotime janë: 1901E/02R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1902E/04R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1903E/04R janë shpallura 7 fletëvotime të pavlefshme, 1904E/06R janë shpallura 8 fletëvotime të pavlefshme, 1905E/01R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1905E/05D janë shpallura 7 fletëvotime të pavlefshme, 1911E/02R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1911E/04R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1911E/06R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1912E/02R janë shpallura 6 fletëvotime të pavlefshme, 1916E/03R janë shpallura 9 fletëvotime të pavlefshme, 1919E/03R janë shpallura 6 fletëvotime të pavlefshme, 1919E/05R janë shpallura 6 fletëvotime të pavlefshme, 1919E/01R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1920E/02R janë shpallura 8 fletëvotime të pavlefshme, 1920E/05R janë shpallura 6 fletëvotime të pavlefshme, 1920X/01R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1920X/02R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1920X/03R janë shpallura 7 fletëvotime të pavlefshme, 1921E/03R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1921X/01R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1921X/02R janë shpallura 6 fletëvotime të pavlefshme, 1921X/04R janë shpallura 8 fletëvotime të pavlefshme, 1921X/05R janë shpallura 6 fletëvotime të pavlefshme, 1923E/01R janë shpallura 7 fletëvotime të pavlefshme, 1926E/03R janë shpallura 7 fletëvotime të pavlefshme, 1927E/04R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1927E/08D janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, 1931E/02R janë shpallura 7 fletëvotime të pavlefshme, 1940E/02R janë shpallura 6 fletëvotime të pavlefshme dhe Vendvotimin 1962E/01D janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme.

Nga procesverbalet e hetimit të PZAP-it, të krijuara në QNR, për secilin nga vendvotimet e lartë shënuar, paneli konstaton se nga këto 31 kuti të votimeve, që janë shpallur si të pavlefshme 183 fletëvotime, prej të cilave paneli ka vlerësuar se vetëm katër fletëvotime, në katër kuti të votimeve, janë të vlefshme, ndërsa tjera janë të pavlefshme ashtu siç janë shpall të pavlefshme nga këshillat e vendvotimeve, të cilat vendvotime janë:

- Në Vendvotimin 1902E/04R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, pas rivlerësimit të fletëvotimeve nga ekipi hetues i PZAP-it, duke e bazuar vlerësimin në Doracakun për Votuesit, rezulton se janë 4 fletëvotime të pavlefshme, ndërsa një fletëvotim është i rregullt, ku votuesi ka votuar Sh.A., kandidat për kryetar të Prishtinës nga radhët e subjektit politik Y.Y..
- Në Vendvotimin 1912E/02R janë shpallura 6 fletëvotime të pavlefshme, pas rivlerësimit të fletëvotimeve nga ekipi hetues i PZAP-it, duke e bazuar vlerësimin në Doracakun për Votuesit, rezulton se janë 5 fletëvotime të pavlefshme, ndërsa një fletëvotim është i rregullt, ku votuesi ka votuar Sh.A., kandidat për kryetar të Prishtinës nga radhët e subjektit politik Y.Y..
- Në Vendvotimin 1919E/01R janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, pas rivlerësimit të fletëvotimeve nga ekipi hetues i PZAP-it, duke e bazuar vlerësimin në Doracakun për Votuesit, rezulton se janë 4 fletëvotime të pavlefshme, ndërsa një fletëvotim është i rregullt, ku votuesi ka votuar A.A., kandidat për kryetar të Prishtinës, nga radhët e subjektit politik X.X. dhe,
- Në Vendvotimin 1962E/01D janë shpallura 5 fletëvotime të pavlefshme, pas rivlerësimit të fletëvotimeve nga ekipi hetues i PZAP-it, duke e bazuar vlerësimin në Doracakun për Votuesit, rezulton se janë 4 fletëvotime të pavlefshme, ndërsa një fletëvotim është i rregullt, ku votuesi ka votuar A.A., kandidat për kryetar të Prishtinës, nga radhët e subjektit politik X.X..

Përveç ndryshimeve të katër votave të pavlefshme, e që janë vlerësuar nga paneli si të vlefshme, të theksuara më lart, ekipet hetuese të PZAP-it, nuk kanë gjetur asnjë parregullsi tjetër, në 31 vendvotimet-kutitë e votimeve, që ishin objekt i hetimit.

Kutitë e votimit që ishin objekt i hetimit, ekipet hetuese të PZAP-it, përveç rivlerësimit të fletëvotimeve të pavlefshme, i kanë rinumëruar të gjitha fletëvotimet e rregullta për te dy kandidatët që ishin në garën zgjedhore të datës 19.11.2017, për kryetar të Prishtinës, janë shikuar vulat mbrapa të çdo fletëvotimi çoftë i rregullt apo i pavlefshëm dhe janë shikuar FPR, dhe ka rezultuar se të gjitha këto kanë qenë në harmoni me rezultatin përfundimtar të shpallur në KQZ-ja.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, vërtetoj se parashtruesit e apelit, nuk kanë arritur me prova, ti vërtetojnë

pretendimet në apel përkitazi me mospërputhjet e rezultati përfundimtar me FPR, FRK dhe Fletëvotimet e Pavlefshme. Po ashtu parashtruesit e apelit me asnjë dëshmi nuk i kanë vërtetuar pretendimet e tyre për parregullsitë zingjirore se kanë ekzistuar dhe të cilat sipas parashtruesve të apelit, nuk janë eliminuar nga KQZ-ja edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar.

Andaj, nisur nga të gjitha arsyet e dhëna më lart, paneli vendosi si në pjesën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 117 lidhur me nenin 118 të LZP-së, për pjesën që është refuzuar apeli.

VENDIMI- ZL.A.nr.1128/2017, Votim me kusht i personave të cilët nuk kanë qenë në listën e votuesve

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), ka pranuar ankesë nga subjekti politik N.N., dega në komunën X.X., e paraqitur kundër subjektit politik X.X., për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve - për rivotim për Kryetar të Komunës X.X. të mbajtura më datë 17.12.2017.

Paneli ka vlerësuar se ankuesi me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij, dhe se ankesa është e përgjithësuar dhe pa argumentuar me prova e fakte. Për këto arsye, paneli në përputhje me nenin 117 paragrafi 3 i Ligjit nr.03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka refuzuar ankesën.

VENDIM

REFUZOHET si i pabazuar ankesa e parashtruar nga subjektit politik N.N. dega në Istog, me shenjën ZL.Anr.1128/2017, të datës 18.12.2017, paraqitur kundër subjektit politik X.X. dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për rivotim për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura më datë 17.12.2017.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1128/2017 me datën 18.12.2017, nga subjektit politik N.N. dega në Istog, në të cilën

pretendon se në vendvotimin 0619c/02D, në fshatin Savadran kanë votuar me kusht persona që nuk janë në listë zgjedhore për Istog. Parashtruesi i ankesës kërkon që të hapet kjo kuti dhe të hetohet materialin sensitiv. Në mbështetje pretendimeve në ankesë ka bashkangjitur deklaratën e komisionarit H.M. i cili pohon se R.N. dhe N.D. kanë votuar në vendvotimin në Staradran 0619C/02D.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me përgjigjen në ankesë të datës 19.12.2017, ka theksuar se personat e përmendur në ankesë R.N. dhe N.D. kanë qenë të regjistruar në Komuna tjera në Pejë dhe Gjilan andaj edhe votat e tyre janë refuzuar për arsye se nuk kanë qenë të regjistruar në listën përfundimtare të votueseve për Komunën e Istogut.

PZAP-i, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Panelipasvlerësimittëpretendimeveankimoregjetiseparashtruesi në ankesë me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij. Prandaj, Paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në deklaratën e bashkangjitur nga komisioneri H.M. se kanë votuar votuesit R.N. dhe N.D. në vendvotimin 0619C/02D në Staradran të Komunës së Istogut nga përgjigja e KQZ-së vërtetohet fakti se të njëjtat vota janë refuzuar pasi të dy votuesit nuk janë në listën përfundimtare të votueseve të Komunës së Istogut.

Në ankesën e parashtruar ndonëse është kërkuar nga PZAP që të hapet kutia e votave me kusht në vendvotimin 0619C/02D, dhe të hetohet materiali sensitiv, në ankesë nuk janë bashkangjitur prova me të cilat do të rezultonte se kemi të bëjmë me parregullsi zgjedhore, përveç deklaratës të komisionerit H.M. për dy votues për të cilët u dha sqarimi si më lart.

PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmime konkrete dhe bindëse ankesën e ankuesit e refuzoj si të pa bazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

VENDIMI - ZL.Anr.1142/2017, Shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale për kryetar komune – Raundi i dytë-Rivotim

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka pranuar me datën 22.12.2017 apel nga përfaqësuesi i subjektit N.N., kundër vendimit të KQZ-së, për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Rivotim, për Kryetar të Komunës X.X., për shkak të cenimit të drejtave kushtetuese zgjedhore dhe parregullsive gjatë procesit zgjedhor të datës 17.12.2017, nën pretendimin se në ditën e rivotimit më datë 17.12.2017 si dhe gjatë administrimit të numërimit në QNR, është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Zgjedhjet Lokale dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës.

Paneli e ka hedhur si të palejuar apelin në pjesën që ka të bëjë me parregullsitë për ditën e rivotimit të datës 17.12.2017, pasi që në këtë fazë të procesit zgjedhor - apelet janë të palejueshme, sepse për të gjitha parregullsitë që ndërlidhen me ditën e votimit, afati për të parashtruar ankesë në PZAP, është 24 orë nga mbyllja e Qendrave të Votimit.

Ndërsa, Paneli e ka refuzuar si të pabazuar apelin e subjektit politik që ka të bëjë më rezultatin përfundimtar të ditës së Rivotimit, për Kryetar të Komunës X.X., pasi që gjeti se parashtruesi i apelit, nuk ka arritur që me prova, ti vërtetojë pretendimet e tij në apel.

VENDIM

I. HIDHET I PALEJUESHËM, apeli i subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të X.X. me seli në Prishtinë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Kryetar të Komunës së Istogut, në pjesën që ka të bëjë me parregullsitë e paraqitura për ditën e Rivotimit për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura me datë 17.12.2017.

II. REFUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik N.N. me seli në Prishtinë, dega në Istog, në pjesën që ka të bëjë më rezultatin përfundimtar të ditës së Rivotimit, për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura, me datën 17.12.2017.

Arsyetim

PZAP, më datë 22.12.2017, ka pranuar një apel nga subjekti politik N.N. paraqitur kundër vendimit të X.X. me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, për Rivotimin e Kryetarit të Komunës së Istogut, paneli e ka trajtuar dhe proceduar në këtë fazë të procesit zgjedhor si apel, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 3 par. 8, të Rregullës Nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. Sipas nenit 2 të Rregullës Nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Apel do të thotë mjetet e rregullt juridik, kundër vendimeve të organit të shkallës së parë, siç është KQZ-ja, në këtë rast, lidhur me nenin 122 të LZP-së. Parashtruesi i apelit ka pretenduar se në ditën e rivotimit më datë 17.12.2017 si dhe gjatë administrimit të numërimit në QNR është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Zgjedhjet Lokale dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës.

Sipas parashtruesit të apelit është minuar integriteti i zgjedhjeve nga ana e KQZ-së, për shkak të shpalljes fitues kandidatit e nga subjekti politik N.N. G.D. në rezultatin preliminar të rivotimit, ndërsa në ditët në vijim për shkak të disa kinse gabimeve teknike, ka shpallur fitues kandidatit e Y.Y., H.R..

Lidhur me administrimin e numërimit në QNR, parashtruesi i apelit ka theksuar se votat e 52 votuesve nuk janë numëruar dhe nuk janë përfshirë në rezultatin përfundimtarë, sepse emrat e tyre nuk kanë figuruar në Listën Përfundimtare të Votuesve, dhe se gjatë administrimit të numërimit në QNR votat e 50 votuesve, të tjerë nuk iu janë numëruar dhe llogaritur në Rezultatin Përfundimtarë për arsye të panjohura për subjektin politik AAK. Gjithashtu thekson se në ditën e zgjedhjeve janë arrestuar disa persona nga Policia e Kosovës, nën dyshimin e kryerjes së veprave penale kundër të drejtave të votimit, dhe po të njëjtën ditë sipas vlerësimit të vëzhguesve të akredituar votimi me asistencë, kishte arritur përqindjen në 20% të numrit të përgjithshëm të votuesve. Më tutje parashtruesi i apelit thekson se duke pasur parasysh rezultatin e ngushtë ndërmjet kandidatëve garues për pozitën e Kryetarit të Komunës së Istogut, ku dallimi është 14 vota, çdo shkelje gjatë procesit të votimit dhe Administrimit të Numërimit në QNR pa dyshim ka ndikuar në shtrembërimin e rezultatit, duke mos reflektuar vullnetin e qytetarëve të Komunës

së Istogut. Me propozim për panelin që të aprovohet apeli si i bazuar dhe pas shqyrtimit të dëshmimeve relevante të anuloj Rezultatet e Rivotimit të datës 17.12.2017 dhe të Urdhëroj përsëritjen e Votimit në Komunën e Istogut.

X.X-ja, me përgjigjen në apel të datës 23.12.2017, ka theksuar se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, Neni 7.1, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve, është e saktë dhe e azhurnuar, dhe e njëjta përmban; ekstraktin nga Regjistrit Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësi, dhe të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës. Mëtej X.X. në përgjigje në apel thekson se në pikën 1 dhe pika 5 të ankesës, së parashtruar, gjatë administrimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ku janë refuzuar votat e pesëdhjetë e dy (52) votuesve, për shkak se emrat e tyre nuk kanë qenë në Listën përfundimtare të Votuesve, por që kanë pasur moshën 18 vjeçare në zgjedhjet e datës 17.12.2017, në komunën e Istogut, theksojnë se Ekstrakti i Regjistrit Qendror Civil ka përmbajtur të gjithë emrat e votuesve të regjistruar të moshës 18 vjeçare, duke përfshirë edhe ata që i kanë mbushur 18 vjeç deri në ditën e zgjedhjeve, më 22 tetor 2017. Sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 02/ 2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 3.3, me qëllim të krijimit të listës së votuesve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pranon tri (3) herë ekstraktin e Regjistrit Qendror Civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil. Herën e parë, jo më vonë se dy ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, herën e dytë jo më vonë se 3 ditë para fillimit të periudhës së kundërshtimit të listës së votuesve, si dhe herën e tretë jo më vonë se dy ditë pas përfundimit të periudhës së kundërshtimit të LV-së. Gjithashtu, votuesit kanë pasur mundësi që të kundërshtojnë listën e votuesve gjatë periudhave të shqyrtimit të saj, nga ana e publikut. Periudha kur lista e votuese ka mundur të kundërshtohet në gjykatën e shkallës së parë, është realizuar prej datës 29 gusht 2017 dhe ka përfunduar me datën 12 shtator 2017.

Po ashtu sipas përgjigjes në apel KQZ-ja, thekson se përsëritja e zgjedhjeve për kryetar komune në Istog, që u mbajtën me datë 17.12.2017 është vazhdimësi e zgjedhjeve lokale të datës 22 tetor

2017 dhe raundit të dytë të zgjedhjeve të datës 19.12.2017, Lista e votuesve për këtë komunë (sikurse për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës) përmban emrat e votuesve të moshës 18 vjeç dhe më të vjetër, duke përfshirë edhe votuesit që në ditën e zgjedhjeve më 22 tetor 2017, kanë mbushur moshën 18 vjeçare.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë dhe bazueshmërisë së apelit, në kuptim të nenit 117 par. 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se pretendimet e parashtruesit të apelit në pjesën që ka të bëjë me parregullsitë për ditën e rivotimit të datës 17.12.2017, në këtë fazë të procesit zgjedhor janë të palejueshme siç është vendosur në pjesën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ndërsa pretendimet që ndërlidhen me administrimin në QNR dhe rezultatin përfundimtar, refuzohen si të pabazuara, siç është vendosur në pjesën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, për këto arsye:

Siç është e përcaktuar me LZP dhe me Rregulla Zgjedhore, secila fazë e procesit zgjedhor, i ka afatet e caktuara ligjore, për të parashtruar ankesa dhe apele në PZAP, që ndërlidhen me fazën e procesit zgjedhor, që është duke u zhvilluar. Në këtë rast konkret, tani jemi në fazën e procesit zgjedhor, pas publikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve lokale për rivotim, të mbajtur me datë 17.12.2017, për Kryetarë të Komunës së Istogut.

Paneli vlerëson se kjo fazë e procesit zgjedhor, është e ankimeshme vetëm sa i për ketë vendimit të X.X. për shpalljen e rezultatit përfundimtar, për kryetar të komunave dhe atë për parregullsitë e shkaktuar gjatë administrimit të të dhënave në QNR, mospërputhjet e FPR-ve, FRK-ve, dhe provave që eventualisht i sjell pala që ka interes ligjor, e të cilat prova nuk përputhen me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, apo parregullsitë të cilat kanë qenë të ditura publikisht dhe që janë konsideruar nga paneli se mund të kenë ndikim drejtpërdrejt në rezultat final dhe që minojnë procesin zgjedhor, por nuk janë përmirësuar respektivisht nuk janë eliminuar nga X.X. edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, siç është rasti i Parteshit, ZL.Anr.447/17 i datës 25.10.2017, i vendosur nga PZAP-i, për parregullsitë për ditën e votimit me vendimin për të njëjtën komunë, i vendosur pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, për kryetar të kësaj Komune, ZL.Anr.560/17 i datës 02.11.2017, dhe i vërtetuar me vendimin e Gjykatës Supreme U.ZH.-A.A.nr.28/2017 i datës 06.11.2017, në

të cilat parregullsi ishte i përfshirë drejtpërsëdrejti kandidati për kryetar të asaj Komune.

Prandaj, pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit, se në ditën e rivotimit të mbajtura me datë 17.12.2017, votimi me asistencë, kishte arritur përqindjen në 20%, të numrit të përgjithshëm të votuesve, poashtu lidhur me pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me blerjen e votave siç thekson parashtruesi i ankesës duke ia bashkangjitur apelit një CD, për ti provuar pretendimet e tij, janë pretendime të cilat në këtë fazë të procesit zgjedhor paneli i vlerëson si të palejueshme, sepse për të gjitha parregullsitë që ndërlidhen me ditën e votimit, afati për të parashtruar ankesë në PZAP, ka qenë 24 orë nga mbyllja e Qendrave të Votimit, në këtë rast afati për të parashtruar ankesë në PZAP, ka qenë deri me datë 18.12.2017, në ora 19:00.

Dispozita ligjore e nenit 119 par.1 të LZP-së me Nr.03/L-073, i ndryshuar dhe i plotësuar me LIGJIN Nr. 03/L-256, parasheh se: “Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa”.

Ndërsa në raport me pretendimet që rrjedhin nga shkrimi i postuar në Komunikata për Media, Paneli vlerëson se lidhur me të gjeturat në procesin e votimit në Komunë e Istogut gjatë ditës së votimit me dt.17.12.2017 nga Demokracia në Veprim (DNV), PZAP-i ka vendosur me vendimet: ZLAnr.1130/2017, ZLAnr.1134/2017, ZLAnr.1135/2017 dhe ZLAnr.1136/2017 të datës 19.12.2017, dhe se kjo çështje konsideron se është e gjykuar.

Andaj, paneli nga arsyet e theksuara me lart dhe duke u bazuar në dispozitën e lart cituar ligjore vendosi si në pjesën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, lidhur me pretendimet e parashtruesit të apelit që ndërlidhen me ditën e votimit.

Ndërsa lidhur me pretendimet e parashtruesit të apelit se votat e 52 votuesve nuk janë numëruar dhe nuk janë përfshirë në rezultatin përfundimtarë, sepse emrat e tyre nuk kanë figuruar në Listën Përfundimtare të Votuesve, dhe se gjatë administrimit të

numërimin në QNR votat e 50 votuesve të tjerë nuk janë numëruar dhe llogaritur në Rezultatit Përfundimtarë për arsye të panjohura për subjektin politik X.X.

Paneli i PZAP-it, me parashtresën e datës 22.12.2017, ka kërkuar nga subjekti politik X.X. plotësimin e apelit në mënyrë që N.N. ta plotëson apelin ashtu që të specifikon saktë se 50 vota të cilat nuk janë numëruar pse nuk janë numëruar dhe në cilat vendvotime kanë votuar, votuesit që pretendohet se nuk i janë numëruar votat. Mirëpo subjekti politik N.N. nuk e ka bërë plotësimin e apelit siç ishte kërkuar me parashtresën e PZAP-it të datës 22.12.2017, por vetëm e ka kthyer një shkresë, në të cilin shkresë është "Raporti i votave me kusht dhe votave me Postë" nga QNR-ja, të cilin raport paneli e vlerëson si një raportim të rregullt nga QNR për X.X. e që nuk ka pas fare të bëjë me plotësimin e apelit nga subjekti politik N.N. siç ishte kërkuar nga paneli me parashtresën e datës së lartpërmendur.

Nga Raporti i votave me kusht dhe votave me Postë, i QNR- KQZ-së, paneli konstaton se me kusht kanë qenë 481 vota, ndërsa me Postë kanë qenë 24 vota, apo gjithsejtë 505 vota. Nga të cilat janë konfirmuar, me kusht 309 vota, të konfirmuara me Post 24 vota dhe të Refuzuar me kusht dhe Votat e Personave me Nevoja të Veçanta (VPNV), 172 vota. Që gjithsejtë janë siç u theksuar me lart 481.

Ndërsa nga parashtresa e KQZ-së e datës 23.12.2017, paneli konstaton se lidhur me refuzimin e 172 votave, pas përfundimit të te procedurave të konfirmimit në QNR, jo të gjitha këto vota kanë përmbushur kriteret ligjore për tu numëruar. Pas përfundimit të kësaj procedure në QNR, është vërtetuar se nga numri i përgjithshëm 481, i votave me kusht dhe votave VPNV, që i plotësojnë kriteret ligjore si fletëvotime të rregullta për numërim dhe procedim të mëtejshëm janë 309 vota, ndërsa 172 vota janë refuzuar. Arsyeja pse janë refuzuar 172 fletëvotime, sipas parashtresës së KQZ-së të datës 23.12.2017, është se të njëjtat nuk i kanë plotësuar kriteret ligjore, ngase 108 fletëvotime të refuzuar kanë të bëjnë se personat të cilët kanë votuar por nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV); 61 fletëvotime të refuzuar janë sepse personat që kanë votuar nuk kanë qenë votues respektivisht qytetar të Komunës së Istogut ku është mbajtur procesi zgjedhor; 2 fletëvotime janë refuzuar sepse votuesit që kanë votuar nuk kanë qenë të regjistruar si votues të kategorisë me nevoja të veçanta dhe 1 fletëvotim është refuzuar

sepse votuesi përveç që ka votuar me kusht është vërtetuar se i njëjti ka votuar edhe si votues në vendvotimin e tij të rregullt.

Lidhur me pretendimet e apellesit se janë 50 fletëvotime që nuk janë numëruar sepse votuesit kanë arritur moshën madhore për të votuar në mes të datave 20.10.2017 dhe 17.12.2017, e cilat vota nuk janë numëruar, këto pretendime janë vlerësuar nga paneli si të pabazuar sepse Ekstrakti i Regjistrimit Qendror Civil ka përbajtur të gjithë emrat e votuesve të regjistruar të moshës 18 vjeçare, duke përfshirë edhe ata që i kanë mbushur 18 vjeç deri në ditën e zgjedhjeve, më 22 tetor 2017. Sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 02/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 3 par.3, parasheh: "Me qëllim të krijimit të listës së votuesve, KQZ-ja gjatë procesit zgjedhor pranon tri (3) herë ekstraktin e regjistrimit civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil. Herën e parë, jo më vonë se dy ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, herën e dytë jo më vonë se 3 ditë para fillimit të periudhës së kundërshtimit të listës së votuesve, si dhe herën e tretë jo më vonë se dy ditë pas përfundimit të periudhës së kundërshtimit të LV-së". Të cilën listë, votuesit kanë pasur mundësi që të kundërshtojnë gjatë periudhave të shqyrtimit të saj, nga ana e publikut dhe atë prej datës 29 gusht 2017 deri me datën 12 shtator 2017. Meqenëse lista e votuesve është certifikuar pasi që ka kaluar afati i kundërshtimit, deri me datë 12.09.2017, dhe e njëjta listë e certifikuar është e vlefshme për një proces zgjedhor sepse certifikohet vetëm njëherë në një palë zgjedhje pavarësisht se sa zgjatë periudha kohore e procesit zgjedhore, mbi këtë bazë votuesit që e kanë arritur moshën madhore gjatë periudhës kohore 22.10.2017 dhe 17.12.2017, nuk kanë mundur të jenë pjesë e listës së certifikuar të votuesve.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, vërtetoi se parashtuesi i apelit, nuk ka arritur me prova, ti vërtetojë pretendimet në apel, andaj nisur nga të gjitha arsyet e dhëna më lart, paneli vendosi si në pjesën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 117 lidhur me nenin 118 të LZP-së, për pjesën që është refuzuar apeli.

